


INTERVISTA E ISH-TRUPROJES

► FAQE 4-5

Marjan Gryka: Dorëzimi i vrasësit të Azemit me garanci të SHIK-ut

"Mulosmani s'tregon të vërtetën, Rama të burgosë Berishën"



"QYSH KI QEF"

**BEATRIX RAMOSAJ
SAKRIFIKON PER
DASHURINE**

► FAQE 24

[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30

VITI IV - NR. 181 - E DIËL - 03-08-2014

Lexoni
Dëgjoni
Shikoni
EDICIONI MULTIMEDIAL
Kjo gazetë përdor teknologjinë QR-CODE



Satirë politike



NGA **ARBEN DUKA**

Pak e nga të gjitha..

Në datën një gusht, në ditën e plazhit, më çuditi shumë, ikje e Celibashit!..

► vijon në faqen 23
bashkë me Vargje për këngë

Koment



NGA **STEFAN TROEBST**

Si mund t'i vihet pritë ndikimit të Moskës?!

"BRSS vazhdon të jetojë ende mes 'bllokadës armiqësore kapitaliste', me të cilën nuk mund të ketë një bashkëkzistencë paqësore afatgjatë" – kështu i telegrafonte Departamenti të Shtetit nga Moska diplomatit amerikan George F. Kennan në 22 shkurt 1946. Lidhur me politikën e jashtme sovjetike, Kennan dallonte 'dy fusha', konkretisht njëra "zyrtare" dhe një "fushë e nëndheshme, ku veprojnë agjentë për të cilët qeveria ruse nuk merr asnjë përgjegjësi". Kennan ishte gjithashtu i mendimit se, "aty ku duket e mundshme dhe premtuese, Fuqia Sovjetike do të përpiqet të zgjerohet..."

► vijon në faqen 14

SUPLEMENTI "RILINDASI"



DOKUMENTI I VITIT 1907

Letra e Nolit në konferencën e Hagës: Shpëtoni Shqipërinë

Pas 50 vitesh në shtëpinë e poetit Frederik Reshpja...

► FAQE 15-22

VJEDHJA E THESARIT

► FAQE 12-13

Prokuroria gjen firmën e kunatit të Bitrajt, kapitali 330 milionë lekë

Aktiviteti për importin e jahteve. Nipi i hiqte targën makinës para derës



Objekti i Qendrës së Emissionit të BSH



MINISTRIA E ARSIMIT

Del formulari A2, ja si duhet plotësuar për të fituar shkollën

► FAQE 9



HUAJA

Në tre muaj qeveria siguron 202 mln euro nga ndërkombëtarët

► FAQE 8

» DEKLARATAT

Pasuritë e anëtarëve të KLD, nga dhuratat te loja me bonot

Depozita në disa banka, ja lëvizjet e shumave në dy vite

Anëtarët e KLD kanë të deklaruar në depozitat e tyre bankare pasuritë e tyre financiare dhe pronat e paluajtshme. Kupola më e lartë e drejtësisë pasuritë i deklaroi të vëna nga angazhimi në arsim, puna si këshilltarë, anëtarë të KLD, interesa bankare etj. Shumë prej tyre pasuritë më të mëdha i kanë deklaruar në emër të bashkëshorteve

të tyre ndërkohë që të tjerë pranojnë dhuratat deri në 30 mijë euro. Nën kryetari i KLD-së, Elvis Cefa brenda një viti e ka shumfishuar pasurinë e tij. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, Xhevair Zaganjori brenda dy vitesh ka depozituar një shumë prej 25 mijë paund në llogari të djalit të tij i cili vazhdon studimet në Londër. Gjyqtari i Shkallës së Parë, Ilir Mustafaj, deklaroi të ardhura falë angazhimeve

të tij të mësimdhënies në universitet. Dritan Hallunaj veç shumave të mëdha pasurore që deklaroi ka pranuar edhe një dhuratë në shifrën e 30 mijë eurove nga babai i tij, por dhe një kredi me vlerë 5 milion lekë. Pasuritë e gjyqtarit të Apelit Gjini Gjoni, vështirëse mund të ndahen nga ato të deklaruar nga bashkëshortja e tij Elona Çausi. Në deklaratimet e pasurisë Gjoni, deklaroi karta krediti

të posaçme. Bashkëshortja e tij në deklaratën e pasurisë, paraqet depozita në banka të ndryshme. Gjyqtari i Apelit në Vlorë, Hysen Saliko pasurinë e tij e justifikoi duke deklaruar se një pjesë të mirë të të ardhurave i përfiton falë pëmtarisë dhe bletarisë që janë në pronësi të familjes. Shpenzimet monetare nga depozitat që ka në llogaritë të tij, anëtarë i KLD-së, Lulzim Lelcaj e investon në bono thesari.



PASURITË E ANËTAREVE TE KLD-SË




Artan Broci
SHTOHEN FONDET NGA PUNA E GRUAS
SI NOTERË, QIRATË E HONORARËT

(VITI 2013)

- » Paga si Gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë 1.497.921 Lekë
- » Qira nga lokali Janar-Qershor 2012 nga qiramarrësi E.Rira 600.000 lekë
- » Qira shtator-dhjetor nga Shoqëria "Rexha Gold" sh.p.k 3.600 euro
- » Qira nga Zyra Janar-Dhjetor 2012 nga L.OCO 840.000 lekë
- » Të ardhura nga puna e bashkëshortes si notere në Tiranë 2.272.797 lekë
- » Shtuar Depozita pranë B.K.T-së nga kursimet familjare nga fitimi i Zyrës Noteriale 1.179.170.01
- » Depozitë pranë Bankës Credins Depozita Plus kursume nga paga 583.589.31 lekë

(VITI 2014)

- » Apartament sip.65.7 M2 shtesë e pallatit ekzistues në Don Bosko 550.000 lekë
- » Shtuar autoturë Benz në pronë të bashkëshortes, arkëtuar në banesë 500.000 lekë
- » Blerë autoturë Benz, kursume personale 1.000.000 lekë
- » Llogari pranë B.K.T-së e bashkëshortes nga puna si notere 1.500.000 lekë
- » Llogari pranë B.K.T-së, Interesa e Bashkëshortes nga puna si notere 9.963.71 lekë
- » Llogari pranë B.K.T-së, Interesa e Bashkëshortes nga puna si notere 7.018.55 lekë
- » Shtuar Interesa nga llogaria në B.K.T. 160.373.3 lekë
- » Llogari pranë bankës Credins paga 707.352.48 lekë
- » Llogari pranë bankës Credins paga kart visa klasik 348.653.71 lekë
- » Llogari pranë bankës Credins Depozita Plus 1.039.645.16 lekë
- » Interesa nga depozita plus pranë bankës Credins 17.839.86 lekë
- » Paga si gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë 398.500 lekë
- » Paga si anëtar i Gjykatës së Lartë 1.123.516 lekë
- » Honorare si Anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë 117.000 lekë
- » Të ardhura nga puna e bashkëshortes si notere në Tiranë 4.208.890 lekë
- » Qira nga Lokali Shoq. "Rexha Gold" 10.800 euro
- » Qira nga zyra Loco 840.000 lekë




Astrit Haxhialushi
SHITESAT NGA PENSIONE DHE PAGA

(2013)

- » -Shitje e automjetit motorik të përdorur, blerë autoturë MB 320 CDI 10.000 euro
- » Dogana e paguar për autoturë MB 320 CDI 590.255 lekë
- » Shitje e automjetit tip Fiat Punto të bashkëshortes 500.000 lekë
- » Paga si Gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë 1.542.219 lekë
- » Pensioni i babait 174.552 lekë

- » Pensioni i nënës 144.000 lekë (2014)
- » Kursime të familjes 400.000 lekë
- » Paga si Gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë 1.619.586
- » Të ardhura nga honorare për mbledhjet e zhvilluara nga KLD 117.000 lekë
- » Paga e bashkëshortes nga puna si "inspektore" në Ministrinë e Financave 579.200 lekë
- » Pensioni i babait 188.412 lekë
- » Pensioni i nënës 164.412 lekë




Dritan Caka
TË ARDHURA NGA PAGA DHE MËSIMDHËNIA.
BLEN AUTOTURËN 900 MIJË LEKË

(2013)

- » Pakësuar një pjesë e të hollave të deklaruar si kursume për vitet paraardhëse 500.000 lekë
- » Shtuar autoturë të përdorur tip benz (Daimler-Chrysler), model B 180 CDI 900.000 lekë
- » Të ardhura personale nga paga neto si gjyqtar, shtesa për vjetërsi pune, pagesa për punë jashtë orari 1.111.992
- » Të ardhura nga paga neto dhe shpërbilimet e bashkëshortes, si inspektore në Ministrinë e Drejtësisë dhe nga loja e lindjes së familjes së parë në vitin 2012. Paguar nga M.Drejtësisë dhe ISSH 470.317 lekë
- » Të ardhura prej tokës së përfituar në pronësi nga ligji 7501 "Për Tokën" Rreth 300.000 lekë
- » Të ardhura nga pagesa e angazhimit si ekspert i Shkollës së Magjistraturës 36.000 lekë
- » Të ardhura nga shërbimet e pjesëmarrjes në mbledhjet e KLD 108.000 lekë
- » 2.500.000 lekë kredi e marrë pranë "Tirana Bank" për financimin e ndërimit të apartamentit të banimit, mbetur 650.934

(2014)

- » Të ardhura personale nga paga neto si gjyqtar, shtesa për vjetërsi pune, pagesa për punë jashtë orari 1.016.739
- » Të ardhura nga paga neto dhe shpërbilimet e bashkëshortes, si inspektore në Ministrinë e Drejtësisë (deri në 07.07.2013 kur është larguar nga kjo ministri) 430.669
- » Të ardhura (fitim neto) nga aktiviteti privat i bashkëshortes si notere me profesion të lirë 781.279 lekë
- » Të ardhura nga shërbimet e pjesëmarrjes në mbledhjet e KLD 135.000 lekë
- » Shlyer kreditin e marrë pranë "Tirana Bank" për financimin e ndërimit të apartamentit të banimit 2.500.000 lekë



Dritan Hallunaj
BABAI I DHURON 30 MIJË EURO,
MERR KREDI 5 MLN LEKË

(2013)

- » Shtesë gjendje cash në banesë për vitin 2012, dhuratë nga babai 30.000 euro

- » Shtesë gjendje cash në banesë për vitin 2012, të ardhura nga kursimet nga paga ime dhe e bashkëshortes 300.000 lekë të reja
- » Të ardhura nga paga si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda 1.262.686 lekë
- » Të ardhura nga pagesat si anëtar i KLD 108.000 lekë
- » Paga e bashkëshortes si mjek stomatolog 432.205 lekë
- » Kredi bankare në "Raifaisen" me vlerë 5.000.000-mbetur për t'u shlyer edhe 3.953.583

(2014)

- » Shtesë gjendje Cash në banesë për vitin 2013, të ardhura nga kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes 300.000
- » Të ardhura nga paga si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda 1.234.412 lekë
- » Të ardhura nga pagesa si anëtar i KLD-së 135.000 lekë
- » Të ardhura nga pagesa si anëtar i Komisionit Disiplinor i Domës Kombëtare të Avokatëve 315.000 lekë
- » Paga e bashkëshortes si mjek stomatolog 502.997 lekë
- » Kredi bankare në "Raifaisen" me vlerë 5.000.000 mbetur për t'u shlyer edhe 3.785.365.09



Elvis Cefa
SHTON PASURINË NË VITIN 2012,
NIS SHPENZIMET NË VITIN 2013

(2013)

- » Apartament banimi këmbyer me apartament banimi 124.91 m2 kat 11 me vlerë 141.208 euro
- » Depozitë bankare në Credins Bank 3750 euro
- » Elvis e Arjeta Cefa gjendje "cash" nga kursimet familjare 147.600 lekë
- » Elvis Cefa llogari page në BKT / 9066.93 lekë & 96064.52 lekë dhe shtesë 86997.59 lekë
- » Arjeta Cefa(bashkëshortja) llogari page në Credins Bank 539.08 & 9930.35 dhe shtesë 9391.27 lekë
- » Të ardhura neto nga paga, shpërbilime dhe bonuse në Agjencinë e Kimit të Pronave 942.041 lekë
- » Të ardhura Netto nga paga dhe shpërbilime nga KLD në vitin 2012 846059 lekë
- » Të ardhura neto nga shpërbilimet si anëtar i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës 18000 lekë
- » Të ardhura neto nga interesi bankar në depozitë kursumi 100 euro
- » Të ardhura neto nga paga e shpërbilimit në Kuvendin e Shqipërisë në vitin 2012 1.009.264 lekë
- » Kredi bankare për strehim në BKT në shumën 5 000 000 lekë mbetur edhe 4.510.150.33 lekë

(2014)

- » Llogari pranë BKT pakësuar 56.389 lekë
- » Arjeta Cefa (bashkëshortja) pakësuar 8.950.03 lekë
- » Pakësim gjendje "cash" deklaruar më parë 1.476.000 lekë dhe 3.850 euro
- » Elvis e Arjeta Cefa gjendje "cash" nga kursimet familjare shtuar 1.270.000 lekë
- » Të ardhura neto nga paga dhe honorare në KLD 2.462.673 lekë
- » Të ardhura neto si anëtar i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës për vitin 2013 27000 lekë
- » Arjeta Cefa(bashkëshortja) të ardhura nga paga në Kuvendin e Shqipërisë 1.013.123 lekë

- » Kredi bankare për strehim në BKT në shumën 5.000.000 lekëmbetur edhe 4.242.800.07 lekë



Hysen Saliko
SHIMI I KURSIEMEVE NGA
PËMTARIA DHE BLETARIA

(2013)

- » Shtuar gjendje para kesh nga kursimet dhe të ardhurat nga ferma bujqësore dhe bletaria e familjes 1.600.000 lekë
- » Të ardhura nga paga si gjyqtar i Gjykatës së Apelit Vlorë për vitin 2012 1.256.467 lekë
- » Të ardhura nga shpërbilimet për pjesëmarrje si anëtar në mbledhjet e KLD 99.000 lekë
- » Të ardhura nga pensioni i pleqërisë së nënës viti 2012 102.360 lekë
- » Të ardhura nga toka bujqësore, pëmtaria e bletaria e familjes në fshatin Qinan në Kolonjë 1.100.000
- » Të ardhura nga paga e djalit si Jurist i Jashtëm, punësuar te Urdhri i Infermerit të Shqipërisë dhe puna si Specialist në Ministrinë e Drejtësisë 582.903 lekë
- » Të ardhura nga paga e bashkëshortes e punësuar në sektorin privat 42.000 lekë

(2014)

- » Shtuar gjendje para kesh nga kursimet dhe të ardhurat nga ferma bujqësore dhe bletaria e familjes 1.600.000 lekë
- » Të ardhura nga paga gjatë vitit 2013, si gjyqtar i Gjykatës së Apelit Vlorë 1.270.591 lekë
- » Të ardhura nga shpërbilimet për pjesëmarrjet si anëtar në mbledhjet e KLD 126.000 lekë
- » Të ardhura nga pensioni i pleqërisë së nënës 104.460 lekë
- » Të ardhura nga toka bujqësore, pëmtaria e bletaria e familjes në fshatin Qinan në Kolonjë 1.100.000 lekë
- » Të ardhura nga paga e djalit si specialist në Ministrinë e Drejtësisë 638.804 lekë
- » Të ardhura nga paga e bashkëshortes e punësuar në sektorin privat 264.000 lekë



Ilir Mustafaj
KURSIMET RITEN NGA MËSIMDHËNIA
NË UNIVERSITETET PRIVATE

(2013)

- » Llogari rrjedhëse te Union Bank të ardhura nga mësimdhënia 2.303.122 lekë
- » Llogari e shtuar nga pakësimi i llogarisë te "Credins Bank" 791.000 lekë
- » Llogari rrjedhëse te Banka Credins (paga si gjyqtar) 149.589 lekë
- » Llogari rrjedhëse te "Raifaisen Bank" (shpërbilime nga KLD) 54.000 lekë
- » Llogari rrjedhëse te "Raifaisen Bank" (paga e bashkëshortes) 62.941 lekë
- » Llogari rrjedhëse te "Banka Kombëtare e Greqisë"



(mësimdhënie e Fakultetit Ekonomik Publik) 133.550 lekë

- » Paga nga detyra e gjyqtarit në "Credins Bank" 1.122.123 lekë
- » Shpërbilim nga pjesëmarrja në mbledhjen e KLD 108.000 lekë
- » Të ardhura nga mësimdhënia dhe udhëheqja e diplomave në Fakultet, Sistemi Master, duke pasur parasysh titullin "Prof.Asc.Dr" 725.122 lekë
- » Të ardhura nga mësimdhënia në Fakultetin, sistemi Master në "Union Bank" 378.000 lekë
- » Të ardhura nga udhëheqja e diplomave në Sistemin Master, duke pasur parasysh dhe titullin Shkencor, që zotëroj "Prof. Asc. Dr" 210.000 lekë
- » Të ardhura nga pjesëmarrja në konferenca, shitja e librave 100.000 lekë
- » Të ardhura nga mësimdhënia, Fakulteti Ekonomik, në Bankën Kombëtare të Greqisë 133.550 lekë
- » Paga e bashkëshortes si drejtore të Gjinnazit "Partizani" 669.672 lekë

(2014)

- » Llogari rrjedhëse tek Union Bank të ardhura nga mësimdhënia 997.339
- » Llogari e shtuar nga pakësimi i llogarisë të "Credins Bank" 149.589 lekë
- » Llogari rrjedhëse të "Raiffaisen Bank" (shpërbilime nga KLD) 135.000 lekë
- » Llogari rrjedhëse në Raiffaisen Bank, paga e bashkëshortes 62.941 lekë
- » Llogari tek Credins Bank, me afat në vjeçar në vlerën 3.000 000 lekë
- » Llogari rrjedhëse tek "Banka Kombëtare e Greqisë" mësimdhënie në Fakultetin Ekonomik 133.550 lekë
- » Të ardhura nga mësimdhënia, Fakulteti Ekonomik, në Bankën Kombëtare të Greqisë 456.558 lekë
- » Paga e bashkëshortes si drejtore të Gjinnazit "Partizani" 657.583 lekë

Sokol Çomo SHITESA NGA ZYRA JURIDIKE, PEDAGOG DHE NGA SISTEMI I DREJTËSISË

(2013)

- » Apartament banimi me sip. 95.46 m2. Çmimi i blerjes 5 000 000 lekë, rivlerësuar në 2013 në vlerën 16 825 200 lekë
- » Gjendja e llogarisë në Raiffaisen Bank 50.204.93 lekë
- » Gjendja e llogarisë në NGB Albania 1.797 euro
- » Gjendja e llogarisë në Intesa SanPaolo 119.09.40 lekë / 5.82 euro/ 41.91 dollarë
- » Gjendja e llogarisë në Bankën Societe Generale 1.362.31 lekë
- » Gjendja e llogarisë në BKT 12.93 euro
- » Paga si Drejtues i Zyrës Ligjore për Kreditit me Probleme në Intesa SanPaolo Bank 2.132.022 lekë
- » Shpërbilim si pedagog i jashtëm, udhëheqës teme pranë shkollës së Magjistraturës 130.500 lekë
- » Shpërbilim si President i Komisionit të Disiplinës pranë Federatës Shqiptare të Futbollit 567.000 lekë
- » Shpërbilim si anëtar i Bordit të Fondacionit Soros 90.000 lekë
- » Shpërbilim si ekspert i Qendrës Shqiptare për Studime dhe Trajtime Juridike 36.000 lekë
- » Shpërbilime si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës së Bankës "NGB Albania" 1800 euro
- » Shpërbilim si ekspert trajnimi i Shoqatës Shqiptare të Bankave 18.000 lekë
- » Shpërbilime si ekspert i Dhomës Kombëtare të

Përmbauesve Gjyqësorë private 36 000 lekë

- » Paga e bashkëshortes si Drejtore e Marrëdhënive me Publikun dhe me Jashtë pranë Gjykatës Kushtetuese 1 041 917 lekë
- » Kredimarrës në blerjen e një apartamenti në Tiranë, kredi me vlerë 5 000 000 lekë / Pa shlyer 2.871.226.22 lekë
- » Bashkëkredimarrës në kredi personale të kredimarrës Alma Çomo (bashkëshortja) në shumën 1.000.000 lekë Pa shlyer 900.273.28 lekë
- » Debi në kartën e kreditit të lëshuar nga Raiffaisen Banka 54.43 euro

(2014)

- » Gjendja e llogarisë në Raiffaisen Bank 404.100.30
- » Gjendja e llogarisë në NGB Albania 33.06
- » Gjendja e llogarisë në Intesa SanPaolo 558.941.40 lekë / 5.82 euro/ 41.91 dollarë
- » Gjendja e llogarisë në BKT 9.95 euro
- » Paga si Drejtues i Zyrës Ligjore për Kreditit me Probleme në Intesa SanPaolo Bank 976.928 lekë
- » Shpërbilim për Mbledhjet në KLD 18.000 lekë
- » Shpërbilim si President i Komisionit të Disiplinës në FSHF 180.00
- » Shpërbilim si anëtar i Komitetit Shkencor të Shkollës Kombëtare të Avokatëve 120.500 lekë
- » Paga e bashkëshortes si Drejtore e Marrëdhënive me Publikun dhe me Jashtë pranë Gjykatës Kushtetuese 58.34 lekë
- » Kredimarrës në blerjen e një apartamenti në Tiranë, kredi me vlerë 5 000 000 lekë / Pa shlyer 2.821.340 lekë
- » Bashkëkredimarrës në kredi personale të kredimarrës Alma Çomo (bashkëshortja) në shumën 1.000.000 lekë. Pa shlyer 884.048.58 lekë
- » Debi në kartën e kreditit të lëshuar nga Raiffaisen Bank 369.66 euro

Tritan Hamitaj SHËNOHEN ULJE TË KURSIMEVE GJATË VITIT TË FUNDIT

(2013)

- » Llogari rrjedhëse në Raiffaisen Bank 54.000 lekë
- » Llogari rrjedhëse në Alfa Bank 54.500 lekë
- » Llogari rrjedhëse në Credins Bank 22.000 lekë
- » Llogari në Alfa Bank 180.000 lekë
- » Gjendje cash 200.000 lekë
- » Paga si gjyqtar 1.115.600 lekë
- » Të ardhura nga toka bujqësore (Hekal Mallakastër) 150.000 lekë
- » Pagesa si anëtar i KLD 108.000 lekë
- » Paga si mësuese e bashkëshortes në Gjinnazin Gjergj Kastrioti në Durrës 432.000 lekë

(2014)

- » Llogari rrjedhëse në Raiffaisen Bank 1.000 lekë
- » Llogari rrjedhëse në Alfa Bank 10.375 lekë
- » Llogari në Alfa Bank 57.124 lekë
- » Llogari kursimi 5.000 euro pranë Credins Bank
- » Llogari rrjedhëse në Raiffaisen Bank (Andis Hamitaj) 48.000 lekë
- » Paga si gjyqtar 1.237.735 lekë
- » Të ardhura nga toka bujqësore (Hekal Mallakastër) 200.000 lekë
- » Pagesa si anëtar i KLD 135.000 lekë
- » Paga si mësuese e bashkëshortes në Gjinnazin Gjergj Kastrioti në Durrës 550.526

Xhevair Zaganjori ZAGANJORI PAGUAN 25 MJË PAUND SHKOLLËN E DJALIT, RRIJT KURSIMET NË DEPOZITA

(2013)

- » Të ardhura nga qiraja (bodrum+zyrë) 480.000 lekë
- » Interest nga depozita në lekë e bashkëshortes në SanPaolo Bank 296.000 lekë
- » Shitesë në Euro e bashkëshortes në depozitën e bankës San Paolo 5.200 euro
- » Tërheqje dhe mbyllje e llogarisë në USD në bankën SanPaolo 900 USD
- » Depozitë e re në Euro në bankën Raiffaisen 10.000 euro
- » Depozitë në lekë në Raiffaisen 1.300.000 lekë
- » Pagesa për shkollën e djalit (Master në Londër) 17.500 Pound
- » Paga si anëtar i Gjykatës Kushtetuese 2.052.336 lekë
- » Të ardhura të bashkëshortes si notere 850.000 lekë
- » Të ardhura nga udhëheqja e doktoraturave dhe masterit në Fakultetin e Drejtësisë 2.507.000 lekë
- » Të ardhura nga udhëheqje shkencore e mësimdhënies 15.000 lekë dhe 192.000 lekë
- » Të ardhura nga anëtarësia në Këshillin për Arsimin e Lartë dhe Shkencën 60.408
- » Të ardhura nga bashkëpunimet me fondacionet e huaja 3320 euro dhe 1257.000 lekë
- » Të ardhura nga seminare në Institutin evropian 9.000 lekë
- » Gjendja e kartës kreditit Raiffaisen 17.500 lekë
- » Gjendja e kartës kreditit Raiffaisen 5.000 lekë
- » Të ardhura nga ligji për "Jurisprudencën" 112.000 lekë
- » Gjendja e kartës së kreditit në Bankën San Paolo 12.000 lekë
- » Gjendja e depozitës së djalit në Raiffaisen 428.000 lekë

(2014)

- » Të ardhura nga qiraja 432.000 lekë
- » Interest nga llogaria e bashkëshortes në Intesa SanPaolo Bank 280.000 lekë
- » Interest nga depozita nga llogaria e bashkëshortes në euro në Intesa SanPaolo Bank 333 euro
- » Shitesë në depozitën në Euro në Raiffaisen Bank 7.160 euro+203 euro interesa të mëparshme
- » Interest nga depozita kryesore në Euro në Raiffaisen Bank 1.690 euro
- » Shitesë në depozitën në lekë në Raiffaisen Bank 1.300.000 lekë+50.000 lekë interesa
- » Pagesa për master në Lindër të Djalit (semestri i dytë) 7500 Pound
- » Hapje llogari bankare e djalit në Deutsche Bank-Gjermani për kurse parauniversitare 9000 euro
- » Shitesë+Interest në depozitën e djalit në Raiffaisen Bank 40.000 lekë
- » Kartë krediti e djalit në Raiffaisen Bank 1.650 euro
- » Paga si anëtar i Gjykatës Kushtetuese 2.042.000 lekë
- » Të ardhura nga puna e bashkëshortes si notere 943.000 lekë
- » Të ardhura nga mësimdhënia, udhëheqje master dhe doktoraturë në Fakultetin e Drejtësisë, Institutin Europian, Shkolla e Magjistraturës 1.703.000 lekë
- » Të ardhura nga mësimdhënia dhe udhëheqje shkencore 17.000 Euro dhe 126.000 lekë
- » Të ardhura nga bashkëpunimi me fondacionet 1.985 euro
- » Të ardhura nga shitjet e librit 120.000 lekë
- » Të ardhura nga anëtarësia në ZABGJ, KLD 119.000 lekë
- » Paga e djalit si Specialist në Zyren e komisionit kundër Diskriminimit 247.328 lekë
- » Gjendja e kartave të kreditit në Raiffaisen 170.630 lekë & 47.560 lekë
- » Gjendja e kartës së kreditit në Intesa SanPaolo në emër të bashkëshortes 165.370 lekë

Flamur Kapllani DEPOZITA BANKE NË LEKË DHE KREDI PËR BANESË

(2013)

- » Parcelë e llojit "Are" në Shetaj, Durrës me sipërfaqe 1000 m2 200.000 lekë
- » Gjendja e llogarisë në emër të tij dhe të bashkëshortes 1) 434.071.85 lekë
- » 2) 147.29 lekë
- » 3) 397.932.65 lekë
- » Shitesë sipas kontratës së shitjes së automjeteve Ford Fiesta në emër të bashkëshortes 100.000 lekë
- » Gjendja e llogarisë 175.105.81 lekë
- » Të ardhurat vjetore nga paga bruto si Gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë 1.270.783 lekë
- » Kompensim për shpenzime celulari 120.000 lekë
- » Të ardhurat e përfuturara nga shpërbilimet për pjesëmarrje në mbledhjet e KLD 90.000
- » Paga, shpërbilime nga AKKP të bashkëshortes 491.249 lekë
- » Të ardhurat e bashkëshortes së deklaruesit nga puna si Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë 280.425.00
- » Të ardhura nga shitja e automjeteve në emër të bashkëshortes 100.000 lekë
- » Kredi në NGB për blerje banese/ Pa shlyer 11.875.50
- » Paga shpërbilime nga AKKP për bashkëshorten 491.249 lekë
- » Të ardhurat e bashkëshortes nga puna si notere pranë Dhomës së Avokatëve 280.425.00 lekë

(2014)

- » Gjendja e llogarisë bankare
- » 1) 310.123.14 lekë
- » 2) 8.252.36 lekë
- » 3) 502.170.42 lekë
- » Gjendja e llogarisë bankare në emër të bashkëshortes 1) 454.811.72 lekë
- » 2) 147.60 lekë
- » 3) 404.306.63 lekë
- » 4) 669.696.97
- » Të ardhura vjetore nga paga bruto si Gjyqtar në Gjykatën e Tiranës 1.283.792 lekë
- » Kompensim telefoni për shpenzime celulari 1.004.803 lekë
- » Të ardhura të përfuturara nga shpërbilimet në KLD 135.000
- » Të ardhura e bashkëshortes si notere në Dhomën e Tregtisë Tiranë 1.507.293 lekë
- » Kredi në NGB për blerje banese/ Pa shlyer 11.272.14 euro

Lulzim Lelcaj INVESTIME NË BONO THESARIT DHE INTERESA BANKARE

(2013)

- » Rrinvestimi në ankandin e bonove të thesarit të BSH me maturi 1 vjeçare, 52.902 lekë
- » Pjesëmarrje në ankand 1 vjeçar në shumën 2 milion lekë, Interest i bonove të thesarit 134.140 lekë

- » Pjesëmarrja në ankandin e BSH, 19 000 euro interesti i bonove 960 euro
- » Interesti në euro nga depozita maturimi i depozitës së deklaruar 674 euro
- » Interest i depozitës në Lekë e depozituar dhe e mbyllur 95.525 lekë
- » Paga vjetore si Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit legjislativ 1.523.100 lekë
- » Mësimdhënie si pedagog në Shkollën e Magjistraturës 8.640 lekë
- » Mësimdhënie si pedagog në Universitetin e Shkodrës 66.400 lekë
- » Honorarë si anëtar i Bordit të Qendrës së Publikimeve Zyrtare 23.500 lekë
- » Mësimdhënie si pedagog 109.350 lekë

(2014)

- » Rrinvestimi në ankandin e bonove të thesarit në BSH, Interest i bonove në shumën 28.623 lekë
- » Transferimi i shumës së investuar për shit-bleje të bonove të thesarit në BSH në llogarinë e Raiffaisen 1.986.586 lekë
- » Tërheqje nga llogaria në Raiffaisen 200.000 lekë
- » Tërheqje nga Banka Credins 19 000 euro
- » Depoziti i kësaj shume dhe interesave të marra një vit më parë prej Bankës Raiffaisen 19 965 euro
- » Llogari në Raiffaisen Bank në Pound 1.145 Pound
- » Llogari në Raiffaisen Bank në USD 3.119 USD
- » Paga si Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit legjislativ pranë Kuvendit të Shqipërisë 1.160.201 lekë
- » Paga për mësimdhënie në Shkollën e Magjistraturës 5760 lekë
- » Paga si pedagog 39.400 dhe 195.120 lekë
- » Honorarë si anëtar i KLD 99 000 lekë
- » Paga për mësimdhënie 17.100 lekë

Gjin Gjoni ME KARTA KREDITI TË POSAÇME DHE BLERJE AMBIENTESH

(2013)

- » Blerje ambienti dyqan me sip. 77 m2 150.000 euro
- » Paga si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë 1.521.627 lekë
- » Dhënie ambienti me qira 16.000 euro
- » Kredi NGB bashkë me bashkëshorten (Elona Çaushti) 90.000 euro/ Pa shlyer 68.367.41 euro
- » Overdraft pranë bankës Credins 350.000 lekë
- » Kartë krediti Amerikan Express 10.000 euro
- » Kredi për blerje makine, Benz Mercedes bashkë me (Elona Çaushti) 9.252 euro

(2014)

- » Kontratë sipërmarrje me bashkëpronare bashkëshorten (Elona Çaushti) 81.276 euro
- » Paga si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë 1.571.388 lekë
- » Dhënie ambienti me qira 8000 euro
- » Dhënie ambienti me qira 8000 euro
- » Kredi NGB bashkë me bashkëshorten (Elona Çaushti) 90.000 euro/ Pa shlyer 63.098.55 euro
- » Overdraft pranë bankës Credins 350.000 lekë
- » Kartë krediti Amerikan Express 10.000 euro limiti i kartës
- » Kredi për blerje makine, Benz Mercedes bashkë me (Elona Çaushti) 11.577 eur

ELONA ÇAUSHI (BASHKËSHORTE)

2013

- » Llogari në SOGENAL 67.180 euro
- » Zgjidhje kontrate porositje apartament 20.000 euro të mbetura
- » Vintage Second Hand Kapitali 100.000 lekë
- » Nr.llogarie
- » 1) 6.94 euro
- » 2) 1.017.96 USD
- » 3) 1.257.094.92 AU
- » 4) 170.90 CHF
- » 5) 358.727 Euro
- » 6) 1.212.88 GBP
- » Kartë e Amex e zezë nga Banka Credins
- » Kartë Krediti Visa Classic Banka Credins
- » Kartë Debiti Visa i Rrignegs Banka Credins
- » Paga vjetore si administratorë Shoqërisë ADFD Sh.P.K 5.761.160 lekë ose 41.447 euro
- » Dividenti i tërhequr në vitin 2012 30.000.000 lekë ose 220.000 euro

2014

- » Karta e zezë AMEX e lëshuar nga Credins Bank
- » Llogari Segonal 60.836 euro
- » Nr.llogarie
- » 1) 1196 GBP
- » 2) 2944 USD
- » 3) 5100 CHF
- » 4) 362.128.80 lekë
- » Kontratë sipërmarrje 81.276 euro
- » Mbyllje llogarie në Zvicër dhe tërheqje e shumës 4980 CHF
- » Paga vjetore si administratorë e ADFD Shpk 7.632.643 lekë
- » Divident me vendim asambleje i pa tërhequr nga shuma 13.200.000 lekë

» INTERVISTA

KRYETARI i shoqatës “Azem Hajdari” kërkon nga mazhoranca dhe kryeministri që të hapin sërish çështjen e vrasjes së liderit të dhjetorit dhe autorët të dënohen



Akuza
“Nuk besojmë se kërkon ndonjë koment pjesa që ne e kemi deklaruar dhe rideklaruar publikisht se vrasësit nuk kishin ardhur për të vrarë Azem Hajdarin”.

Marjan Gryka: Rama të çojë Berishën në burg për Hajdarin

Ish-truproja e Liderit të Dhjetorit: Jaho Mulosmani ka qënë i lidhur me SHIK-un, ai s'tregon të vërtetën

Kryetari i shoqatës “Azem Hajdari”, njëherësh ish-truproja e Liderit të Dhjetorit, Marjan Gryka, në një intervistë për gazetën “Shqiptarja.com” është shprehur se kryeministri Edi Rama duhet të mbajë premtimin që ka bërë dhe të dërgojë para drejtësisë Sali Berishës për vrasjen e liderit të dhjetorit, por dhe 21 janarin e vrasjes e deputetit Fatmir Xhindi. Njëherësh ai është shprehur se i dënuari me burgim të përjetshëm për këtë vrasje, Jaho Mulosmani nuk flet të vërtetë në deklaratimet mediatiche, madje nuk tregon as që ka pasur lidhje me SHIK-un, vetëm tek i cili besonte kur u dorëzua për t'u dënuar më pas. Teksa deklaronte se Berishën dhe Hajdarin i kishte shoqëruar ai në Tropojë, Gryka nënvizon se politika e të dyja krahëve e vrau liderin e dhjetorit. Ndërkohë që thotë se Ilir Meta e ka në dorë të kërkojë nga Kuvendi inicimin ligjor të zbardhjes së kësaj vrasjeje të shekullit.

Jeni kryetar i shoqatës “Azem Hajdari”, ku asnjëherë nuk keni rreshtur së kërkuari zbardhjen e plotë të kësaj vrasjeje nga drejtësia shqiptare, duke kërkuar që politika të ushtrojë presionin e saj pozitiv për përshejtimin e saj...?

Kanë kaluar 16 vite nga pushkatimi i deputetit Azem Hajdari dhe po kaq vite ku u vra Lideri i Dhjetorit '90. Dhe pavarësisht nga implikimi i të dy kampeve politike në këtë vrasje, ata më në fund e kuptuan se edhe pas 16 viteve për Azemin do të flitet gjithmonë deri në zbardhjen e vrasjes, sikur ai është vrarë dhe ose sot! Tani e kuptuan më së miri se shqiptarët në të gjithë botën duan drejtësi dhe se Azemi nuk falet kurrë sepse ishte lideri i së drejtës e i fjalës së lirë. Shohim deputetë nga e majta duke bërë gjoja përpjekje për të rihapur dosjen 'Hajdari', por shohim edhe se si gazetarë të dërguar dhe të paguar shkojnë te vrasësit e Azem Hajdarit për të gërvishur sadopak atë pjesë që i intereson atij që e ka dërguar këtë gazetar. Dhe sot në Shoqatën Mbarëkombëtare Azem Hajdari, dhe vetë unë si kreu i kësaj shoqate me emrin e madh Azem Hajdari, gjithmonë ndjejmë detyrim, obligim juridik, statutor, mediatik dhe politik ndaj popullit shqiptar por edhe institucioneve ndërkombëtare që të sqarojmë çdo moment dhe çdo detaj për zbardhjen e çështjes 'Hajdari' dhe zhvillimet e saj ashtu siç kemi bërë dhe nuk jemi ndalur për 16 vite me radhë!

Ju po flisni për deklaratat e Jaho Mulosmanit në media, njeriut të dënuar me burgim të përjetshëm për këtë vrasje, ku ai ka deklaruar disa elemente për ekzekutimin e liderit të dhjetorit?

Po e fillojmë me atë çfarë lexuam dhe dëgjua nga Jaho Mulosmani! Në radhë të parë shqiptarët e panë vrasësin e Azemit pas 16 viteve me pamjen dhe fytyrën e deputetëve



Marjan Gryka

të Parlamentit tonë të sotëm dhe me një zyrë me pamjen e biznesmenëve të sotëm në Shqipëri! Në fillim nuk besojmë se kërkon ndonjë koment pjesa që ne e kemi deklaruar dhe rideklaruar publikisht se vrasësit nuk kishin ardhur për të vrarë Azem Hajdarin! (Këtë Mulosmani e përsëriti disa herë). Në anën tjetër si një i dënuar me burgim të përjetshëm ai gënjën duke thënë se shkuam të sqarohemi me Azemin dhe se Saliu ishte i lirë të hynte në Tropojë! Nuk dua t'i jap vlera aspak një personi si Jaho 'Lepuri', por dua t'i them se kur flet për vrasjen e Azemit nuk duhet të flasë si i burgosur por si ish-Shef Komisarati që ishte në këtë detyrë kur shtiu mbi Azemin dhe kur flet për Fatmir Haklajn duhet të citojë atë si Drejtor policie në Tropojë që e gëzonte këtë post kur shtiu mbi

Azemin ku për çudi burrërore Haklaj kanë qënë kullë e lartë, por ranë në grackën politike. Ndërsa Jaho ishte në atë kohë kushëriri i parë i njeriut më të besuar të Sali Berishës dhe Drejtorit të Policisë Vlorë, Sokol Mulosmanit, dhe pasi ra shteti dhe u rrëzua Sokoli i Saliut, erdhi PS dhe u ngrite ti Sokoli i Nanos! Ashtu siç Fatmir Haklaj ishte kushëriri i parë i kryetarit të PD të Tropojës, Azgan Haklaj, i besuari Saliut dhe Fatmiri i besuari i Nanos! Sepse edhe vrasja ndodhi e mirëlllogaritur, me Berishën në krye të opozitës që është i pari për të marrë pjesë në varrimin, dhe me Nanon Kryeministër që me aftësitë e tij komuniste përdori puçistët

AKUZA NANOS
“Vrasja ndodhi e mirëlllogaritur, me Berishën në krye të opozitës i pari për të marrë pjesë në varrimin, dhe me Nanon Kryeministër që përdori puçistët brenda PD me në krye Saliun”.

Azemin ku për çudi burrërore Haklaj kanë qënë kullë e lartë, por ranë në grackën politike. Ndërsa Jaho ishte në atë kohë kushëriri i parë i njeriut më të besuar të Sali Berishës dhe Drejtorit të Policisë Vlorë, Sokol Mulosmanit, dhe pasi ra shteti dhe u rrëzua Sokoli i Saliut, erdhi PS dhe u ngrite ti Sokoli i Nanos! Ashtu siç Fatmir Haklaj ishte kushëriri i parë i kryetarit të PD të Tropojës, Azgan Haklaj, i besuari Saliut dhe Fatmiri i besuari i Nanos! Sepse edhe vrasja ndodhi e mirëlllogaritur, me Berishën në krye të opozitës që është i pari për të marrë pjesë në varrimin, dhe me Nanon Kryeministër që me aftësitë e tij komuniste përdori puçistët



Për Mulosmanin

“Jaho duhet të shprehet dhe për lidhjet e tij me SHIK-un për dorëzimin e tij dhe garancinë sepse ata janë njerëzit që i dhanë edhe garanci shtetërore për vrasjen që bëri”

Për Berishën

“Drejtësia e ka thirrur Saliun mbi 8 herë për t'u paraqitur. Saliun nuk ka nevojë ta thërrasë drejtësia, por ta arrestojë policia, jo ju s'doni këtë por thjesht shashka politike”.

brenda PD me në krye Saliun! Pra çdo gjë është e lidhur dhe e verteturar si në dritën e diellit dhe nuk mundet t'i hedhin hi syve shqiptarëve siç bënë 'Tomi e Xherri' për 16 vite.

Ju mendoni se Jaho Mulosmani nuk ka qënë i singertë në deklaratimet e tij dhe se ka elementë të tjerë që nuk janë përmendur...?

Jaho duhet të shprehet dhe për lidhjet e tij me SHIK-in për dorëzimin e tij dhe garancinë sepse ata janë njerëzit që i dhanë dhe garanci shtetërore për vrasjen që bëri po për gjithë publikun dhe çdo shqiptar që e shikoi dhe dëgjoi, ishte e turpshme kur shikonte vrasësin e Azemit duke qeshur! Pra kur deklaronte shtesat se kishim ardhur për sqarim aty gënjën plotësisht, sepse me Haklajt ishte sqaruar çdo gjë më parë dhe kasetën e kishte me vete plaku i Haklajve kur iku atë ditë dhe u përqaftua me Azemin si i ati me të birin. Ndërsa, që Saliu mund të hynte në Tropojë sa herë që të donte kjo është gënjeshtrë e shkruar, e vjetër e Jaho 'Lepurit' me shokë. Sepse kur sollëm në Tropojë Saliun dhe Azemin unë isha komandant i grupit të shoqërimit atë ditë, por pas nesh na kishin ardhur edhe shoqëruar të rinj në ndihmë të Saliut dhe që komunikimin në celular me policinë e Tropojës! Dhe atë ditë, jo vetëm që na njoftuan që në Koman që të ktheheshim mbrapsht, por kur shkuam në tribunë, e kishin hedhur në erë me dinamit dhe ne bëmë luftë me armë, ku kjo është dhënë dhe në TV dhe kjo e hedh poshtë gënjeshtrën e Jahos. Pas kësaj unë kam qënë me Azemin edhe kur i vdiq i ati Shpend Hajdari, por edhe herë të tjera e Tropoja një qytet me traditë të mëdha, duke pasur brenda vetes vrasës dhe shegertë të politikës mori fund si qytet me 200 djem të vrarë! Pra kjo ishte përgjigja jonë për komisarët e policisë dhe vrasësit e Azem Hajdarit.

Ndërkohë që është premtuar zbardhja e vrasjes së Azem Hajdarit, mendoni se tani pas 16 vitesh mund të arrihet dhe autorët e kësaj vrasjeje, të cilësuar si politike të vihen realisht përpara drejtësisë dhe të marrin dënimin e merituar?

Në lidhje me atë çfarë po luan politika sot, ku shfaqen



Për Ramën

"Dilni publikisht e distancohuni nga të implikuarit në vrasjen e Azem Hajdarit, si dhe të kërkonit publikisht rihapjen e çështjes 'Hajdari', kërkesë që ua kemi bërë disa herë me radhë".

Për Metën

"Për zbardhjen e vrasjes së Hajdarit, i vetmi njeri që mund ta bëjë publikisht para gjithë shqiptarëve është sot kreu i Kuvendit Ilir Meta, që mund ta bëjë kërkesën para deputetëve".

NË FOTO:

Lidri i Dhjetorit Azem Hajdari, ish-kryetari i PD-së dhe ish-kryeministër Sali Berisha dhe njëri ndër ish-themeluesit e PD-së Gramoz Pashko

njerëz që duan të vënë drejtësi duke hedhur shashka për përfitimet politike ne po ju sqarojmë! Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama duke dështuar në çështjen e premtuar se do të zbardhë dhe duke u frikësuar të arrestojë jo vetëm Salin, por edhe Sali të tjerë, po luan fort duke futur në lëvizje deputetët e PS, për rihapjen e çështjes 'Hajdari' si një person që kërkon të sjellë fytyrën e re Gjykatave, Prokurorisë etj! Mirëpo i kujtojmë atij se, kur u vra Azem Hajdari t'i jo që nuk ishte në post por as që ishte anëtar i PS-së! Mirëpo kur u bërë ministër kulture dhe po zhvillohej festivali flokrorik në Gjirokastrë, grupet e Jugut kishin ardhur me këngë për Azem Hajdarin dhe ju sapo ju informuan për një gjë të tillë, i egërsuar urdhëruat që kënga e Azem Hajdarit të eleminohet urgjentisht dhe ashtu u bë. Kjo që sapo cituam është publike dhe mund ta ripublikojmë përsëri! Nisur nga kjo, ju në radhë të parë si ish-profesor në Lëvizjen e Dhjetorit '90 dhe si një i djathtë duhet t'i kërkonit publikisht të falur shqiptarëve për këtë veprim të ulët dhe personalisht të ndjerit Hajdari, dhe po ashtu pasi të bëni këtë, dilni publikisht e distancohuni nga të implikuarit në vrasjen Hajdari, kërkonit publikisht rihapjen e çështjes 'Hajdari', kërkesë që ua kemi bërë disa herë! Por nuk e di nëse mundesh? Nuk e di nëse të lënë ta bësh një burrëri të tillë, pasi të akuzuar dhe të implikuar në këtë vrasje janë shumë aktorë politikë nga e majta, nga i përmenduri disa herë Taulant Dedja që në Tropojë rrinte natë e ditë me vrasësit e Azemit pasi gjoja përfaqësoonte ndihmat humanitare atje, Fatos Nano, Fatos Klosi, Skënder Gjinushi, Thimio Kondi dhe ca të tjerë. Pra mendoj se deputët e tu po e bëjnë detyrën që ju ke ngarkuar por fatkeqësisht kanë ngelur në rrugë, duke e parë jo vetëm që e ke të pamundur këtë veprim ta besh sot se nesër do jetë vonë. Të rikujtojmë se ju jeni ish-opozita që me në krye Ramën akuzuat Sali Berishën e Lul Bashën si vrasës të 21 Janarit, ju akuzuat Salin dhe Median si vrasës të Gërdecit, ju keni bërë deri më tani mbi 30 akuzat publike Salit dhe s'itës së tij, por nga ana tjetër ju si Edi Rama keni tre raste që i dërgoni letër për bashkëpunim këtyre vrasësve, Bashës dhe Salit! Pra drejtësia as te ju nuk egziston, por duke u refuzuar letrat e dërguara nga ju prej Bashës ju po bëjnë lojën e kërcënimit për Salin me çështjen Hajdari.

Po kush mendoni se do ta dërgojë para drejtësisë këtë çështje, ndërkohë që kanë kaluar gati 16 vite nga ekzekutimi i tij para selisë së Partisë Demokratike..?

Çështjen Hajdari do e dërgojë në gjykatë populli kur të ketë drejtësi, sepse drejtësia e ka thirrur Salin mbi 8 herë për t'u paraqitur dhe jo ju, sepse ju vetëm në akuzat me shashka dhe turpe në Parlament po merreni për një vit. Salin nuk ka nevojë ta thërrasë drejtësia, por ta arrestojë policia pasi ai është i thirrur, edhe të tjerët pas tij Ylli Rakipi, Genc Pollo, etj tani di deshmitari Neza e shumë të

tjerë. Por ju nuk doni këtë por thjesht shashka politike dhe kërcënime ndaj Salit. Ju duhet të rihapni Gërdecin dhe ta largoni nga vetja dhe PS se Deljorgjin që vetëm për në vit qeverisje ka filluar 8 pallate! Ju nuk duhet të krenoheni me Lazaratin, me spiunët e Salit dhe disa të PS-së sepse Lazarati ishte viktimë si Tropoja ku 10 veta pasuroheshin, të tjerët hanin bukë thatë dhe ju duhet të vazhdoni arrestimet e jo të vetëkënaqeni se ka mundësi gjeni lidhje jo vetëm tek PD-ja, ju nuk duhet të turpëroheni duke e

lënë të zbehët vrasja e bujshme e Artan Santos që gjoja u vra një çun Tirone. Jo, vrasja e tij rrezoi shtetin, me bindjen se shteti e di mirë nga erdhi kjo vrasje, por rri tërhequr sepse implikimi është i thellë e në majë. Përgjegjësia bie mbi qeverinë dhe kryeministri duhet të ketë kurajon për

zbardhjen e domosdoshme të vrasjes së deputetit Fatmir Xhindi. Çfarë ju pengon e ju frikëson që nuk veproni, apo për çdo gjë ju pengon Adriatik Lllala me Salin, ju pengon SHISH apo KLSH! Ju e dinit mirë çfarë ju priste para se të bëheshit kryeministër. Pra zoti Edi Rama ka ardhur koha të mendosh si qytetar i përgjegjshëm e të kujtosh shkallët ku i ngjite dhe se me kë i ngjite! Ka ar-

Berisha-Ristani:

"Ngrihet Byroja Socialiste e Hetimit, Rama një kryehetues"

— Ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, e ka cilësuar si antikushtetuese ngritjen e Byrosë Kombëtare të Hetimit, duke u shprehur se "Aleanca e Qelbësirave" ngriti Byronë Socialiste të Hetimit dhe se Rama shpallet kryehetues i Shqipërisë". Përmes një postimi në Facebook, ai shprehet se Byroja Kombëtare e Hetimit do të jetë një institucion paralel me Prokurorinë e Përgjithshme, duke shtuar sipas tij se kjo nuk është asgjë më shumë se hetuesia e dyshes Rama-Meta. Sipas tij, kjo është antikushtetuese, dhe nuk ekziston në asnjë vend të botës. "Parlamenti i krimit votoi ditën e fundit të punimeve, ligjin për ngritjen në kundërshtim flagrant me Kushtetutën e vendit, të ashtuquajturës Byro Kombëtare e Hetimit,



që de facto është hetuesia e PS, e cila do funksionojë si pushtet paralel i institucioneve kushtetuese të zbatimit të ligjit. Ky model nuk ekziston në asnjë vend të botës së lirë dhe sipas këtij ligji, kreu i ekzekutivit, në rastin konkret neo-blokmenei Edvin Kristaq Rama, bëhet dhe kryehetues i Shqipërisë, duke i marrë kompetencën kushtetuese Prokurorit të Përgjithshëm të vendit", tha Berisha. Ai tha se pakënaqësinë ndaj ngritjes dhe Prokurorit, Rama po e shpreh duke u marrë kompetencat. Ndërkohë që për të e vetmja rrugë është "Rama ik". Ndërkohë që dhe deputeti Ristani është shprehur se Byroja Kombëtare e hetimit është anti-kushtetuese dhe se s'do lejohet instalimi i oligarkisë Rama-Meta

dhur koha të mendosh se nesër nuk do jesh aty ku je sot!

Si mendoni se do të realizohet zbardhja e vrasjes së Hajdarit dhe dërgimi para drejtësisë të të gjithë atyre që kanë marrë pjesë në ekzekutimin e tij politik...?

Në lidhje me zbardhjen e vrasjes së deputetit Azem Hajdari, mund të them që i vetmi njeri që mund ta bëjë publikisht para gjithë shqiptarëve është sot kryetari i Parlamentit Ilir Meta, i cili mund ta bëjë këtë kërkesë para të gjithë deputetëve. Prej aty të shikojnë vetë shqiptarët moralin, burrërinë dhe implikimin e gjithsecilit deputet. Pra këtë kërkesë ia bëjmë sot publikisht zotit Ilir Meta si ish Dhjetorist dhe shqiptarët kudo në botë do të jenë mirënjohës përjetë. Në të kundërt ju tregoni se kur deklaruar si kryeministër që të arrestohen vrasësit e vrasësve të Azem Hajdarit, gabuat apo u nxituat? Edhe njëherë Shoqata "Azem Hajdari" ju thotë ballëhapur të gjithë shqiptarëve se Azemin nuk e falim dhe se nuk ka Zot që të na ndalë deri në zbardhjen e çështjes dhe se nuk do lejojmë askënd ta përdorë këtë çështje për politikën e saj personale. Ju garantojmë se kjo çështje do të rihapet dhe nuk do të mund t'i shpëtojë askush nga organizatorët e vrasjes së shekullit drejtësisë, e për t'i dërguar te zyrat luksoze të Jahos, mikut te tyre politik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMEVE



TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit:

"Furnizim dhe vendosje mbrojtëse nga dielli, grila "Roman" dhe perde për kompleksin e ri të Bankës së Shqipërisë".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i Hapur Kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 14.994.000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: ish-Hotel Dajti, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel. 04 22 35 576, çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00, nga çdo person i autorizuar me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraparakisht pagesën e pakthyeshme prej 2.000 lekësh, në Sektorin e Financës të Bankës së Shqipërisë, që ndodhet në adresën: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla B.

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 28 Gusht 2014, ora 11.00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

» BASHKITE

QEVERIA pas hyrjes në fuqi të ndarjes së re territoriale do të nisë dhe organizimin për strukturat e menaxhimit të fondeve

Reforma territoriale ndryshon skemën e marrjes së fondeve

Ndarja me 61 bashki sjell decentralizimin e pushteteve. Gara për thithjen e fondeve kërkon struktura të posaçme

BRAHIM SHIMA
TIRANË

Reforma e re territoriale do të ndryshojë formën e marrjes së fondeve prej pushtetit vendor. Por po ashtu dhe strukturën e shërbimeve dhe investimeve. “Tani do kemi bashki më të mëdha, më të fuqishme, me kapacitete më të shtuara, por edhe me më shumë para dhe fonde, edhe nga qeveria, por edhe shumë fonde që çlirohen nga kursimet e reformës”, u shpreh zv/kryeministri Niko Peleshi në një takim të zhvilluar dje në Elbasan. Sipas tij, secila nga 61 bashkitë e vendit, pas ndarjes së re territoriale, do të kenë një llogari të veçantë tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit, për të financuar kapacitetet projektuese të tyre. Ndërkohë që krijimi i këtyre strukturave do të bëjë

të mundur që pushteti vendor të konkurrojë për grante në Bashkimin Evropian. Tashmë Shqipëria do të ketë mundësinë të aplikojë në të pestë komponentët e financimit të BE-së. Plus këtyre financimet për të 61 bashkitë do të vijnë dhe nga Buxheti i Shtetit.

Përsa i përket granteve, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Fondi i Zhvillimit të Rajoneve janë dy mekanizma të qeverisë për të mbështetur zhvillimin lokal. “Këtë vit ne e rritëm shumë mbështetjen

FONDET

Rishikimi i ndarjes administrative do të sjellë dhe një ndryshim të strukturave të përpunimit dhe paraqitjes së projekteve për financime

për qytetet. Të gjitha qytetet kryesore të Shqipërisë, në zonat me potencial turistik, në total u investuan nga qeveria 100 milionë dollarë këtë vit. Të dy këto organizma do të jenë akoma më të

Opozita

Ende asnjë vendim për të kundërshtuar ndarjen

— Opozita nuk ka marrë ende një vendim se si do të veprojë mbi hartën e re administrative. Burimet kanë bërë të ditur se më parë do të pritet firma nga kreu i shtetit për të kaluar më pas në një vendim konkret. Nga ana tjetër krerët e pushtetit vendor kanë kërcënuar për zhvillimin e referendumeve. Por për këtë afatet kushtëzojnë zhvillimin për shkak të afërimit të zgjedhjeve vendore. Por përplasja pritet të jetë më e ashpër mes mazhorancës dhe opozitës në shtator. Kjo pasi dhe ankimi në gjykatën kushtetuese nuk mbetet variant i përjashtuar. Por se gjithnjë është i fundit si shkak i procedurave që do të ndiqen nga firma e kreut të shtetit dhe deri në një votim të dekreteve në parlament, gjithnjë nëse presidenti e refuzon. Por një tjetër diskutim mes opozitarëve ka qenë dhe bojkotimi i zgjedhjeve vendore. Kjo pasi harta e re administrative është parë si një ndarje elektorale dhe llogaritje votash prej mazhorancës. Ndërkohë që në Kuvend nuk u morën parasysh as propozimet e krerëve të komunave të vogla, por dhe as propozimi i opozitës për nisjen e reformës nga ndryshimi i ligjit dhe më pas në llogaritjen se cila nga zonat administrative duhet të shkinet e se cilat do të qëndrojnë



VIDEO/ NIKO PELESHI DUKE FOLUR MBI NDARJEN E RE TERRITORIALE



Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas

fuqishme tani me bashkitë e reja. Një nga problemet që kanë bashkitë tona janë kapacitetet për projekte. Duke filluar nga buxheti i këtij viti ne do të hapim një llogari për secilën prej 60 e ca bashkive të reja tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit për të financuar projektimin”, tha Peleshi.

Në një takim me banorë të fshatit Letan, Zëvendëskryeministri diskutoi mbi përfundimin e reja të ndarjes së re territoriale duke shtuar fon-

zëvendëskryeministri Niko Peleshi, gjatë inaugurimit të përfundimit të punimeve të rrugës Balëz-Letan, në Komunën Bradashesh të El-

BUXHETET

Bashkitë do të konkurrojnë ndërmjet tyre dhe në fondet e posaçme të zhvillimit të rajoneve. Ndërkohë dhe kompetencat shkojnë drejt decentralizimit

det. Sakaq, kryetari i Bashkisë së Elbasanit, Qazim Sejdimi i pranishëm në këtë inaugurim u shpreh ndarja e re territoriale e vendit do të sjellë dhe decentralizimin e kompetencave. Deklarata erdhi nga

basanit; një zonë e njohur për potencialin e saj turistik dhe bujqësor. “Ajo që u bë me këtë reformë administrative shpresoj që do të japë një impakt shumë të madh. Nuk është thjesht një bashkim mekanik, për mua që kam qenë partizan i kësaj pune, por shpresoj që do të kemi edhe decentralizimin e kompetencave dhe do të japë një zhvillim shumë të madh”, tha Sejdimi.

Propozimi për diplomat në Spanjë

Dokle: Nuk e lë mandatin e deputetit për ambasador

— Kalimi si ambasador i Shqipërisë në Spanjë, nuk është opsion i pranueshëm prej deputetit të Partisë Socialiste Namik Dokle. “Nuk është e vërtetë. Edhe po të më propozohet ky post ambasadori, nuk do ta pranoja, sepse ndjej akoma detyrimet ndaj zgjedhësve të mi dhe partisë të cilës i jam përkushtuar që nga dita e parë e themelimit të saj”, tha Dokle dje për gazetën “Shqiptarja.com”. Emri i deputetit të PS-së u fol si kandidat i mundshëm për zëvendësimin e Kastriot



Robos, të cilit i ka përfunduar mandatin. Megjithatë duket se ish-kryetari i parlamentit, tashmë deputet i PS-së nuk do të pranojë të lërë mandatin, për rolin e diplomatit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTRI

SHPALLJE KËRKËSE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastruktura shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të pajualtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Dalja Ura e Vashës-Bulqizë”.

Subjekti i kërkesës, i këtij objekti, është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në mesazh të vlerësimit të llogarit, në bazë të Vendimit nr.138, datë 23.03.2000 të Këshillit të Ministrave. “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërdimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkalidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi

i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentat përkatëse në Ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastruktura).

Ky publikim bëhet vetëm për pasuritë e llojit: objekte.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimit pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë parqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti i kërkesës në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 3 988 061 (tremilion e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëdhjetë e një) lekë.

LISTA E PRONAREVE TE OBJEKTEVE QE PREKEN NGA NDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “DALJE URA E VASHES-BULQIZË”

Nr.	Nr. Pasurisë	Emri - Atësisë - Mbiemri	Nr. Z. Kad.	Vlera LEKE	Lloji i objektit	Shënime
1	153/4	Sadik Hasan Alla	2982	521.711	Banësë e rënuar	Konfirmuar nga ZVRPP
2	31/4	Bp. Zelihe Kuka	2982	731.174	Banësë e rënuar	Konfirmuar nga ZVRPP
3	31/3	Hike Miftar Jauri	2982	447.260	Banësë e rënuar	Konfirmuar nga ZVRPP
4	152/2	Hysen Mehmet Tafa	2982	2.287.916	Banësë 2kt	Konfirmuar nga ZVRPP
SHUMA TOTALE				3.988.061		

Emrat e kandidatëve për kryetar kaluan në proces të përsheptuar

Lulzim Basha mbyll zgjedhjet në PD e Tiranës

Kreu i opozitës akuzon PS-LSI për marrëveshjen me CEZ

JUXHIN MUSTAFARAJ
TIRANË

Partia Demokratike pritet të mbyllë të hënën procesin zgjedhor në të gjithë degët. Kryetari i demokratëve ka marrë pjesë në të gjitha konferencat e degëve, ku dhe ka monitoruar procesin e votimit. Ndërkohë që është vënë re kandidimi i emrave të cilët nuk kanë qenë më parë në postet drejtuese të selisë blu. Gjithsesi në qendrimit e dhëna në takimin me delegatët Basha është shprehur ndaj koalicionit PS-LSI. Ndërkohë që dhe debate mbi ligjet e votuara në parlament janë bërë pjesë e fjalimeve në këto konferenca, duke realizuar kështu një debat thuajse në distancë mes mazhorancës dhe opozitës. Por se dhe vetë zgjedhjet brenda demokratëve nuk u kanë shpëtuar replikave. Kështu përfshirja në garë e ish-aleatëve të vegjël, apo dhe nxitimi i daljes së kandidatëve ende pa u zgjedhur delegatët janë parë me skepticism nga palët. Nga zgjedhjet e degëve të Partisë




Demokratike, nr 8, 9 dhe 4 në Kryeqytet Lulzim Basha hodhi akuza ndaj qeverisë duke e cilësuar si promovuese të kimit, që sipas liderit së të dhatës u faktua më së miri me marrëveshjen me CEZ. "Siç po bëhet përditë e më e qartë për shqiptarët nga dysjia Rama-Meta, nuk kanë tjetër parim apo vlerë në themel të ekzistencës së tyre politike,

përveç promovimit të kimit, ardhjes së kimit në krye të administratës, futjes së kimit në Parlament, vjedhjes ditën për diell të 3 miliardë dollarëve, pasuri të shqiptarëve, me marrëveshjen famëkeqe të CEZ-it" – u shpreh kreu i PD. Kryetari Basha kërkoi nga të zgjedhurit e PD-së që të reflektojnë në vlerësimin e kontributit dhe meritës dhe nga



Kandidatët

Emrat e kandidatëve të përfshirë në garën e demokratëve kanë qenë jashtë radhëve të drejtuesve të selisë blu



Përplasjet

Përfshirja e aleatëve të vegjël si dhe dalja e konkurrentëve para zgjedhjes së delegatëve janë parë me rezerva nga anëtarët

ana tjetër, në kundërvënien e vlerave të së djathtës me antivlerat e promovuara nga mazhoranca

"Në këtë parti, liria e fjalës, liria e mendimit, liria e vendosjes me votë u sanksionua që në ditët e saj të para. Unë jam i vendosur dhe po e fakttoj dita – ditës bashkë me ju, se këtë parti do ta bëjmë më të madhe, më të fuqishme, më të

dashur dhe më të besueshme, duke e konsoliduar edhe më shumë lirinë e vendimmarrjes nga sovran në PD që është dhe do të jetë këtë e tutje, anëtar dhe anëtarja e PD", - deklaroi z. Basha.

Sipas Bashës anëtarë dhe anëtarja si dhe vota e tyre e lirë duhet të jenë themeli i vendimmarrjes në Partinë Demokratike

LAJME
shkurt

Kuvendi me pushime, PD vijon akuzën ndaj Ndokës

— Edhe pse Kuvendi ka nisur pushimet, demokratët kanë vijuar me akuzat ndaj deputetit Arben Ndoka dhe heshtjes së Ramës ndaj rrarjes së Gent Strazimirit. Radha për deklaraten në media ka qenë e deputetes Lili-ana Elmazi e cila tha se Rama inskenoi në Parlament goditjen fizike dhe kërcënimin me jetë të opozitës. "Akti banditesk ndodhi në godinën e Kuvendit dhe, Edi Rama prej 23 ditësh nuk mban asnjë përgjegjësi, hesht dhe bën të paditurin. Kur çdo qytetar në vend mësoi me prova e fakte se Edi Rama ka inkriminuar parlamentin me persona të dënuar për vepra të rënda penale, përti përdorur ata si skuadër dhune ndaj opozitës, mbarë opinioni publik u trondit. U trondit opinion publik nga fakti se deputeti i Edi Ramës, Arben Ndoka, ishte dënuar për shfrytëzim prostitucioni dhe rrëmbim personi. Vetëm Edi Rama nuk reagoi, a thua sikur gjithçka ishte normale dhe kishte dënuar sipas planit", deklaroi deputetja e PD-së.



Gruevski: Nuk do cenohen marrëdhëniet ndëretnike

— Kryeministri i Maqedonisë, Nikola Gruevski I ka cilësuar "provokatorë të imët" protestuesit, ndërsa është shprehur se nuk do të lejojë që ata të cënojnë marrëdhëniet ndëretnike. "Dua të përcjell mesazh te ata që i sfidojnë marrëdhëniet ndëretnike. Ky nuk është 200-shi, as që mund të jetë. Ejani bashkërisht të tregojmë se mund të jetojmë në harmoni. Ne nuk do të lejojmë që provokatorë të imët, që i dimë shumë mirë se kush janë, të nxisin marrëdhëniet ndëretnike", tha Gruevski. Ndërsa ka shtuar "ne jemi maqedonas dhe flasim gjuhën maqedonase, kemi kulturën tonë autentike maqedonase dhe nuk kemi asnjë pretendim ndaj Greqisë ose ndaj çilido fqinji tonë, as që duam të dëmtojmë dikë. Duam paqe, liri, prosperitet për të gjithë qytetarët. Duam drejtësi", tha Gruevski.

Diplomati i SHBA

Senati shtyn mandatin e ambasadorit Arvizu në Tiranë

— Ambasadori i SHBA-së në Shqipëri Aleksandër Arvizu do të vijojë të qëndrojë në detyrë. Edhe pse mandati i tij ka më shumë se një vit që ka përfunduar, fundi i këtij viti mund ta gjejë atë ende në Tiranë. Kjo pas bllokimit që republikanët i bënë në mbledhjen e së Premtes, emërimit të ambasadorëve amerikanë në botë, ku përfshihet dhe Donald Lu që do të vijë në Tiranën zyrtare në vend të kryediplomatit Arvizu. I vetmi që mori konfirmimin e senatit ishte Xhon Teft, ambasadori i SHBA në Moskë, post i cili ishte vakant prej 5 muajsh. Kanë qenë republikanët që bllokuan miratimin e ambasadorëve të propozuar nga presidenti Barak Obama, përveç Teft. Bëhet fjalë për një hakmarrje nga ana e republikanëve ndaj rregullave të reja të vendosura nëntorin e kaluar që i heqin të drejtën opozitës për të penguar emërimin e



funksionarëve të gjykatës, që nuk kanë mbështetjen e së paku 60 senatorëve. Që pas miratimit të këtyre dispozitave, senatorët republikanë kanë nisur të pengojnë në mënyrë masive emërimin e ambasadorëve të propozuar nga presidenti. Kështu, ndërkohë që mandati i ambasadorit Arvizu në Tiranë ishte drejt fundit, Obama caktoi në vend të tij Donald Lu. Por, me shumë gjasa Arvizu do të qëndrojë në Tiranë edhe për disa muaj.

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

FTESE PËR OFERTË

1. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, zhvillon procedurën konkurruese për dhënie me qira të sipërfaqes së tokës prej 120.84 ha, Qarku Korçë.
2. Subjektet e interesuar mund të kërkojnë informacion për procedurën konkurruese, pranë Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Person kontakti: Lauresha Grezda, email: lauresha.grezda@bujqesia.gov.al.
3. Ofertuesit të paraqesin vetëm një ofertë, ku të angazhohen se pranojnë kushtet e përcaktuara në ftesën për procedurë konkurruese dhe detyrimet që rrjedhin nga fitimi i procedurës konkurruese. Shpenzimet e kryera për të marrë pjesë në procedurën konkurruese nuk rimbursohen nga Autoriteti Qiradhënës.
4. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumenta ligjorë dhe administrativë origjinalë ose kopje të noterizuar, si provë e kërkesave kualifikuese të përcaktuara dhe të dorëzohen në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Adresa Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 2 – Tiranë.
5. Vlera fillestare e qirasë së tokës bujqësore në pronësi të shtetit për hapjen e procedurës konkurruese është **16,915 lekë/ha/vit** (gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqindpesëmbëdhjetë). Ofertat me vlerë më të ulët se kjo vlerë fillestare do të skualifikohen.
6. Sigurimi i ofertës, që është në shumën prej 170.334 (njëqindtëdhjetë e tre mijë e treqindtëdhjetë e katër) lekë, të dorëzohet së bashku me ofertën.
7. Asnjë ofertues nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e konkurimit në bazë të shtetësisë.
8. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data **01.09.2014, ora 11:00**.

Ofertat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen. Ofertat do të hapen në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në Sallën e Mbledhjeve, Kati i Dytë, datë 01.09.2014, ora 11:00.

Përfaqësues të ofertuesve janë të ftuar të ndjekin hapjen e ofertave.

Huatë**GENC KONDI**
TIRANE

Afro 202 milionë euro ka arritur të sigurojë, në formën e borxhit të jashtëm, ministria e Financave gjatë tre muajve të dytë të vitit, prill-qershor. Sipas statistikave të Drejtorisë së Borxhit pranë këtij dikasteri, kanë qenë katër financuesit e qeverisë shqiptare për këtë periudhë të vitit ndër institucionet financiare ndërkombëtare, të cilët kanë ofruar në total një shifër të tillë.

BANKA BOTËRORE

Në përputhje me marrëveshjet e karakterit politik, të lidhura midis qeverisë shqiptare dhe Bankës Botërore, ka qenë një ndër institucionet e rëndësishme financiare të grupit të BB që ka ofruar dy hua për qeverinë. Fjala është për IBRD, Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim e Zhvillim, që ofron huanë e parë në favor të zhvillimit të Financave publike shqiptare. Kjo është në shumën 87 milionë euro, kësti i parë do të fillojë të paguhet në datë 1 shtator të vitit 2021 dhe e gjithë huaja duhet të likuidohet brenda 1 marsit të vitit 2037. Kështu, huaja është me maturim 23-vjeçar, ndërkohë që shtatë

Kreditë e marra nga qeveria shqiptare në periudhën qershor-gusht 2014

FINANCUESI	SHTETI	PROJEKTI	SHUMA	VALUTA	KËSTI I PARË	KËSTI I FUNDIT	DIKASTERI PËRFITUES
■ UniCredit Bank	Austria	Furnizimi me ujë Peshkopi	4,000,000.00	EUR	30/06/2022	30/06/2033	Ministria e Transportit
■ IBRD	Banka Botërore	Huaja e parë në zhvillimin e financave publike	87,000,000.00	EUR	1/9/2021	1/3/1937	Ministria e Financave
■ IBRD	Banka Botërore	Modernizimi i politikave të sektorit financiar	72,600,000.00	EUR	1/9/2021	1/3/1936	Ministria e Financave
■ IDB	Institucion Financiar	Projekti Mikrofinancë	1,000,000.00	USD	31/12/2017	30/06/2024	Ministria e Financave
■ IDB	Institucion Financiar	Projekti Mikrofinancë	2,670,000.00	USD	31/12/2017	30/06/2024	Ministria e Financave
■ UniCredit Bank	Austria	e-shëndetësi	13,995,000.00	EUR	31/08/2022	28/02/2032	Ministria e Shëndetësisë
■ BEI	Institucion Financiar	By-passi Vlorë	18,000,000.00	EUR	30/12/2019	30/12/2029	Ministria e Transportit
■ UniCredit Bank	Austria	Modernizimi i arsimit	3,500,000.00	EUR	31/05/2022	30/11/2031	Ministria e Arsimit

Qeveria siguron 202 mln € në tre muaj nga ndërkombëtarët

Kredi për buxhetin, arsimin, shëndetësinë, rrugë e ujë

vitet e para pala shqiptare nuk duhet të paguajë detyrim. Kjo shumë shkon në favor të Ministrisë së Financave në formën e mbështetjes për buxhetin e shtetit, pas konstatimit të borxhit të konsiderueshëm publik ndaj sipërmarrjeve private në kohën e mandatit të dytë të qeverisë Berisha.

E njëjta banka, IBRD, ka ofruar tashmë edhe një hua të dytë në vlerë 72.6 milionë eurosh gjatë tremujorit të dytë të vitit, që duhet të nisë të paguhet më 1 shtator të vitit 2021 për të përfunduar më 1 mars të vitit 2032.

Pra, me një periudhë "grace" gjithashtu 7-vjeçare dhe me afat 18-vjeçar shlyerje.

Të dy huatë konsiderohen me terma të butë nisur nga afati i gjatë i pagesës së detyrit nga shteti shqiptar.

ISLAMIKËT

Banka Islamike për Zhvillim (IDB) ndërkohë ka kontribuar në arkën e shtetit shqiptar me dy hua, por me të njëjtin projekt: mbështetje për mikrofinancimin. Fjala është për një institucion financiar me bazë në Arabinë Saudite që ka investuar financiarisht edhe në projekte të infrastrukturës kohët e fundit, të tilla si segmenti Tiranë-Elbasan, ai Qukës-Qafë Thanë, etj. Të dy huatë jepen me afat 7-vjeçar dhe duhet të shlyhet që të dyja në ditë të njëjta: nga 31 dhjetori 2017 deri më 30 qershor 2024; e para me vlerë 1 milion dollarë dhe e dyta 2.67 milionë dollarë.

EVROPIANËT

Banka Evropiane e Investimeve, nga ana e saj, ka akorduar gjatë kësaj periudhe 18 milionë euro për By-Passin e Vlorës. Pagesa është parashikuar nga fundi i vitit 2019 deri në fund të 2029-ës. Kurse austriakja Unicredit

**Statistikat**

Sipas Drejtorisë së Borxhit pranë Financave, kanë qenë katër financuesit e qeverisë shqiptare për tremujorin e dytë të vitit ndër institucionet financiare ndërkombëtare

Afatet

Bie në sy se periudha, gjatë së cilës Shqipëria nuk paguan interesa është rreth shtatë vjet, ndërkohë që shlyerja do të kryhet për shumë kohë, deri në mes të vitit 2032

Banka financon tre projekte: 3.5 mln euro për modernizimin e arsimit, afro 14 mln të tjera për e-shëndetësi dhe

4 mln euro për zgjidhjen e furnizimit me ujë të Peshkopisë. Pagesat, nga mesi i 2022, deri në vitin 2032.

Denoncimi

KLSH çon 10 zyrtarë të ALUIZNI Elbasan në Prokurori

— Kontrolli i Lartë i Shtetit ka bërë dje 10 kallëzime penale, për ish-drejtorin e ALUIZNI-t të Elbasanit dhe 9 ish-përgjegjësja sektori. Përmes një deklarate për media, KLSH bëri me dije se ata akuzohen për kryerje të legalizimeve të jashtëligjshme. Gjatë kontrollit rezultoi se bëhet fjalë për 182 subjekte me



diferencë në parcelat ndërtimore, brenda Studimin Urbanistik të Qendrës së qytetit Elbasan, në zonat e gjelbëruara pronë e bashkisë Elbasan, brenda brezit mbrojtës të hekurudhave, brenda ose pranë vijës së ndërtimit të strukturës së rrugës dhe kanaleve kullues, si dhe të pavetëdeklaruar, me një dëm ekonomik ndaj Buxhetit të Shtetit në vlerën 412 milionë lekë ose 4 milionë dollarë. Zyrtarët kanë dhënë OK për parregullsi në plotësimin e dosjeve, duke legalizuar objekte në kundërshtim me ligjin në 167 raste për sipërfaqen prej 47.583.83 m2, në vlerë 412,442,529 lekë duke shkaktuar dëm ekonomik si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit, për fondin e kompensimit të ish-pronarëve.

Vodafone Albania njofton se duke filluar nga data 8 Gusht 2014:

• Për klientët e planit tarifor me parapagesë Vodafone Club dhe Vodafone Card koha fillestare e tarifimit për thirrjet drejt destinacioneve kombëtare dhe ndërkombëtare është 60 sekonda. Pas 60 sekondave të para të një telefonate aplikohet çmimi për sekondë.

**BUJQËSIA**

67 kontrata e licensa drejt anulimit



— Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave njofton se ka ngritur një Task Force për verifikimin e licensave dhënë për subjekte të peshkimit detar, ujërave të brendshme dhe akuakulturës, si dhe kontratat e tokave bujqësore. Nisin kështu procedurat për anulimin e 22 licensave të peshkimit dhe 45 kontratave për tokat bujqësore. Pas verifikimeve, janë konstatuar se ka pasur probleme, si me procedurat e dhënies së licensave të peshkimit dhe lidhjes së kontratave për tokat bujqësore, ashtu edhe me zbatueshmërinë e tyre. Për këtë arsye, ministri Edmond Panariti ka urdhëruar fillimin e procedurave për anulimet.

Matura

SONILA ISAKU
TIRANE

Të hënën maturantët në të gjithë vendin do të nisin plotësimin e formularit A2, sipas një grafiku të përcaktuar nga Ministria e Arsimit. Formularin me dhjetë preferenca do të plotësojnë të gjithë ata maturantët të cilët kanë rezultuar kalues në provimet e Maturës Shtetërore. Sa i përket fituesve, përcaktimi do të bëhet sipas parimit Meritë – Preferencë, ku parimi i meritës përcaktohet sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të Maturës Shtetërore (të detyruara dhe me zgjedhje) dhe për programe studimi të caktuara, edhe sipas rezultateve të arritura në konkurs. Kurse parimi i preferencës përcaktohet nga vullneti i kandidatëve, i shprehur nëpërmjet jo më shumë se 10 preferencave të zgjedhura prej tyre. "Maturanti mund të arrijë nivelin e fituesit në disa programe studimi të përzgjedhura prej tij, por sistemi e shpall atë fitues në preferencën më të lartë të shprehur prej tij. Kjo është arsyeja që në plotësimin e formularit A2 është shumë e rëndësishme jo vetëm përzgjedhja e programeve të studimit (preferencat), por dhe renditja e tyre", thuhet në njoftimin zyrtar të MAS. Por gjatë plotësimit të formularit maturanti duhet të bëjë kujdes jo vetëm në për-

Del formulari A2 ja si duhet të plotësohet

Maturantët do zgjedhin 10 preferencat e tyre

Afatet sipas zonave për plotësimin e formulari A2

DATE

APLIKANTET NE QYTETET

04.08.14	Tirana Qytet	Tirana Qark							
05.08.14	Tirana Qytet	Tirana Qark							
06.08.14	Tirana Qytet	Tirana Qark	Kamëz	Kavajë	Durrës	Krujë			
07.08.14	Elbasan	Peqin	Gramsh	Librazhd	Korçë	Pogradec	Kolonjë	Devoll	
08.08.14	Fier	Mallakastër	Lushnjë	Berat	Kuçovë	Skrapar			
09.08.14	Shkodër	Malësi e Madhe	Pukë	Lezhë	Kurbini	Mirditë			
10.08.14	Vlorë	Sarandë	Delvinë	Gjirokastër	Tepelenë	Përmet			
11.08.14	Kukës	Has	Tropojë	Dibër	Mat	Bulqizë			

zgjedhjen e jo më shumë se 10 preferenca, por një element mjaft i rëndësishëm është dhe renditja e tyre sipas shkallës së plotësimin të dëshirës personale për ndjekjen e studimeve të larta. Nuk është e domosdoshme që të jenë përzgjedhur 10 preferenca, por për të rritur probabilitetin e fitimit të një të drejte studimi, është e këshillueshme që të zgjidhen sa më shumë preferenca, deri në 10. "Kriteri i vetëm që e shpall një maturant fitues në një degë është kriteri i Meritës, pra sasia e

pikëve të grumbulluara në një program studimi të përzgjedhur. Preferenca është kriter kualifikues brenda përbrenda përzgjedhjeve të një maturanti. Kjo do të thotë që nëse maturanti X kapërcen pikët e fituesit të fundit në disa programe studimi të përzgjedhura nga ana e tij, sistemi e shpall fitues në preferencën më të lartë të këtij grupi preferencash. E thënë ndryshe një fitues i një programi studimi mund ta ketë rreshtuar si preferencë të dhjetë atë

program, por ai fiton ndaj një maturanti tjetër që e ka preferencë të parë, për faktin se ka grumbulluar më shumë pikë", përcaktohet në udhëzi-

min e MAS. Ndërkohë maturantët të cilët do të zgjedhin degë të tilla si, arkitekturë, sport apo arte duhet t'i nënshtrohen konkurseve. Këta

maturantë që marrin pjesë në konkurse pranimi, që të rrisin mundësinë e fitimit të atij programi duhet ta vendosin si prioritet të parë.

Në faqen zyrtare të MAS maturantët gjejnë:

- Formularin A2
- Listat e programeve të studimit me kuotat përkatëse
- Formulën e llogaritjes së pikëve
- Koeficientet e profileve të shkollave të mesme për çdo program studimi të ofruar nga IALP
- Koeficientet e lëndëve me zgjedhje për çdo program studimi të ofruar nga IALP
- Udhëzimin teknik për aplikimin online me formularin A2
- Planin kalendar i aplikimit sipas Dar/Za-ve
- Pikët e fituesit të fundit të vitit të kaluar që nga maturantët do të merren vetëm si referencë orientuese.

Bizneset

Fondi i punësimit, 224 milion lekë për 360 kompani

— Ministria e Mirëqenies Sociale këtë vit ka ndarë një fond prej 2.7 milion dollarë për nxitjen e punësimit, nga i cili përfitojnë bizneset që punësojnë më shumë persona të papunë të regjistruar në zyrat e punës. Aktualisht vetëm 224 milion lekë janë ndarë për rreth 360 sipërmarrje, të cilat iu nënshtroan konkursit. Kompanitë fituese do ta përfitojnë atë me kështu dhe menaxhimin e fondit kryhet nga Shërbimi Kombëtar i Punës. Drejtori i këtij institucioni, Genc Kojdheli sqaron se nëse bizneset, që kanë marrë para nga fondi i punësimit do të shkelin kriteret do t'u hiqet e drejta për të përfutur kështu e tjera të fondit. Ndërsa pjesa tjetër e mbetur e fondit, e cila rrezikonte të digjej është rialokuar. Industria e fasonerisë, ajo e ndërtimit, e shërbimeve, por edhe bizneset e vogla kanë qënë përfuturës kryesorë. Nëse kompanitë nuk do të plotësojnë kriteret e vendosura nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, atyre do t'u hiqet e drejta e marrjes së



fondit i cili shpërndahet në mënyrë periodike" pohon Kojdheli. Një tjetër fond shtesë është parashikuar për bizneset, që do të punësojnë disa grupe të veçanta, si personat me aftësi të kufizuara, gra dhe të rinj të komunitetit rom.

BRITISH AMERICAN
TOBACCO

British American Tobacco Albania sh.p.k.

Njofton se duke filluar nga data 4 Gusht 2014, çmimet e reja maksimale të shitjes me pakicë për produktet e saj të duhanit do të jenë si vijon:

MARKA	Çmimi maksimal/pa ketë i shitjes me pakicë	MARKA	Çmimi maksimal/paketë i shitjes me pakicë
KENT Nanotek (Infina)	270	Lucky Strike Click & Roll	230
KENT HD Futura	270	Lucky Strike Red	210
KENT HD (6mg katran)	270	Lucky Strike Silver	210
KENT HD Neo	270	Lucky Strike Red 10 cigare	110
KENT HD Infina	270	Lucky Strike Silver 10 cigare	110
KENT Convertibles	270	Rothmans International	280
KENT Demislims Spectra	250	Rothmans Leggera	200
KENT Demislims Neo	250	Rothmans of London (Blue)	170
KENT HD Neo 10 cigare	130	Rothmans of London (Sky Blue)	170
KENT HD Infina 10 cigare	130	Rothmans of London (Silver)	170
Lucky Strike Additive Free (Red)	230	Peter Stuyvesant Blue	220
Lucky Strike Additive Free (Blue)	230	Peter Stuyvesant Silver	220

*Çmimet shprehen në Lek

Njoftimi i mësipërm bëhet në përputhje me pikën 9.5.3 (ç) të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 17, datë 13.05.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar.

British American Tobacco Albania sh.p.k.
Tirane, Rr: "Kavajes", ish Kombinati Ushqimor
web: www.bat.com
office phone: +355 (0) 42 255084

PUNONJËSJA e kompanisë së sigurimeve e kallëzoi në polici, pas fejesës që bërë me një mashkull tjetër. Marios Dimopoulos kërkonte zemrën e shqiptares.

Tradhëtia

Në pamundësi për ta takuar në punë, Marios Dimopoulos ka shkuar deri në banesën e saj. Pikërisht në këtë vend, ai e ka parë B.T. në shoqërinë e një djali tjetër,



Gjykata e Tiranës

Faksimile e vendimit të Gjykatës së Tiranës



GERMANI

Kapen dy shqiptarë me 15 kg. kokainë në makinë

Greku përndiqte shqiptaren dënohet me gjashtë muaj burg

Historia e dashurisë në "FB" që përfundoi në qeli

ELTON QYNO
TIRANË

Një histori dashurie mes një shtetase shqiptare dhe një Greku, e lidhur në internet është kthyer në tragjedi për shtetasin grek Marios Dimopoulos. Ky i fundit pas shumë komunikimeve në "Facebook" me B.T., punonjëse e një kompanie sigurimesh në Tiranë. Pas disa takimesh të një pas njëshme në Tiranë, në muajin Prill shtetasja me inicialet B.T., i ka komunikuar në "Skype" se nuk mund të vazhdonin më takimet dhe s'mund të lidheshin, kjo për shkak të largësisë dhe tipit jo serioz të grekut Marios Dimopoulos. Pas këtyre fjalëve 39-vjeçari ka udhëtuar sërish nga Greqia në Shqipëri, ku kërkuar një takim urgjent me shtetasen Shqiptare. Në pamundësi për ta takuar në punë, Marios Dimopoulos ka shkuar deri në banesën e saj. Pikërisht në këtë vend, ai e ka parë B.T. nën shoqërinë e një djali tjetër, që ishte i fejuari i saj dhe menjëherë është larguar. Dy ditë pas kësaj, ai e ka pritur sërish poshtë pallatit, ku B.T. ka dalë dhe menjëherë ka shkuar në drejtim të saj, duke i kërkuar të flisnin. Por B.T. ka refuzuar dhe për pasojë është qëlluar në fytyrë nga shtetasi grek. Nisur nga kjo situatë, punonjësa e kompanisë së sigurimeve, ka bërë denoncim në polici, për akuzën e "Kanosjes" dhe "Përdjekjes", duke bërë që me pas shtetasi grek të arrestohet dhe në 29 korrik 2014 të dënohet me 6 muaj burg.

ARRESTIMI I GREKUT

Në datën 04 qershor 2014 rreth orëve të mëngjesit shtetasi Marios Dimopoulos është kapur në flagrancë nga forcat policie, afër vendit të punës të shtetasës B.T. duke përndjekur përsëri

këtë shtetase. Ky shtetas ka ardhur nga Greqia posaçërisht për të përndjekur shtetasen B.T. Po këtë datë është pyetur shtetasja B.T., e cila shpjegon se ndjekja nga ana e shtetasit Marios Dimopoulos ka qenë e vazhdueshme. Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se, shkaku për të cilin Mariosi e kërcënon B. është sepse ai i kërkon me forcë, që ajo të bëhet e dashura

e tij dhe të bëhen përsëri shokë siç kanë qenë më parë. Por, B.T. nuk pranon që të lidhet me të. Në këtë mënyrë, i pandehuri Marios kërkon me forcë që B. të ndryshojë mënyrën e jetesës, duke u rilidhur përsëri me të.

ARGUMENTI I PROKURORISË

Në pretendencën e tij prokurori Ervin Karanxha ka


theksuar se, çdo person në demokraci është i lirë të zgjedhë se me kënë person do të lidhet dhe me kënë jo. Në rastin konkret B. nuk do që të lidhet me të pandehurin Marios. Rrjedhimisht, ky i fundit nuk mund të kërcënohet e ta përndjekë B. për shkak se, kjo e fundit nuk e do atë dhe nuk do që të lidhet me të. Duke kryer veprimet e

mësipërme shtetasi Marios Dimopoulos ka konsumuar tërësisht elementët e veprës penale të "Përdjekjes", të parashikuara nga neni 121/a të K.Penal. Në këto kushte sipas prokurorit shtetasi grek duhet të dënohet me 1.6 vite burg. Kjo kërkesë është rrëzuar nga gjykata e cila e ka dënuar me vetëm 6 muaj heqje lirie.

Vinin për pushime në Shqipëri, aksidentohet familja në Kroaci

Viktimë ka mbetur Erjon Isufi bashkë me dy fëmijët

Ngjarja
KROACI



Familja e aksidentuar në Kroaci

Po ktheheshin tek të afërmit në Shqipëri, por përplasja me një kamion e makinës me të cilën udhëtonin 5 pjesëtarët e familjes Isufi, ka rezultuar fatale duke i marrë jetën kryefamiljarit dhe dy fëmijëve, ndërsa bashkëshortja Meri dhe djali më i vogël, Klivi, 9 vjeç janë plagosur dhe po marrin mjekim në spital. Klivi, mësohet se tashmë është në gjendje të qëndrueshme, ndërsa nëna e tij ndodhet në gjendje kome pas një operacioni në mëllci. Makina e zezë tip BMë, e cila drejtohej nga 37-vjeçari Isufi u përplas me një kamion në Slano të Kroacisë, rreth orës 08:00 të mëngjesit të 31

Korrikut. Ata ishin duke udhëtuar drejt Shqipërisë për të vizituar familjen, kur ndodhi përplasja e fuqishme me një kamion. Mësohet se miq të tyre udhëtonin në një makinë tjetër pas tyre, por fatmirësisht nuk janë përfshirë në përplasje. Miq, dhe shokë të familjes Isufi kanë vendosur lule para shtëpisë së tyre në Londër, ku familja jetonte prej vitesh. Fqinja e familjes, Ornella Zuguoli 37 vjeç, duke folur për mediet vendase,

tha se vetëm 4 orë para aksidentit fatal kishte marrë një mesazh nga mikja e saj Meri e cila e njoftonte se kishin mbërritur në Kroaci dhe ishin afër Shqipërisë. Ajo e përshkruan Merin, një person të mrekullueshëm e cila gjithmonë është gjithmonë pozitive dhe e qeshur, duke shtuar: Ne jemi si motra. Kam shumë kohë që njihem me të, ndoshta 10 vjet. Nuk mund ta besoj këtë që ka ndodhur, është e tmerrshme".

MAREN TUFA

Vrau pronarin e lokalit në gjyq autori

Prokuroria e Tiranës ka mbyllur hetimet dhe ka dërguar në gjykatë të pandehurin Maren Tufa, i cili është arrestohet për vrasjen e Elton Pojanit. Sipas akuzës shkak i kësaj vrasje ka qenë një konflikt për muzikën e lokalit, ku ishte duke konsumuar alkool autori i krimt. Sipas dëshmitarëve, Tufa gjatë orëve të mbërmjen së datës 8 mars 2014 pasi kishte konsumuar alkool kishte debatuar me pronarin e lokalit Elton Pojani, duke kërkuar ngritjen e zërit të muzikës. Por, pronari ka kundërshtuar me pretekstin se policia ia kishte tërhequr vërejtjen për ngritjen e zërit. Pas këtij kundërshtimi, Tufa ka debatuar me Pojanin, i cili ka kërkuar nga autori të largohet nga lokali Ai është larguar por më pas është kthyer duke qëlluar me thikë Pojanin dhe lënë të vdekur në vend.


I punësonin si mësues e s'i paguanin, 5 në gjyq

Fier, prokuroria padit 5 ish-zyrtarë të Arsimit Rajonal

ARTAN CENA
TIRANE

I merrnin në punë dhe më pas nuk i paguanin pasi ishin jashtë strukturës së miratuar. 5 ish-zyrtarë të Drejtorisë Rajonale të Arsimit janë dërguar në gjyq pasi akuzohen për shpërdorim detyre. Prokuroria e Fierit ka bërë të ditur se të pandehur janë: Miranda Bullati, ish-drejtores e Drejtorisë Arsimore, Ylli Malaj ish-shef Kuadri i Drejtorisë Arsimore, Tatjana Ferko, ish-specialiste e drejtorisë Arsimore, Suzana Nazëraj ish-specialiste në Drejtorinë Arsimore dhe Eliza Nako, ish-specialiste pranë Drejtorisë Arsimore në Fier. Në lidhje me këtë hetim ka reaguar edhe Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ministria Lindita Nikolla ka deklaruar se, "me këtë hetim vërtetohet abuzimet që kanë bërë

Punësimi
Këta zyrtarë kanë kontraktuar një numër më të madh mësuesish se sa ishte i limiti i miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës



Miranda Bullati

drejtuesit e kaluar të këtij institucioni".

ABUZIMET ME PUNËSIMIN

Kanë qenë disa prej të punësuarve dhe që nuk ishin paguar ata që kanë bërë edhe denoncimet. Pas disa muaj hetimesh, Prokuroria e Fierit e ka dërguar dje

për gjykim çështjen ndaj 5 zyrtarëve të DAR-it të këtij qyteti, të akuzuar për "shpërdorim detyre". Nga hetimi ka rezultuar se dy drejtues të lartë, drejtoresha dhe shefi i kuadrit dhe tre punonjës të tjerë të këtij institucioni, në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë regjistruar një numër të madh mësuesish



në listë-pagesa, në bazë të kontratave të rregullta, dhe nuk i kanë paguar. Po ashtu, rezultojnë se, me veprimet e tyre, këta zyrtarë kanë kontraktuar një numër më të madh mësuesish se sa ishte i limiti i miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës,

TË PANDEHURIT

- Miranda Bullati - ish-Drejtor i Drejtorisë Arsimore, Fier
- Ylli Malaj - ish-Shef Kuadri, Drejtorisë Arsimore, Fier
- Tatjana Ferko - ish-Specialist, Drejtorisë Arsimore, Fier
- Suzana Nazëraj - ish-Specialist, Drejtorisë Arsimore, Fier
- Eliza Nako - ish-Specialist, Drejtorisë Arsimore, Fier

Reagimi

Nikolla: Ish-zyrtarët e DAR kanë abuzuar

— Në lidhje e lajmin bërë publik nga prokuroria e Fierit ka reaguar edhe Ministria e Arsimit, Lindita Nikolla. Sipas saj, "Prokuroria e Fierit ka dërguar kërkesën për gjykim ndaj 5 ish-zyrtarëve të Drejtorisë Arsimore të këtij qarku". "Ky rast rikonfirmon edhe njëherë konstatimet e MAS se ish-drejtuesja e mëparshme e DAR Fier, së bashku me disa prej vartësve të saj kanë abuzuar dhe shkelur ligjin duke shpërdoruar detyrën e duke shkaktuar një dëm ekonomik dhe moral ndaj mësuesve, prindërve dhe nxënësve të qarkut Fier", ka deklaruar ministria Lindita Nikolla.

duke krijuar mbivendosje në pozicionet e punës dhe rrjedhimisht edhe pamundësi të pagesave të rrogës.

REAGIMI I MAS

Burime nga Ministria e Arsimit dhe Sportit kanë sqaruar dje se, ky është një fenomen

që është bërë para zgjedhjeve të 23 Qershorit. Sipas tyre në disa shkolla është gjetur numri i madh i mësuesve të cilët ishin mbi organikën e shkollave. Sipas ministrisë, hetimi ka faktuar abuzimet që janë bërë nga drejtuesit gjatë qeverisjes së kaluar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të logaritit në përputhje me V.K.M. nr.138, datë 23.02.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërbimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik" të ndryshuar dhe VKM nr.514, dt 30.07.2014 "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë"

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronës, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Kulturës.

Pronarët për të cilët është bërë shënim "Konfirmuar nga ZVRPP", do të likuidohen për efekt shpronësimit pas daljes së Vendimit të Këshillit të Ministrave që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 36,107,184 (tridhjetë e gjashtë milion e njëqind e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh.

LISTA E PASURIVE TË PALUAJTËSHME PRONË PRIVATE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM PËR INTERES PUBLIK, TË CILAT PREKEN NGA SHPRONËSIMI

Nr	Pronari	Zona kadas-trale	Nr. pasurie	Sipërfaqe		Çmimi Lekë/m2		Vlera Lekë			SHENIME
				Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtim	Truallit	Ndërtësë	Banësë	
1	Flutura Hasan Cela, Lijana Petro Sotiri, Naze Hasan Subashi, Qemal Gega, Vjollca Nagjeli Shtet	8280	2/8-ND		104		12445.712		1,294,354		Plotësim dokumentacioni
2	Hodo Vela Shtet	8160	7/11-N2		94.5		25769.968		2,435,262		Plotësim dokumentacioni
3	Rovan Limon Luku	8280	2/327	72m2	299.8	23955	43894.793	1,724,760	13,159,659		Blikuar në favor të UNION BANK
4	Persefoni Kristo Koka	8280	2/13	51m2	60.9	23955	23944.335	1,221,705	1,458,210		Konfirmuar nga ZVRPP
5	Majlinda Xhehajir Zalla Vipauto Sh.P.K. Vipauto Sh.P.K. Lionmax Konstruksion	8280	2/337 2/336 2/11 2/267	22.9m2 22.9m2 31.8m2 25.5m2	104.5	23955	65961.675	2,464,970	6,892,995		2/11 blikuar në favor të UNION BANK 2/336 Blikuar në favor të UNION BANK
6	Mak-Albania Sh.P.K. Shtet	8160	7/11-N3		140		34241.907		4,793,867		Plotësim dokumentacioni
7	Lijana Petro Sotiri Vjollca Rushit Angjeli Flutura Hasan Cela Qemal Lial Gega Shtet	8280	2/334-ND/2	40m2	48.9		13525.603		661,402		Plotësim dokumentacioni
8	Hodo Vela Shtet	8160	7/11-N4		0		0		0		
				-	852.6			5,411,435	30,695,749	-	36,107,184
TOTALI											Lekë



Bashkim Xhilaga



Dhimiter Davidi



Petrit Ramohitaj



Klevis Bejtaj



Lavdim Cani



Liljana Tusha



Myzejen Belba

» THESARI

Makina në thesar shfaqej pa targa, ja si u bë zbulimi

Nipi i Bitraj, Klevis Bejtaj hiqte targat e makinës kur priste dajën para thesarit

Hetimet

ELTON QYNO
TIRANË

Ardian Bitraj dhe nipi i tij Klevis Bejtaj, kishin zgjedhur një mënyrë tepër të kamofluar edhe për të mos rënë në sy jashtë rrethimit të godinës së repartit "X" në Linzë. Nga pamjet filmike rezultojnë se Bejtaj priste dajën e tij të dilte i mbushur me para nga thesari i bankës, me një makinë pa targa. Automjetit i hiqeshin targat për të mos u identifikuar plotësisht nga kamerat e jashtë të sigurisë, që janë instaluar në godinën e The-sarit të Shtetit. Sipas burimeve të prokurorisë, janë dashur disa ditë për të identifikuar personin që zotëronte automjetin, që në pamjet filmike shfaqej pa targa. Për këtë është urdhëruar sekuestrimi i disa pamjeve filmike të bizneseve që ndodhen në rrugën që të çon në repartin "X" në Linzë. Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se i njëjti mjet që shfaqet pa targa në hyrje të godinës së The-sarit të Shtetit, shfaqet disa qindra metra më poshtë kësaj godine me targa. Dhe këtë e kanë filmuar kamerat e një biznesi, që ndodhet buzë rrugës. Nisur nga kjo situatë është arritur të identifikohet dhe pronari i mjetit, i cili rezultoi të ishte shtetasi Klevis Bejtaj, nipi i autorit të supervjedhjes Ardian Bitraj. Fill pas këtij konstatimi është vendosur mbrëmjen e të mërkurës arrestimi i menjëhershëm i 26-vjeçarit.

CELËSAT TEK BIXHOZXHIU

Banka e Shqipërisë i kishte besuar një bixhoz-

hiu tre çelësat e The-sarit të Shtetit. Ardian Bitraj, njeriu që ka vjedhur shuma të konsiderueshme lekësh nga The-sari i Shtetit ka qenë personi që mbante tre çelësat kryesorë të kasafortës ku mbahen lekët e shtetit shqiptar. Tri kopjet e çelësve, mbaheshin prej tij gjatë orarit zyrtar dhe jo zyrtar të punës, duke krijuar mundësi që ai të vidhte paratë thuajse çdo ditë nga kasaforta. Sipas rregullore këto tri çelësa duhet të mbaheshin nga Bitraj dhe dy specialistë të tjerë dhe pasi të mbyllej orari zyrtar i punës, çelësat e kasafortës duhet të mbylleshin në një kasafortë tjetër, me qëllim

shmangien e çdo mundësie për vjedhjen e parave të The-sarit të Shtetit. Por një gjë e tillë nuk ka ndodhur, duke ia lënë çelësat parave të shtetit një bixhozxiu. Mumentalisht për këtë ngjarje janë arrestuar 9 persona ndërkohë që të tjerë pritet të verifikohet dhe mund të arrestohet nga prokuroria.

LEKËT ME THASË

Sipas prokurorisë së Tiranës, Dhimiter Davidi kishte si detyrë të vëzhguesit-operator. Ai mbikëqyrte kamerat e sigurisë dhe raportonte për çdo anomali. Nga ana e prokurorisë së Tiranës është kryer kqyrja e

PROKURORIA, identifikoi makinën dhe Klevis Bejtaj nga kamerat e sigurisë së një biznesi privat në rrugën që të çon në godinën e thesarit.



Ardian Bitraj



Mimoza Bruzia

kamerave të sigurisë, nga të cilat rezultojnë se vëzhguesi-operator i ka parë veprimet e shtetasit Ardian Bitraj, i cili mbushte thasë plastike me kartëmonedha në magazinën e stokut dhe nuk e ka raportuar. I pandehuri kryesor, Ardian Bitraj, pasi i merret para me thasë plastike, shkonte në tualetet e ndërtesës dhe paratë i fshihte në trup, poshtë rrobave. Pikërisht pas kësaj Bitraj kapërcente derën e hekurit të The-sarit të Shtetit dhe zbraste paratë e vjedhura në makinë, ku e priste nipi i tij Klevis Bejtaj.

VIDEO/ VJEDHJA E PARAVE PASDITEVE



Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AIREPORT që shkarkohet falas

PESË ORËT E MASAVE TË SIGURISË

Mbyllen në qeli 6 të arrestuarit Familjarët: Po i bëni koka turku

Avokatja Pustina: Klienti im neglizhoi, po nuk vodhi

Gjykata e Tiranës ka mbyllur në qeli gjashtë punonjësit e Bankës së Shqipërisë, së bashku me nipin e Ardian Bitrajt të akuzuar për vjedhjen e 713 miliard lekëve nga the-sari i Linzës. Vendimi i gjykatës është dhënë ditën e djeshme në një seancë e cila zgjati për 5 orë me detyrë të mbyllura. Jashtë kamerave familjarët e të arrestuarve akuzojnë se ky është një inskenim pasi përgjegjësit kryesorë drejtojnë ende Bankën e Shqipërisë dhe të afërmit e tyre mbahen në burg padrejtësisht. Sipas kërkesës së organit të akuzës në burg duhet të qëndrojnë Petrit Ramohitaj, me detyrë përgjegjës i arkës në veprim, Liljana Tusha, me detyrë specialiste e arkës në veprim, Lavdim Cani, me detyrë specialist i arkës stok (tranzit) pranë Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë i cili është dhe personi që shihni në këto foto pas kafazit të hekurit. E njëjta masë e arrestit me burg u dha dhe për Myzejen Belba, me detyrë specialiste

e arkës stok (tranzit) dhe Dhimiter Davidi, me detyrë vëzhgues-operator, i cili në gjykatë u mbrojt me avokaten e vendosur kryesisht Vjollca Pustina. Pas përfundimit të gjykimit kjo e fundit deklaroi se: "Faktikisht mbaroj masa



e sigurisë për të arrestuarit Dhimiter Davidi, personi nën hetim është me urdhër ndalimi nga organi i akuzës. Unë si mbrojtëse, shpreha pretendimet e mia për përcaktimin e masës së sigurimit, ai realisht ka qenë punonjës bankë por mendoj se një neglizhencë e tij dhe s'e ka vlerësuar si duhet situatën prandaj është këtu për një masë sigurimi. Të pranishëm për disa orë me radhë pranë ambienteve të Gjykatës qëndruan dhe familjarët e të arrestuarve, ku jashtë kamerave akuzuan drejtuesit e bankës pasi sipas tyre, të arrestuarit janë thjesht koka turku për ngjarjen dhe përgjegjësit kryesorë si prek kush.

Akuza drejtuesve

Të pranishëm për disa orë me radhë pranë ambienteve të Gjykatës qëndruan dhe familjarët e të arrestuarve, ku jashtë kamerave akuzuan drejtuesit e bankës



Objekti i Qendrës së Emisionit të Bankës së Shqipërisë

Shkarkohen dhe 9 të arrestuarit

Banka e Shqipërisë dorëzon raportin e auditit në prokurorinë e Tiranës

— Mesditën e së Premtes një punonjës i Bankës së Shqipërisë, është paraqitur në prokurorinë e Tiranës, ku ka dorëzuar dosjen voluminoze të auditit të kryer nga vetë ekspertët e bankës. Dosja është dorëzuar te prokurori Ramadan Troci, i cili po kryeson hetimet për supervjedhjen më të madhe të kryer vitet e fundit në Thesarin e Bankës së Shqipërisë. Auditit i bankës tregon se shuma që është vjedhur në thesar kap shifrën prej 7.13 milion dollarë, shumë kjo që mendohet se është

vjedhur nga përgjegjësi i Departamentit të Qendrës së Emisionit Ardian Bitraj gjatë katër viteve. Në dëshminë e tij, Bitraj përmend se vjedhjen e parë e ka kryer në vitin 2011, kohë kur në departamentin e Qendrës së Emisionit është emëruar me firmën e Ardian Fullanit, shtetasi Dorian Çollaku. Ky i fundit pas skandalit të vjedhjes së bankës është shkarkuar dhe bashkë me të u largua nga puna dhe shtetasi Eduart Sinani, Drejtori i Departamentit të

Sigurisë dhe Mbrojtjes së Bankës së Shqipërisë. Tashmë, vetë banka është duke kryer hetime të mëtejshme për të parë përgjegjësinë e secilit prej personave që ka abuzuar me detyrën, duke i lënë mundësi Ardian Bitraj të kryente vjedhjen e parave në Thesarin e Shtetit Shqiptar. Vendim për shkarkim është marrë dhe për 9 personat e arrestuar nga prokuroria e Tiranës, të cilët sipas bankës janë shkaktarë të këtij skandali që solli zhdukjen e parave.



HETIMET

Numri i të arrestuarve pritet të rritet



Hetimi pasuror zbulon firmën me kapital 335 mln lekë

Akuza: Kunati i Ardian Bitraj, kompani të importimit të mjeteve ndërtimore e jahteve

— Numri i personave të arrestuar mund të rritet gjatë muajit Shtator ose Tetor. Sipas burimeve të prokurorisë, pritet që kjo periudhë të shërbejë për saktësimin e rolit dhe për disa punonjës të tjerë, të cilët mund të kenë gisht në supervjedhjen e Bankës së Shqipërisë. Bëhet fjalë, për punonjës të tjerë të kësaj banke dhe disa persona që nuk janë punonjës por miq dhe shokë të shtetasit Ardian Bitraj. Ky i fundit në dëshminë e tij ka treguar disa emra, por që sipas prokurorisë mbetet që në ditët në vazhdim të verifikohet pozicioni i tyre.

ELTON QYNO
TIRANE

Hetimet e njësisë hetimore Task-Forcë për të identifikuar pasuritë e personave të arrestuar për supervjedhjen e Bankës së Shqipërisë dhe familjarëve të tyre, kanë zbuluar një kompani tregtare me një kapital prej 335 milion lekë të vjetra. Burimet e prokurorisë së kryeqytetit pohojnë se në vazhdim të hetimit pasuror, kanë marrë një përgjigje nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit të biznesit, se Kujtim Bejtaj kunati i Ardian Bitraj, njëherësh dhe babai i të arrestuarit Klevis Bejtaj, ka në pronësi kompaninë "Eurostar". Kjo kompani rezultoi e regjistruar në QKR, dhe se ka si ortak të vetëm biznesmenin Kujtim Bejtaj, i cili sipas prokurorëve ka kumat njeriun që vodhi nga Thesari i Bankës së Shqipërisë 713 miliard lekë. Kompania ka si objekt të saj zbatimin në fushën e ndërtimeve, montimit, projektimit.



Jahte
Sipas burimeve të prokurorisë së Tiranës kompania në pronësi të Kujtim Bejtaj kohët e fundit importonte nga jashtë dhe mjete lundruese si Jahte.

meve, montimit, projektimit. Prodhimi i materialeve të ndërtimit. Import-eksport të materialeve të ndërtimit. Import të makinerive e mjeteve transportit në fushën e ndërtimit. Në historikun e saj, kjo

kompani është themeluar në datën 29 maj 1993, dhe se prej kësaj kohe ka shtrirë aktivitetet e saj në disa zona të Shqipërisë.

IMPORT JAHTESH

Edhe pse në objektin e kësaj kompanie nuk përcaktohet konkretisht se çfarë paisje konkrete importon në Shqipëri, burimet pranë njësisë hetimore Task-Forcë, thanë se vitet e fundit kompania ka importuar dhe Jahte. Tashmë prokuroria ka nisur hetimet, ndërkohë që është në pritje dhe të disa përgjigjeve të tjera nga disa institucione lidhur me pasurinë e familjes Bejtaj dhe familjarëve të Ardian Bitraj, i akuzuar nga prokuroria e Tiranës për veprën penale të "Vjedhjes së bankave dhe arkave të kursimit" me pasojë të rënda.

20 FAMILJARË

Vendimi për të verifikuar pasurinë e familjarëve të arrestuarve, ka dalë pas një analize të zhvilluar në Prokurorinë e Përgjithshme, ku 6

EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"	
GJENDJA E REGJISTRIMIT	
1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NPT)	J61929023U
2. Data e Regjistrimit	29/05/1993
3. Emri i Subjektit	EUROSTAR
4. Forma ligjore	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
5. Data e themelimit	29/05/1993
6. Kohëzgjatja	Nga: 29/05/1993 Deri:
7. Selia	Tirane Tirane, TIRANE/SHOQËRI URA DOMBËT
8. Kapitali	33.4 33,477,254.00
9. Numri i pjesëve	91 shtesa nominale
10. Të dhëna mbi abizhjeten e kapitalit	334,772.54
11. Objekti	Zhatisht me fushën e ndërtimit, montimit, projektimit. Prodhimi i materialeve të ndërtimit. Import eksport të makinerive e mjeteve
12. Përfunduesit ligjorë	Alfati i emërit Nga: 29/05/1993 Deri: 11/10/2013
13. Kufizime të kompetencave	

● Faksimile e ekstraktit të QKR ku tregohet kapitali dhe pronësia e kompanisë "Eurostar"

ditë më parë u urdhërua që grupi i hetimit veç verifikimeve për akuzën e "Vjedhjes së bankave dhe arkave të kursimit", të kryente hetime paralele dhe për "Pastrimit të produkteve të veprës penale". Sipas prokurorëve, rasti që janë duke hetuar ka vend për të kryer hetime për këtë akuzë, pasi sasia e parave që është vjedhur është tepër e madhe, ndërkohë që probabiliteti i gjetjes së lekëve deri në këtë fazë është zero. Për të shuar çdo dyshim, është ngarkuar njësia hetimore Task-Forcë që të kryejë hetime rreth 20 personave, familjarë dhe miq të Bitraj dhe Bruza, për të mësuar rreth transfertave të tyre bankare dhe origjinës së tyre. Sipas hetuesve, në shërbim të këtij

hetimi do vihen dhe bankat e nivelit të dytë në Shqipëri si dhe Zyra e Hipotekës dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit të bizneseve. Vetë Ardian Bitraj disponon në emrin e tij një apartament në rrugën "Fortuzi" në Tiranë dhe një automjet ndërkohë që bashkëshortja e tij nuk ka asnjë pasuri, veç rrugës si drejtore dhe në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri. Ndërkohë që burimet pranë prokurorisë thanë se kanë kërkuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë t'i vënë në dispozicion listën me të gjithë emrat e personave që punojnë dhe kanë punuar ndër vite në repartin e koduar "X", apo siç njihet ndryshe në Qendrën e Emisionit të monedhës në Linzë.

Si mund t'i vihet pritë ndikimit të Moskës?!

NGA **STEFAN TROEBST**

vijon nga faqja 1

...kufijtë e saj të jashtëm". Federata Ruse e vitit 2014 nuk është më Bashkimi Sovjetik i 1946-s, por një Dëjja-vu është i pashmangshëm.

MBYLLJA E NGUSHTICAVE DETARE

Ç'mund të bëhet kundër politikës hegjemoniste, ekspansive dhe destabilizuese të Moskës?

Edhe pas goditjes së avionit MH17 me rreth 300 viktima prej oficerëve të kamufluar të Shërbimit të fshehtë ushtarak rus, përfshirë falangat e tij kriminale, Bashkësia Ndërkombëtare vazhdon të ngurrojë. Veçanërisht BE-ja shmanget me kujdes, sepse pasojat e sanksioneve ekonomike më të rënda do të kishin kundërveprim. Atëherë si mund të goditen pasuesit e Putin-it, pa dëmtuar drejtpërdrejt 140 milionë qytetarë të Federatës Ruse?

Nga një opsion ushtarak SHBA dhe NATO kanë hequr dorë publikisht qysh gjatë pushtimit të gadishullit ukrainas të Krimesë – taktikisht në mënyrë të parakohshme dhe joadekuate. Por a ka masa që të synojnë dobësimin ushtarak të Rusisë, pa qenë nevoja që Aleanca Transatlantike të kapërcente pragun e lejueshëm të agresionit?

Një propozim original vjen nga europarlamentari gjermano-lindor Werner Schulz dhe parasheh mbylljen e ngushticave detare të Bosforit dhe Dardaneleve për anijet luftarake ruse nga ana e Turqisë, si një vend anëtar dhe bashkëthemelues i NATO-s. Neni 21 i Konventës mbi Ngushticat Detare, nënshkruar në Montreux, 1936, ia jep Turqisë këtë

mundësi, jo vetëm në rast lufte, por edhe në rastin kur Turqia thjesht ndjehet e kërcënuar. Fitorja strategjike e Moskës përmes aneksimit të Krimesë ukrainase do të neutralizohet ndjeshëm nga bllokimi i koridorit detar për anijet luftarake, pasi kështu flota ruse e Detit të Zi nuk do të kishte më rrugëdalje. Dëjka e tillë do t'ia vështirësonte shumë Moskës furnizimin e të vetmes bazë detare jashtë vendit, në portin sirian Tartus.

Por, sa realiste është kjo? Fakt është se, jo vetëm segmentet me orientim nacionalist të opinionit publik turk, por dhe rrethet qeveritare kanë shprehur solidaritet me tatarët myslimanë të Krimesë, meqenëse Khanati i Krimesë tatarë ishte deri më 1774 pjesë e Perandorisë Osmane dhe Republika e Turqisë e sheh veten si pasuese ligjore të kësaj ish-perandorie. Veç kësaj, në kuadër të luftës civile siriane, Ankara është pozicionuar qartazi kundër presidentit sirian Bashar al-Asad, i mbrojtur nga Moskë. Dhe së fundi, Turqia është konkurrenë e Rusisë në pjesët turqishtfolëse të Kaukazit dhe Azisë Qendrore – me interesa të kundërta në projektet energjetike dhe gazsjellëse ndërkombëtare mes Lindjes dhe Perëndimit.

KUFIZIM

Një akt simbolik, ndikimet politiko-ushtarake të të cilit do të tejkalonin dukshëm diversionet e deritanishme të disa avionëve luftarakë amerikanë mbi kufijtë lindorë të Polonisë, do të ishte shfuqizimi - në aktin themeltar të Këshillit NATO-Rusi 1997 - i angazhimit të Aleancës transatlantike për të "mos stacionuar në periudhë afatgjatë trupa luftarake shtesë në brezin aktual të sigurisë". Me argumentimin se Moskë nuk i është përbajtur parimit të sanksionuar në këtë akt themeltar: "Dorëheqje prej çdo lloji kërcënimi apo përdorimi i forcës kundër kufijve shteti tjetër, kundër sovranitetit, integritetit territorial apo pavarësisë politike të tij", për të mos përmendur parimin tjetër: "Respektimi i sovranitetit, pavarësisë dhe integritetit territorial i të gjithë shteteve si dhe pacënueshmëria e kufijve të tyre", do të mund të shfuqizohet me plot arsye angazhimi i sipërpërmendur i NATO-s. Nëse dëjka e tillë do të çonte në afrimin e pjesshëm të flotës luftarake të Mbretërisë Norvegjeze, të British Airforce ose të Bundeswehr-it gjerman drejt gjireve finlandeze, në brigjet Courland të Lituaniës e Rusisë apo në distriktin liqenor Masuria të Polonisë, kjo është tjetër çështje.

Në debatën ndërkombëtare mbi agresionin rus ndaj Ukrainës, palët dhe komentatorët i tremben termit të "vënies pritë" si djalli ujti të bekuar. Kjo nuk ka asnjë bazë, sepse vënia e kufizimeve, sipas Kennan-it, nuk është aspak një përgjigje me prirje shkalëzuese ndaj një zhvillimi kanosës ose një aksioni ushtarak.

Shënimi: Stefan Troebst është Historian dhe Profesor për Studime Kulturore të Europës Qendrore-Lindore në Universitetin Leipzig. Shkrimi është botuar së pari në Neuer Zürcher Zeitung, përkthet dhe botohet shqip me lejen e autorit. Përkthet Raim Beluli

3.9%

Lekë & Euro

Kredia Hipotekore 5 Yje

Interes fiks për vitin e parë
Shlyerje para afatit me **komision 0**



Fibank
15 vjet në Shqipëri

TELEFONI PA PAGESË NË
0800 01 11
www.fibank.al

RILINDASI

Viti IV - Nr:31

E diel, 3 gusht 2014

Kryeredaktore: Admirina PEÇI

NA NDIQNI
EDHE ONLINE
www.shqiptarja.com
...origjina
e lajmit...

MEMORANDUMI I 1907


Fan Noli: Fqinjët, ja si u ngulën tinëzisht nëpër qytetet shqiptare

ADMIRINA PEÇI

Ky është një dokument mjaft i rëndësishëm që dëshmon përpjekjet e Fan Nolit dhe drejtuesve të tri shoqërive të tjera shqiptare në Amerikë për të siguruar të ardhmen e Shqipërisë në një kohë mjaft kritike për të.

Dokumenti, të cilin e sjellim sot për herë të parë për lexuesit së bashku me faksimilet e tij, është një prej katër memorandumëve të dërguara në konferencën e Paqes në Hagë (korrik-shtator 1907, përmes të cilëve dëshmohej se shqiptarët ishin të vendosur të ngrinin zërin për një varg kërkesash, duke kërkuar deri edhe autonominë.

Katër memorandumet ishin hartuar nga: i pari, i hartuar në Boston më 10 korrik, në emër të shoqërive atdhetare të kolonive të SHBA-së dhe nënshkruar nga kryetarët e tyre, si Fan Noli, Potë Lambec, Lambi Bimbly dhe Paul Chili; memorandum i dytë ishte dërguar në emër të kolonisë shqip-



NË FOTO: Fan Noli dhe Faksimile e memorandumit për konferencën e paqes Hagë 10 korrik 1907

tare të Kostancës në gusht 1907; memorandum i tretë ishte dërguar nga "Komiteti i kolonisë shqiptare të Egjiptit" po në gusht të atij viti dhe i katërti ishte hartuar nga Der-vish Hima dhe dërguar "Në emër të shqiptarëve myslimanë, ortodoksë e katolikë" në korrik, 1907.

Dokumenti që sjellim për lexuesit është ruajtur në arkivin e Vjenës dhe së bashku me shumë dokumente të tjera historike të kësaj periudhe, iu dhuruan Arkivit të Shtetit në Tiranë para pak ditësh nga studiuesi Pjetër Logoreci.

Memorandumi është dërguar delegatëve austro-hungarezë në Konferencën e Paqes në Hagë më 10 korrik 1907 dhe është firmosur nga Fan Noli, kryetari i shoqërisë Besa-Besë, Potë Lambec i shoqërisë "Lidhja", Lambi Bimbly i shoqërisë "Mall" i Mëmëdheut, dhe Paul Chili i shoqërisë "Koha".

I shkruar me shkrim dore, me një kaligrafi mjaft të bukur, dokumenti paraqet gjithsesi vështirësi për t'u lexuar. Siç dihet në këtë periudhë intelektualët shqiptarë nuk kishin një shqipe me një alfabet të njësuar...

vijon në faqen 16-17



Helidon Gjergji ironizon Facebookun me nënën e Stalinit

Ja çfarë rrëfejnë tre videot e ekspozuara në Galerinë Kombëtare të Arteve. Koncepti i artistit për fenomenin e facebookut. A është ky një problem global?

DHURATA HAMZAI

Mund të kishte zgjedhur për të bërë ironi me fenomenin Facebook çdo lloj diktatori, por arsyeja pse artisti Helidon Gjergji zgjodhi Stalinin është një lloj lidhje me të kaluarën e tij. "Jemi shqiptarë dhe kemi vuajtur diktaturën staliniste. Mund të kisha zgjedhur dhe nënën e Hitlerit, Musolinin, Sadamit, etj", thotë artisti. Helidoni ka zgjedhur figurën e diktatorëve, sepse edhe imazhi i tyre për publikun ishte gjithmonë i kurrar, me një buzëqeshje reklamuese dhe plot ëmbëlsi. Në Facebook kështu ndodh, sipas tij...

...faqe 22



Gjovali Reshpja vëllai i poetit Frederik Reshpja dhe një ambient nga shtëpia e lindjes së poetit

Pas 50 vjetësh... në shtëpinë e poetit Frederik Reshpja

Takimi i fundit me vëllain e poetit, mjekun Gjovalin Rreshpja, një ditë para se të vdiste... Shënimet e fundit në një bllok. "Të nesërmen e rikthimit aty, për të vazhduar bisedën siç e kishim lënë... më 13 korrik, papritur, u gjenda keq. Pashë letërën e vdekjes dhe fotografinë e tij..."

XHAHID BUSHATI

...faqe 18-19

Paradigma lirike në poezinë e Nikolla Spatharit

Erotika e Spatharit është e lezme, siç do ta quante Martin Camaj, por herë-herë edhe e ashpër, shpërthyes, e kushtëzuar nga marrëdhëniet komplekse të dashurisë....

SAZAN GOLIKU

Nikolla Spathari, autor me një gamë të gjerë në fushën e letrave si shkrimtar humorist, poet, reporter, studiues, shkrimtar për fëmijë, si dhe me një hapësirë të gjatë kohë si krijues, ka bërë emër dhe është shquar me veprën e tij, por mendoj se me krijimtarinë poetike ka arritur vlerat më cilësore. Ndryshe nga shumica e poetëve, që lulëzimin e talentit poetik e kanë pasur në moshë të re, Nikolla Spathari pjekurinë e poezisë e ka arritur me pjekurinë e moshës.

Në kohën e realizmit ...faqe 20-21

DOKUMENTI | HISTORIK

MEMORANDUMI I 1907

ADMIRINA PEÇI

vijon nga faqja 15

...Kjo ndodhi thuasje një vit më vonë në kongresin e Manastirit.

Për shkak të autenticitetit në kemi vendosur ta zbardhim përmbajtjen e këtij memorandumi me besnikëri, edhe pse mund të krijojë vështirësi në të lexuar, për shkak të rëndësisë dokumentare që ai paraqet si historike ashtu edhe gjuhësore.

Në vija të përgjithshme memorandumi parashtrohet këtë përmbajtje. Pas lutjes drejtuar delegatëve austro-hungarezë në konferencën e paqes për të ndërhyrë për çështjen e Shqipërisë, nënshkruarit e këtij memorandumi paraqesin një historik të Shqipërisë, që pas vdekjes së Skënderbeut dhe rënies së Shqipërisë nën sundimin turk deri në fund të shekullit XIX-të, duke theksuar se në këtë periudhë mjaft të gjatë shqiptarët e bazuan mbijetesën e tyre në dy burime, bujqësi dhe ushtri. Duke lënë thuasje pas dore çdo zhvillim tjetër të jetës ekonomike, të huajt shumica fqinjë të shqiptarëve gjejnë terren të lirë për ngritjen e një sërë aktivitetesh tregtare, duke krijuar edhe monopolin e tyre.

Pas reformave që Turqia ndërmori në ushtri shumë shqiptarë mbetën tashmë pa asnjë të ardhur për të jetuar. Po ashtu edhe bujqësia shqiptare shënonte ditët e saj të rrezikut. Në kushtet e një krize të papritur ekonomike, shqiptarët menduan t'i ktheheshin tregtisë dhe industrisë, por kjo binte ndesh me interesat e tregtarëve të huaj që tashmë i kishin fuqizuar monopolin në të gjithë tregjet shqiptare.

Shqiptarët kuptuan se çlirimi i tyre ekonomik varej nga çlirimi i tyre kombëtar dhe ky nga arsimimi i popullit. Kështu filluan të themelojnë shkollat, për të cilat në fillim Turqia dha leje. Por kjo nuk do të zgjaste shumë. Befas nisën përndjekjet dhe shkollat u mbyllën një nga një.

Kjo sipas autorëve të këtij memorandumi kishte ardhur pas ndërhyrjes në instancë të larta të perandorisë turke të fqinjëve ballkanikë të shqiptarëve.

Çështja shqiptare nuk është veçse një luftë për vdekje, e cila u hap para djemve shqiptarë nga një grusht të huajsh të cilët arrihen ta kenë Turqinë në anën e tyre. Pas kësaj në memorandum, nënshkruarit kërkojnë të ndërhyhet me urgjencë për çështjen shqiptare, ndërsa parashtrojnë edhe kërkesat e tyre. Kërkesa e parë është njohja prej Turqisë e shqiptarëve si një kombësi e veçantë pa vënë re dallimet fetare, kërkesa e dytë lidhet me shkollat dhe zhvillimin intelektual të shqiptarëve.

Ata kërkojnë që Turqia të japë leje për hapjen e shkollave fillore, bujqësore e artizanale, për qarkullimin e librave mësimorë dhe autorizimin dhe krijimin e "Këshilli t'Arësimit Botëror", i cili do të drejtonte e mbikëqyrte shkollat shqipe.


Kërkesa e tretë lidhet me sigurinë e lirisë tregtare të Shqipërisë, duke nënkuptuar ndalimet, frikësimet dhe rryshfetet, me të cilat kërcënoheshin tregtarët shqiptarë.

Ata kërkojnë që tregtarëve shqiptarë t'u sigurohet çdo lehtësi që u nevojitet, të hiqen gjithë pengesat për rrugët tregtare e industriale, që rrugët tregtare që lidhin limanet me qendrat bujqësore të mbahen siç lipset. Dhe të lejohet krijimi i një "Këshilli të lartë për Tregtinë", i cili do të ketë mjetet e duhura për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.

Duke përfunduar me kërkesat e tyre, nënshkruarit e këtij memorandumi bëjnë thirrje të ndërhyhet për këtë popull që s'dëshiron veçse përparimin, punën dhe paqen.

Zbulohet dokumenti për Fuqitë e Mëdha: Shpëtoni Shqipërinë

Fqinj, ja si u ngulën tinëzisht nëpër qytetet shqiptare. Fakti që shqiptarët merreshin vetëm me ushtri dhe bujqësi nën sundimin osman, tregtia u pa si një mundësi për monopol prej fqinjëve ballkanikë...



Fan Noli

Dokumenti i plotë, zbardhur sipas originalit

Zotërij delegatë,

Sa do dëshirë që të ketë Konferenca për të lënë më gnanë tsa fare bisedime fiesht politike, po të pakën do merret së-jashtmi për çështjen e Ballkanit. Delegatët e Shteteve të veghël të Ballkanit sidomos do të rëfejnë që çfarëdo pacje do mos jetë vech e kottë sa kohë chështia e Ballkanit, shkak armicësiesh aktive nërmiet popujve dhe rivalësish të rëxikshme nërmiet fucive të mëdha, nukë merr gnë xghidhje, ose gnë nisje xghidhjeje. Kombi shqipëtar, që është gnë nga anët e interesuara në xghidhjen e kësaj chështjes së madhe, do të jetë i vetëmi që do mos ketë bajloxë në Konferencë. Është e drejtë Fucitë të mos e shohin Shqipërinë vech me syt' e armicve të saj? Këta armic munt të na për-

flasin, se nuk humbasin asgnë rasje që t'a bëjnë Shqipërinë të mërxiturë.

Është e drejtë Fucitë të dëgjojnë ngaherë përfllime dhe kurrë mprime?

Shocëritë shqipëtare të Shteteve të Bashkuara t'Amerikës – të tsilat facësorj në moralisht nëntë të dhietat e popullit shqipëtar dhe janë gnëxet mijë tregëtorë dhe punëtorë, të krishterë si dhe muhametanë – e pandehjnë për detyrë t'u dërgojnë Shcuarësive Tuaja gnëchposim të vërtetë të ndodhjes së kombit tonë. E dimë shumë mirë që s'ju mbetet mjaft kohë dhe do mos shëkojmë t'u ngarkojmë Shcuarësive Tuaja këndimin e gnë përkujtimi të ghatë. Do t'jemi pra të shkurtër e të përmbledhur sa të na mundet; dhe po të kenë mirësinë Shcuarësive Tuaja të na vënë re për pak minutë, kemi shpresë që di t'interesohi pak për fatin tonë.

Pas gnëxet e shtatë vietsh luftë të pashuarë nënë mbretin tonë të fundit, të pavdekurin Ghergh Kastriot Skënderbenë, Shqipëria – e lënë me fatin e saj prej Republikës së Venetikut e pejt të tierave fuci Europiane t'asaj kohe – u shtrëngua të ipet në Turcit. Afer gnëcint mijë prej bashkatdhetarët tanë u nevojtin të chatdhesohen; tsa prej këta Shqipëtarë të mërguar e prej stërnipët e tyre cenë të të dëgjuar: si, Thomaus, gnë nga më të mëdhejtë humanistë të Përlindjes dhe i pari përkthegnës series i Aristotit; ghenalasisim perandorak, kont' i Hulst-it Ghergh Basta; papa Klement' i XI, kardinali Albani; e më afer politikanin Krispi. Gnë numër i math prej Shqipëtarësh të mbetur në vent u shtrënguan të bëhen muhametanë, dhe mbetnë t'atijë gher më sot, po duke ruajtur tërë karakteristiket e gnë populli European, si monogaminë, ndërë për gratë, etj. Të tierët Shqipëtarë me gnë mijë therore muntnë të cëndrojnë të krishterë – katolikë e orthodoxë. Marrëdhënjet në mes të këtyre kumerteteve të ndryshme, po prej gnë fare, gnë ghaku dhe gnë ghuhe, cenë ghithëgnë tepër micësishte, vech pak të vogëlash xhije të vechanta.

Gher në mest të shekullit XIX, populli shqipëtar mbahej nga dy burime: nga bujqësia dhe nga ushtërisma. Turcia s'kish edhe adoptuar kushkresën, dhe mbledhjet ushtërore të dorës së dytë i kishin përsipër tsa farë bajraktarësh, të tsilet me gnë rrogë të marrë-vesh mirrinin barrën të mbledhin, të ushejnë, e të stërvitin e të mbajnë nën' urdhër të ceverisë centrale trupë prej ushtarësh. Kish pra kështu gnë numër të math Shqipëtarësh, tsilet kishin pothia-se

N° 14, g.
Scheveningen, 16. Juli 1907.
von Merrey

..... in Boston,
St. Louis, Jamestown
Und Neëyork
2 Leihryun

[Texte albanais, lu, discuté et approuvé
par les Sociétés,
et signé par leurs présidents respectifs]
Shcuarësive të Tyre

Zotërijve delegatë t'Austri-Hongries
në Konferencë të pacjes

Zbardhet një prej katër memorandumeve që u dërguan nga shoqëritë shqiptare në Konferencën e Paqes në Hagë korrik –shtator 1907

gnë mieshtërie trashëgimtare. Popullsia tatar merrej vetëm me punët bujqësore. Pas këtyre, Shqipëtarët, popull prej ushtarësh e bujqësh kishin pak mall për qytetet dhe linin fare më gn'anë tregërinë. Dyke përfituar këtë chkuqdesje, të huaj rithnin nga viset feign të veghël, nguleshin dalë ngadalë nër qytetet tona dhe monopolësonin tregjet tanë; me cenë që ishin të dobishim për të lehtësuar chkëmbimet dhe asgnë nuk muntte të parshkëkonte rollë që do të losnin stërnipët e tyre gnë ditë, i prsinin me gith xëmër.

Nga mex' i shekullit XIX, Turcia nisi reformën e sistemit ushtëror, ndrimin i të tsilit s'u mbarua plotaxi në Shqipërie vech afër më 1867. Kio reformë pati përfundje lëndore të chastreshme për Shqipërinë se la pa punë dhe në varfëri gnë anë të tërë të popullimit tonë. N'atë kohë, nga shkakë të nzenë liksh, bujqësia nisi të rëxikohet. Gnë krië ekonomike e madhe u chfac atëherë në vendt. Shqipëtarët dyke mos patur më tërë ato burimet e vietëra, u mejtuan të kthehen me punët industriale dhe tregëtore. Po atie u përcopnë me kundërshtimin e asaj pakitë të huajsh, e tsila monopolësoj pasurit' e Shqipërisë dhe donte me chfarëdo mënyre t'a përmbajë sipërinë ekonomike, të tsilen verbëria e stërgjyshëve tanë e kish lënë të vendosë.

Zija pra po madhohej nër Shqipëtarët, të tsilëtë kupëtuan më në funt se ish shtruar gnë plan methodik prej elementit të huaj që t'i rëpin e t'i vrasin urie. Këtë plan kërkojnë t'a mbushin dyke përdorur pabesinë atie tek elementi shqipëtar ish i-xoti të kundërshtohet dhe pahirë pa tsipë atie tek ish i dobët. Mundet të ndritohet kio method e fundit me gnë shëmbëll të dëghuar: Më 1879 ceveria serbe u xaptonte mallë pa nognë chpërblim tërë Shqipëtarëve të viseve që pushtëtoj atëherë; dhe pas këti atentati kundër mykut, burra, gra e fëmijë i nzuarë jashtë nga kufitë, gith'ata serbë kanë acë pak dignitet përsipër sa nuk pushojnë së thirruri kundër padrejtësisë, kur ata të mierë cë u varfëruan prej syresh mprohen kundër Serbëve të Shqipërisë. Sa për methodën tatarë armice tanë, pabesiën, janë sheshit plot shëmbëlla prej tregëtarësh grekë të tsilët chngarkohen prej Shqipëtarëve konkurentë dyke i kallëxuar për krimëra të pa-cëna kundër shiguries së Shtetit.

Efektet e gnë pabesie kacë të xexë e gnë paligjësie kacë të xëmërgurtë nuk mënuan të chfaceshin. Ndiegnat atdhësore nisë të scohen ne populli shqipëtar dhe dëshira e bashkimit kombëtar u shigrua me fucë. Shqipëtarëtë kupëtuan ch chllirim' i tyre ekonomik varrej nga chllirim' i tyre kombëtar, dhe ky nga arësim' i popullit. U vunë pra të bëjnë atë që kishin bërë cë prej kohe kombësit' e tiera të perandories Tyrke; të themelojnë shkolla. Turcia më në krye dha leje. Po bënim hesap pa pakitsën e të huajve: Ata panë n'aktivërin shqipëtare gnë rëxik prej sipërin' e tyre dhe për mbushien e planeve të tyre, - dhe me gnë herë nisë t'ingrojnë cë të mbiellin shynbenë në mëndien e ceveritarëve turc. Shkollat tona u mbyllë pa dhënë xë dhe pa shkak të chfacur, dhe nisë ndiekje sistemoje kundër bashkatdhetarëve tanë, dyke burgosur këta, dyke shtrënguar të tierët të mërgohen

Liria tregëtare

Kërkesa e tretë lidhej me sigurinë e lirisë tregtare të Shqipërisë, duke nënkuptuar ndalimet, frikësimet dhe rryshfetet, me të cilat kërcënoheshin tregtarët shqiptarë. Ata kërkojnë që tregtarëve shqiptarë t'u sigurohet çdo lehtësi që u nevojitet, të hiqen gjithë pengesat për rrugët tregtare e industriale, që rrugët tregtare që lidhin limanet me qendrat bujqësore të mbahen siç lipset. Dhe të lejohet krijimi i një "Këshilli të lartë për Tregtinë", i cili do të ketë mjetet e duhura për zhvillimin ekonomike të Shqipërisë

e dyke paralytur ata cë mbeteshin. Misionet protestane t'Amerikës, shkollat e të tsilëve Shqipëtarët i pritnë me gas, patnë piesën e tyre nga spitsat ceverimtarë, të këshilluara prej pakitsës huaj.

Esht gnë gachie e ligë të na rëfejnë githëgnë lirin' e madhe që kanë gnëcint mijë nga malësorët tan' të guzimchim të kufive ose të na kujtojnë të mirat që u ipen tsa cindrave nga bashkatdhetarët tanë intriganë, dhe të lënë më gn'anë ato cë vuanë dy miliuna Shqiptarësh nga anët e tiera të vendit. Shëtoret të huaj na suallë këtë fialë të gnë konsulli: "Turcit e vranë Shqipërinë me të pabesë". Dhe ajo cë është më për të vënë re, "e vranë me të pabesë" prej hesapin e të tierëve. Dy numëra miaftojnë për të treguar shtetin për të carë të punëve në Shqipëri: S'ka më pak se gnëcint e pesëdhjetë mijë punëtorë shqipëtarë në mërgim, numër i tmeruar për gnë vënt të vogël, të populluar kacë rallë; kio ushtërië prej punëtorësh u nevojit të mërgohet se s'kish me se të ronte në Shqipëri; - nga tatarë anë gnë vëshgim me rëndësië prej gnë kamere Italiane të tregërisë vendosi cë vetëm e dhietta piese e pasurive të Shqipërisë lërohet.

Vendi ynë po shkretohet nga intrigat e paligjëta t'armice tanë dhe nga kumpliteti krimëtar i Turcve. Chfarëdo pune me rëndësië është e pamundëshme për Shqipëtarët në Shqipëri, porsa cë të hecimë jashtë tsa qytete të përvlegëhuarë të Veriut. Po mëndia e nisjativës nuk na mungon; goditë tona në mërgim e provojnë dhe muntin prej tregim të rëfënim Shqipëtarë të tsilët shtruan udhë të hekurta për hesapin e aksh Shteti të math.

Me gnë fialë, chështia shcipe s'është vech gnë luftë për vdekje tsila u hap kundër diemave të vëndit nga gnë grusht të huajsh pa tsipë, të tsilët arrinë t'i kenë Turcit nga an' e tyre. Kërkojmë nga Fucitë të vihen nga an' e së drejtës. Vojtjet e Shqipëtarëve nukë goditin në fantasion se s'janë melodramore si ato të Bulgarëve dhe të Armenëve. Po besojmë, se n'është për t'interesur fat i gnë populli cë theret, fat i gnë populli cë dhi-etësohet prej mërgimit, syrgjynit dhe uries s'është më pak. E mpshtetur në gnë vdekje të kadalëshme, Shqipëria s'ka të xghedhë prej shpëtimin e saj vech gnë luftë pahiri pa

kec kundër ndiekësve të saj dhe kumplive të tyre. Chfarëdo pacje në Jugë-Lindje t'Europës do mos jetë vech gnë fial e kottë, porsa cë fati ynë s'përmirësohet.

Po të jetë cë t'u vijë kec Fucive për fatin tonë e të kenë mirësinë të bëjnë për stërnipët e Skënderbeut të dhietën e atyre cë kanë bërë për popujt e tierët të Balkanit, jemi miaft t'arësishmë cë të mbetemi të kënaçur e do të chlëndohemi për këtë chast. Kërkimet tona do të përmbliiden në tri pika, moderimin e të tsilave asgnë s'munt t'a mohojë.

I. Turcia duhet të gnohë xyrtarisht Shqipëtarët si gnë kombësi të vechantë pas gjuhës, pa vënë re ndryshime feje.

II. Turcia duhet të mos i kundërshtohet chpëshhtijlles mendore të popullit shqipëtar.

III. Turcia duhet të sigurojë lirin tregëtare në Shqipërië.

Mbë kërkimin e dytë duam të themi cë Turcia të apë leje të kriohen shkolla nistore, bujqësore dhe mieshtërake. Duhet t'apë leje për certhullimin e librave fiesht pedagoghike. Më në funt Turcia duhet t'auctorësojë kriësin e gnë "Këshilli t'Arësimit Botëror", e tsila do ketë drejtimin e përgjithëshëm dhe përmicrjen e shkollave shcipe.

Me kërkimin e tretë duam të themi cë Turcia duhet të lërë më gn'anë ndalimet, frikësimet dhe rryshfetet, me të tsilat pëshhtë tregëtarë shqipëtar. Chfarëdo lehtësie duhet t'u ipen me gnë herë Shqipëtarëve cë dëshërojnë të merren me tregëri; ajartet e industries dhe shëtoret e tregërisë duhet të ghesdisin të lirë pa pengime nga ceveria. Shqipëtarët cë duan të shocërohen me gnë kompanie për gnë punë, të mundin t'a bëjnë; udhët tregëtorë cë lidhin limanet me cendrat bujqësore duhet të mbahen siç lipset. Gnë "Këshilli e lartë e Tregërisë" do të fillohet pe tregëtarësh shqipëtarë. Kio Këshillë do nzerë mietet për chpëshhtijlles ekonomike të Shqipërisë dhe do cëndrojë në gnë cëndrë tregëtore të Shqipërisë së Mesme, si Elbasani.

Këto janë kërkimet tona. U lutemi Shuarësive Tuaja t'i marrin nënë vështrim cë të mos e shtynjë me dëshpërim gnë popull cë s'dëshëron vech përparimin, punën dhe pacjen.

Kemi nderë të mbetemi

Zotërij delegatë

të Shuarësive Tuaja

shërbëtorë bindiakë.

Kryetar i Shoçërisë shcipe "Besa-Besën"

166 Endikott st., Boston, Mass.

Fan Noli

Kryetar i Shoçërisë shcipe "Lidhja"

509 Venderender st. St. Louis, Mo.

Potë Lambe

Kryetar i Shoçërisë shcipe "Mall'i Mëmëdheut"

675 Box P.O. Jamestown, N.Y.

Lambi Bimbly

Kryetar i Shoçërisë shcipe "Koha"

68 E. 43rd st. Neë York City

Paul Chili

Boston, Mass., 10 Korrik, 1907.

N.B. Sekretar i Përgjithëshëm i Shoçërisë

Soter Pettsy

323 Pleasant st., Boston, Mass.

Scutari 29. 8. 1907 G7

XXVI

MALL | KUJTIME



XHAHID BUSHATI

O hënë e shiut,
Bëje një iliadë për mua
Kur të rrëzohet edhe Troja e fundit!
(poezia: "Tors")

Më shoqëron një shi i imët korriku, që bie e pushon herë pas here si një motiv i bezdisshëm, teksa marr rrugën e "Gjuhado-lit" në Sarreq. Kjo rrugë e rikonstruktuar, në imazhin e saj arkitektural, ka një 'portet' ku elementet e traditës kanë raporte 'miqësie' me ato të bashkëkohshme. Pastaj, marr kthesën e parë në të djathtë dhe hyj në rrugicë. Në këtë rrugicë kam ardhur 50 vjet më parë. Më duket sikur kërkoj shumëçka, sikur gjurmët e hapave të mi... kërkoj edhe ndonjë kujtim të vagëlluar si një fluturim zogu...

Është po ajo rrugicë. Nuk ka ndryshuar. Rrugicë që nëpër vite e ka kërkuar heshtjen, siç duket edhe sot jeton me heshtjen... Ca dyer të mëdha, të ndërtuara vonshëm, të kujtojnë rikthimin në origjinë, shumë të tjera ruajnë paqësisht vjetërsinë e drurit.

Shi u ende më shoqëron, ndonëse i afrohem asaj porte të shumëëshiruar... Dhe më kumbojnë këto vargje të poetit: "U ktheva përsëri në qytetin ku kam lindur. / Një shi biblik / Lan prej shekujsh gjakun e perandorive të mundura." dhe më tej... "Më ka marrë malli për shirat e tu të qeshur,..."; kushtuar Shkodrës, që Migjeni i madh e quante: "... dashnorja e shekujve".

Edhe pse vij pas një kohë të gjatë pritjeje, nuk e ngatërroj portën; po nuk është më ajo e drunjtë. Është tjetër, me ca silueta si fragmente antikiteti. Bëj të trokas, por nuk është e nevojshme. Shpejt e kuptoj që ajo është pakëz e hapur. Mos vallë më ka pritur mua?.. Mos më njohu dhe u si një mikpritje u hap për mua?.. Gjithçka mund të hamendësoj... ndoshta është aventura e fundit e Gishtos... Megjithatë ajo rrinte hapur dhe unë e preka ngadalë. Mu duk sikur më foli ajo portë e drunjtë me një gjuhë poetike: "Lulëzoi druri i portës së vjetër. / Ah, druri i vdekur çeli lule!" (poezia: "Druri i portës")

Hyj aq lehtas, sikur nuk dua të trazoj qetësinë e atij kopshti, që i mungonte surrealizmi i luleve që të falte, tashtë kishte lule të tjerë ëndërrimtare dhe ishte zvogëluar kopshti pak si tepërmi. Sjell nëpër mend kujdesjet e tepruara të Fredit për kopshtin e lulet. Mënyra si bisedonte... - një magji e vërtetë!.. "Këndonin lulet dhe tregonin legjenda... / Ah, tërë trëndafilave të botës do t'u bie në gjunj / Veç ato legjenda s'kam për t'i dëgjuar më kurrë". Por, ama, mungonin trëndafilat e kuq, të bardhë e blu. Siç duket '... janë mbyllur në pikëllimin e vet'. Tani në këtë kopsht imcak shëtit vetëm trëndafilat i heshtjes e i shiut.

Pas kopshtit që 's'i them lamtumirë', ngjit ca shkallë dhe në njërin nga dhomat më pret i vëllai i Frederikut, Gjovalini,



Gjovali Reshpja vëllai i poetit Frederik Reshpja



Shtëpia e lindjes së poetit Frederik Reshpja

PAS 50 VJETËSH

Në shtëpinë e poetit Frederik Reshpja

Takimi i fundit me vëllain e poetit, mjekun Gjovalin Rreshpja, një ditë para se të vdiste... Shënimet e fundit në një bllok. "Të nesërmen e rikthimit aty, për të vazhduar bisedën siç e kishim lënë... më 13 korrik, papritur, u gjenda keq. Pashë letrën e vdekjes dhe fotografinë e tij..."

mjek, por i pamundur nga ana shëndetësore. Në sytë e tij shoh lodhje dhe një dukshmëri dëshpërimi. Nuk mund të lëviz, edhe pse mezi merr frymë, dëshira për një cigare është e padurueshme. (Unë nuk e dija, që ky ishte takimi i fundit me Gjovalinin. Do të ishin shënimet e fundit në bllokun tim. Do të ishin dhe shkrepjet e fundit të aparatit tim. Çdo gjë do të ishte e fundit... U largova, aty, nga ora 11.00; për të ardhur të nesërmen për të vazhduar bisedën përsëri..., se kështu e kishim lënë... Të nesërmen, datë 13 korrik, kur unë po shkoja ta takoja përsëri... Papritur, u gjenda keq. Pashë letrën e vdekjes dhe fotografinë e tij... Hyra përsëri në atë shtëpi. Tani për ta nderuar për të fundit herë, por... me bllokun tim të shënimeve që s'do të hapej më, po ashtu edhe me aparatit që nuk do të shkrepje më... Të afërmët e tij më thanë se kishte ndërruar jetë, mbrëmë.

Dhoma e poetit

Në dhomën ku punonte Fredi... dhe rikujtoj portretet e vajzave që ka bërë, rikujtoj dhe nudot. Ndoshta shenjat i la si dashuri, ku "Këndoi bilbili i vetmuar deri në dhembe, / Por askush nuk e dëgjoi zërin e tij, / Sepse i mungoi kafazi. Ndoshta si amanete i gdhendi në shumë tituj poezish, si: "Për një vjollcë", "Peizash vjeshtë", "Peizash nate", "Pastel", "Akuarel", "Tors"...

Qofsh i parajsës, miku im!..)

Teksa flet, ndonëse me ndërprerje, zëri i tij më ngjan si i Fredit, po ashtu tiparet, po ashtu lëvizjet. Gjovalini jeton me vetminë heshtare, kujtimet e të vëllait dhe të prindërve. Rrëfimi i tij ka ngjyra trishtuese dhe të ngadalta: "Fredë zakonisht punonte natën.

Se 'Çdo natë e ka një statujë timen brenda'. I vetëm në dhomë. Në qetësinë e natës dhe të heshtjes. Në prani, shpesh të hënës dhe të yjeve. Me dritë abazhuri. I shkruante aty vjershat. Por asnjëherë nuk kam dëgjuar në këtë shtëpi një varg të shqiptuar nga ana e tij. Kurrë nuk i recitonte poezitë. Ndoshta zakon i tij. Ndoshta ngaqë ishte i thjeshtë. Mbase ka pëlqyer dhe vetminë, një miqësi me të e pafjalë. Dilte pak. Nuk kish shumë shokë. I pëlqenin karafilat, lulekëmbanat, dhe veçanërisht lulet që vështronin nga dielli. I pëlqente të pikturonte. Bënte natyra të qeta, portrete. Edhe nudo ka bërë. Ka dhe vizatime. Sikur... lapsin e përdorte mirë. Po merrej edhe me skulpturë. Zakonisht bënte vajza me fustane të bardha – simbole dhuratash për martesë. Ishte dhe një dizinjtator. I shkëlqyeshëm ishte. Po më vjen çudi në ato fletore me vjersha që më kanë mbetur dhe kam ruajtur, është

Pesë lirika nga Frederik Rreshpja



Shtëpia e lindjes së poetit Frederik Rreshpja

DRURI I PORTËS

Lulëzoi druri i portës së vjetër.
Ah, druri i vdekur çeli lule!
Ti këputi dhe me to bëj kurorë,
për mua që të prita deri në vdekje.
Pash ngjyrën e gjakut dhe... lot,
që çelën në të tëra gjërat prej druri.
Ë kuptova që thika e pritjes më preu në brinjë,
kur çela gjethe si palmat.
Të prita, të prita...
Derisa çelën kameliët e mortjes te porta.
Ti mblidhi dhe më bëj një kurorë,
mua, që deri në vdekje të prita.

KËNGË LAHUTE

Më zuri gjumi i balladave
Dalin etërit pleq në prag të rapsodive
Dhe natë e ditë një zog më rri te kryet.
O ti zogu i zi i amanetit,
Për ku vrapon të bësh shi, o zog?
Dy-tre shira ranë e u bë dimër,
Dy-tre net u deshëm dhe u harruam.
Do të ngrihem e do të marr dynjanë
Por gjumi i balladave nuk më le.
Dy-tre shira ranë e u bë dimër,
Dy-tre net u deshëm dhe u grindëm.

KTHIM NË VENDLINDJE

Ja u ktheva përsëri në Shkodrën e mbretërve
ngritur gurë-gurë
mbi supet lakuria të një gruaje
nga vëllezërit trashëtarë.
Mbi degët e shirave këndojnë zogjtë
Nën pemën e madhe të mesditës
Gjethe të verdha bien mbi shpirtin tim.
Pastaj,
unë i hedh drejt qiellit për të bërë një vjeshtë
Ah, kur ishim të rinj dhe të bukur
Nuk na vajti mendja kurrë të bënim një vjeshtë
Por ti tani nuk je më...
Tani
ti je në fillim të stinëve

Ndaj nuk më intereson loja e ajrit dhe e diellit
Që ngrihet mbi re si mbi një sofër paganësh.
Shfaqen
në muzg trëndafilat e thurur me diell
Ah tani edhe trëndafilat na kujtojnë kamionët me
djemtë e vrarë
sa të bukur dhe të rinj ishin o Zot!
Mirupafshim o djem në një planet pa diktaturë
Në ajër
shfaqen patriarkët e poezisë shqipe
Bogdani, Fishta, Mjeda dhe Migjeni
Etërit e mij sillen në ajër se varret ua kanë thyer.
Tani edhe mermeri i zërit tim është i thyer
Tani që erdhi mbremja
statuja e nates troket në dritaren e vjetër
xhamthyer.

LIRIKË INTIME

Eja, mbështetemi te pema
Në vetminë e saj prej druri,
Te stoli të ulemi, eja
Në vetminë e tij prej guri.
Nën të njëjtin yll jemi ndeshur
A mund të rrimë pra të ndarë,
Si stoli me trungun e heshtur,
Mbjellë shumë vite më parë?
Në flakë vetëtime pashë
Ovalen dridhëse të buzëve
Dhe si një magji poshtë saj,
Gjithçka që në jetë më duhej.
Pastaj gjëmimin, unë ndjeva
Rininë tënde të përkulej,
Në çast u hepova si dega
Dhe gjeta gjithçka që më duhej.

POETI NË SHKRETËTIRË

Absurditetet pa asnjë mesazh për TV-të e
botës.
Rallë ndonjë re, arratisur nga kopeja e reve
Ikën e hutuar nga peisazhi arabik.
Ai rri aty me kokën në duart e shkretës.
U bënë me dorë avionëve.
Pret një dallendyshe që s'ka për të ardhur kurrë.

një shkrim i imët, dhe i pakuptueshëm. Më ngjajnë gerrat si hieroglif. Më vjen cudi dhe s'e kuptoj...

Fredi nga natyra ka qenë i ashpër. Dhe kjo 'ashpërsi' i ngjante një tufani që zgjaste vetëm dy minuta. Pastaj zbutej shpirti i tij, qeshte papushim dhe të dukej sikur tashmë para teje ishte një tjetër njeri dhe jo Fredi.

Unë prindërit i kam pasur malësorë. Baba Mark ishte nga Plani i Dukagjinit. Njeri i qetë. Dy herë nuk ka folë. Asnjë tipar të tij nuk trashëgoi Fredi. Nëna, Drandja ishte nga Xhani i Dukagjinit. Ishte inteligjente, burrneshë, e singertë. Cilësitë e nanës i trashëgoi më së miri Fredi. Hyj në dhomën ku punonte Fredi. Dhe rikujtoj portretet e vajzave që ka bërë, rikujtoj dhe nudot. Ndoshta shenjat i la si dashuri, ku "Këndoi bilbili i vetmuar deri në dhembje, / Por askush nuk e dëgjo zërin e tij, / Sepse i mungoi kafazi. Ndoshta si amanete i gdhendi në shumë tituj poezish, si: "Për një vjollcë", "Peizash vjeshtë", "Peizash natë", "Pastel", "Akuarel", "Tors", "Vizitime". Dhe në këtë vazhde sjell ndërmend poezinë e Lornës dhe vargjet për të: "Por ti në këtë botë erdhe për mua, jo për qiejtë. / Kemi qenë përherë bashkë, që të rinj, / Dhe tani më le! ... Mua më trishtojnë stinët. Ti e ke ditur, / Dhe me botën më ndan një udhë me kilometra vetmi. / ... Kemi thënë gjëra që

s'kanë për t'u kuptuar kurrë. / kemi ecur në tërë shekujt, para piramidave. / Emrat tanë kanë qenë gdhendur / Edhe kur nuk kishim shkëmbinj. (poezia: "Vdekja e Lornës"). Ndalem para portretit të nënë Drandes. Kthehem pas në vite. Dhe... kujtoj kur erdha për herë të parë në këtë shtëpi. Tani u bënë

dhomë. / Nganjëherë më pyet për librat që po shkruaj, / Por s'më ka pyetur kurrë pse s'kam shkruar gjë për të. / ... Se nëna e di: / Fjalën e parë në këtë botë ia kam thënë asaj. / Dhe fjalën e fundit në këtë botë asaj do t'ia them. (poezia: "Nëna").

Hap ngadalë dhe një raft të vjetëruar, ku mola ka bërë shumë 'fole'. Aty 'strehohen' disa këmbësorë të Fredit, disa kollare dhe kapelja (mbështjellur me dimrin e dhembjes), që më kujton: "Na zuri mëngjesi në udhë. / Moj kapelja ime e vjetër. ... Do të vijinë zogjtë do të bëjnë fole.

/ Moj kapelja ime e vjetër / ... Dhe në do të jemi më të vetmuar. ..." (poezia: "Dita e gjahtarëve")

Largohem nga kjo shtëpi... Më shoqërojnë: trishtimet, fati dhe pafati; plaga dhe

Trëfimi i vëllait

"Unë prindërit i kam pasur malësorë. Baba Mark ishte nga Plani i Dukagjinit. Njeri i qetë. Dy herë nuk ka folë. Asnjë tipar të tij nuk trashëgoi Fredi. Nëna, Drandja ishte nga Xhani i Dukagjinit. Ishte inteligjente, burrneshë, e singertë. Cilësitë e nanës i trashëgoi më së miri Fredi..."

50 vjet... Vështrimin dhe ecjen burrërore të saj nuk e harroj. As dhe bukën e sofrën që më ka nxjerrë shumë herë me dashuri, nuk e harroj! Eh, nanë Drande, nanë Drandë! Dhe... më ngjan se "Ecën ngadalë nëpër

shpirti, trëndafilat dhe puthja në sy, endrrat e yjeve dhe dhembja, fjala e pathënë dhe bekimi, ndarja dhe pritja, dimri, pabesia dhe dashuria; arkeologjia e perëndive dhe porta lënë hapur për zogjtë, lutjet e Shën Mërisë dhe lavdia e Iliadave, mallkimi dhe fjala e lirë, vdekja e ngjyrrave dhe stina e harrimit, shtëpia e gjetheve dhe miti i statujave, qefini i gjetheve të thara dhe shpirtat e pyjeve, planeti pa diktaturë dhe shtegu i mbuluar me lule-harresë, ulërimat e ciganëve me dauille dhe agimet e përgjakura nga thika e hakmarrjes, lahuta e muzgut dhe folklori i harruar i qeraxhinjve, gravurat e vjetra dhe bukuria që ende s'ka vdekur, shalli i ylberit dhe retë gri si mall i harruar, lutja e foshnjës dhe mermeri i zërit të thyer të Fredit që pëshpërit përjetësisht: "Unë do të mbetem në këtë tokë që quhet Shqipëri". Po largohem... nga kjo shtëpi... E di, që do të vij përsëri e përsëri... Portën, si gjithnjë, do ta gjej hapur... Do të hyj ngadalë në këtë shtëpi vetmie me kujtesë prej ajri, ku janë gdhendur sytë e poetit Frederik Rreshpja në moment pikëlimi, e që pikëllueshëm thonë: "Unë kam qenë trishtimi i botës", e...

Sidoqoftë, unë mund të shkruaj lirika moderne, Por, për mua është tepër vonë të shpik gjëra që nuk ekzistojnë Si përshembull lumturia. (poezia: "Sidoqoftë")
Shkodër, 12 korrik, 2014

POEZIA | ANALIZË

SAZAN GOLIKU

Nikolla Spathari, autor me një gamë të gjerë në fushën e letrave si shkrimtar humorist, poet, reporter, studiues, shkrimtar për fëmijë, si dhe me një hapësirë të gjatë kohë si krijues, ka bërë emër dhe është shquar me veprën e tij, por mendoj se me krijimtarinë poetike ka arritur vlerat më cilësore. Ndryshe nga shumica e poetëve, që lulëzimin e talentit poetik e kanë pasur në moshë të re, Nikolla Spathari pjekurinë e poezisë e ka arritur me pjekurinë e moshës.

Në kohën e realizmit socialist (që as realist nuk ishte, as socialist mund të ishte se nuk ishte nocion artistik) edhe Nikolla nuk mund t'i shmangej retorizmit e patetikës, si të gjithë poetët e asaj periudhe historike, por evoluimi i tij si krijues, si te shumë shkrimtarë të tjerë pas rënies së diktaturës, na solli një poezi të re e të freskët.

Edhe në ditët e sotme ai nuk i shmanget krijimtarisë së angazhuar, përkundrazi uni i tij poetik shkrihet shpesh me shqetësimet, problemet e interesat e shoqërisë e të atdheut, duke ecur kështu në vazhden e traditës sonë poetike, po dhe të asaj botërore.

Vetëm lum rri zgjuar
Dhe era që çon monologun gjer në fund,
Mbi fjalëkryqin e së ardhmes
Rri zgjuar dhe unë...
(Natë në Shkodër)

Poezia lirike, sidomos ajo e dashurisë, i ka dhënë ngjyrën e tonin mbizotërues krijimtarisë poetike të Spatharit dhe zë një vend të konsiderueshëm e më cilësor në diapazonin e saj semantik dhe emocional. Shprehja e ndjenjave të dashurisë erotike, situatat e marrëdhënieve dashurore, dramata reale e virtuale me femra të ndryshme në kohë e vende të ndryshme kanë shkallëzime e ngjyresa që variojnë nga ndjesitë e moshës së adoleshencës, të rinisë e burrërisë.

Se ndjenjat tek unë nuk janë thinjur,
Ashtu siç nuk thinjen perënditë,
Si thua, t'i hedhim në zjarr pasaportat
Dhe porta ylberesh të hapim çdo ditë?!

(Në djall pasaportat)

Shndërrimi në motiv i një situatë dashurore, ndarjet, braktisjet, shpërthimet e xhelozisë etj. perceptohen nëpërmjet një subjektivizmi të çiltër madje herë-herë të ashpër. Egocentrizmi i heroit lirik të Spatharit përshfaqet e kristalizohet duke na dhënë një figurë burrërore, larg lektisjeve sentimentale ose përbitimeve të eksagjeruara romantike. Ai është njeri pasionant, i përmbajtur dhe i guximshëm, por në të gjitha situatat e gjendjet psikike mbetet thellësisht njerëzor. Autori nuk ndruhet të shpreh poetikisht edhe koncepte të një dashurie të lirë, çka i jep ndjenjës doza eksplicite sinqeriteti. Spathari, sa larg i qëndron frymës anakronike të poezisë, po aq kujdes tregon për të mos rënë pre e joshjes së një poezie që konvencionalisht do ta quaja "lakurike" ose "të paturpshme". Duke shpalosur një botë shpirtërore të pasur e të larme, nga simpatitë e çastit deri te gjakimi i zjarrtë, poeti manifeston një shkallë të lartë ndjeshmërie e sensualiteti.



Nikolla Spathari me poetin Ali Podrimja

Paradigma lirike në poezinë e Nikolla Spatharit

Erotika e Spatharit është e lezme, siç do ta quante Martin Camaj, por herë-herë edhe e ashpër, shpërthyesë, e kushtëzuar nga marrëdhëniet komplekse të dashurisë....

"Mos kërko të ta këndoje më këngën tënde!

Te varri i erës vdiq melodia,
Zëri im mori formën e dashurisë dhe iku
Në qiej ku s'ka kuptim pabesia.

U thye akustika e muzgut
Në mallin e këngës që nën yje u shemb,
Tani mund të vish e ta marrësh kitarën
Dhe ta bësh copë-copë te njëshkëmb."
(Kënga jote)

Lirizmi në poezinë e Spatharit gërksetohet me meditim, po deri në atë shkallë që nuk i prish raportet mes tyre, çka e ka ruajtur për të mos rënë në cerebralitetin që ngrin ndjenjën dhe shua imazhin poetik. Duke qenë më tepër reflektive sesa meditative, kjo lirikë nuk e humbet kurrënjehër piksynimin e autorit për të komunikuar lirshëm me lexuesin.

Nikolla Spathari është njohës e studiues i etnografisë e folklorit të veriperëndimit të Shqipërisë. Ndikimi i këngëve popullore në poezinë e tij lirike është e qensishme, por na vjen i tejdukshëm, i plazmuar me finesë, në frymë. Poeti e ka shmangur me mjeshtëri rënien në imitim formal e shabllon të poezisë popullore, pra në folklorizëm të rëndomtë si një pjesë e poezisë sonë e viteve '50 e '60 të shekullit të kaluar.

Do të ishte e verbër një poezi erotike nëse në një mënyrë ose një tjetër nuk do të "pikturonte" bukurinë e hijeshinë e të dashurës së zemrës të heroit lirik, i cili jo domosdoshmërisht duhet njëjtësuar me poetin. Penelatat e Spatharit janë të kursyerat, po ekspresive, lakonike dhe larg hiperbolizimeve që karakterizojnë një pjesë të poezisë tradicionale.

Erotika e Spatharit është e lezme (siç do ta quante Martin Camaj), por herë-herë edhe e ashpër, shpërthyesë, e kushtëzuar

nga marrëdhëniet komplekse të dashurisë. Dihet që dashuria dhe urrejta, xhelozia, shpërfillja, zhgënjimi bashkudhëtojnë në format më paradoksale të ekzistencës sublimë të botës shpirtërore të njeriut, kushdo qoftë ky, në çdo vend e në çdo kohë. Në disa poezi autori nuk i shmanget as zemërimit, as paradokseve, as humorit.

"Më lini këtu
në viset e largëta të braktisjes,
te mështekna e cunguar
nën britma suferine,
ku mungon tashmë intimiteti i pritjes,
ku s'ka më vend as në shpresën time."

(Braktisja)

Nëpërmjet një ironie të dukshme buron humori në këto vargje:
"Ti thua se në buzë
T'ka mbetur vetëm helm.
Vërtet, çdo pikë mjalti
nga buzët e tua është tretur
dhe tani atje
vetëm helm ka mbetur?!"



LIBRI | I RI

Shën Pali punoi në brigjet e Adriatikut

Studiuesi Thanas gjika ndërton skemën e udhëtimit të apostullit Pal, duke përvijuar kalimin e tij edhe në zonat fshatare të Tiranës, Mirditës, Zadrimës e më tej Lezhë, Durrës e Nikopoli...

AKADEMIK, PROF. DR. JORGO BULO

Apostulli Pal është një nga përhapësit e parë të krishtërimit, misionar i përkushtuar për shpëtimin e fesë së krishterë prej judaizmit dhe kthimin e saj në fe botërore. Ky personalitet ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e historianëve të krishtërimit, teologëve dhe filologëve të teksteve të shenjta.

Deri më sot, për jetën dhe veprën e tij janë shkruar shumë biografi e komente, por studimi që kemi në dorë, është një biografi që mëton të shtrojë teza të reja e të sjellë të dhëna faktike të reja faktike të nxjerra kryesisht prej tekstit biblik, duke përdorur një metodë të re studimi dhe analiza të thelluara. Në këtë studim, që shquhet për frymën kritike e polemike, ndiqen hap pas hapi lëvizjet e Shën Palit dhe rrugëkalimi i shoqëruesve të tij si Luka, Timoteu, Marku, Apolloni, Sosteni, Sopatri, Onesimi, Dema etj. Kjo i ka dhënë studimit karakterin e një biografie paralele të jetës së heroit dhe të shoqëruesve të tij.


Një aspekt tjetër i ri i këtij studimi është dhe përpjekja për të nxjerrë në dritë rolin ndikues të këtij apostulli në krijimtarinë epistolare të Pjetrit, Jakobit etj.

Pohimet e disa studiuesve se në trashëgiminë epistolare të Palit ka katër letra të përbëra nga bashkimi i fragmenteve të letrave të dëmtuara, studiuesi Gjika i shpie më tej, duke sqaruar se në letrat paliane ka gjashtë letra të përbëra. Duke nxjerrë fakte prej tyre, ai përcakton kohën, vendin dhe shkakun pse është shkruar secila letër prej së cilës ruhet fragmenti. Kështu, ky studim e pasuron jetën dhe krijimtarinë e Shën Palit duke mëtur të saktësojë data dhe vende të hartimit të letrave të tij, çka ka shpënë në zgjerimin e udhëtimit të tij të tretë misionar edhe në qytetet e bregdetit Adriatik. Me interes të veçantë është teza e re sipas së cilës letra kryesore e Palit, letra kanoni-ke Romakëve është letër e përbërë nga bashkimi i një letre të plotë (Rom 1-15), shkruar në Durrës në verë të vitit 56 mb. Kr., dhe i një fragmenti që i përket një letre të shkurtër rekomanduese, të cilën autori e shkroi në portin Kenkrea të Korintit në mars të vitit 57 mb. Kr.

Problemi i vizitës së Shën Palit në trojet ilire ka qenë i njohur dhe i pranuar prej shumë historianësh dhe studiuesish të Biblës, mbasi vetë ky apostull ka shkruar se e predikoi Fjalën e Zotit deri në Ilirik. Mirëpo interpretimi i këtij pohimi paraqet mëdyshe, studiuesit nuk kanë dhënë

Biografia

Një biografi për Shën Palin që mëton të shtrojë teza të reja e të sjellë të dhëna faktike të nxjerra kryesisht prej tekstit biblik, duke përdorur një metodë të re studimi dhe analiza të thelluara...



Mbi autorin

Prof. as. dr. Thanas Ligor GJIKAI u lind më 2 korrik 1944 në Korçë, ku mbaroi gjimnazin. Studimet e larta i kreu në Tiranë në vitet 1962-66 në USHT, Fakulteti Histori Filologji, dega Gjuhë Letërsi Shqipe. Në vitet 1966-69 punoi si redaktor e gazetar në Radio Tirana. Në vitet 1970-1996 punoi në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë të A.Sh.Sh, ku mori formim për analizën e tekstit letrar e publicistik. Ka shkruar e botuar shumë artikuj, kumtesa, referate dhe disa vepra shkencore si Mihal Grameno Publicist Demokrat 1980, 277 f.; Kur Dhe Ku u Shkrua Dhjata e Re 2007, 503 f.; Evolimi Ynë Kërkon Njohjen dhe Dënimin e Fajit 2011, 308 f.; Mihal Grameno, jeta dhe vepra. 2012, 506 f.

S'ka gjë,
unë farmakut tënd i gëzohem,
por më thuaj, kur të vij
e të helmohem?" (Shiu)
Ja si i drejtohet heroi lirik krutanes së
bukur, e cila ka sfiduar me hezitimin e saj:
"Të të them bëhu imja
doemos jam gati,
por s'dua të thyhem në muret e Krujës
siç u thyë dikur Sulltan Murati." (Bëhu
imja)
Ja dhe një "deklaratë" paradoksale:
"Dashuria jonë është çmënduri,
por çmënduritë janë më të bukurat."
(Eja të ikim)

Vizioni poetik i këtij poeti është i
pandarrë nga natyra. Ai e gatuan brum
e qelqtë të motivit me elemente që
e rrethojnë, të cilat i lirojnë ndjenjat e
kundërta, duke i shpërndarë nga gravita
cionit i egoizmit të natyrshëm njerëzor.
Natyra nuk është vetëm skena ku zhvil
lohen e këndohen motivet e dashurisë, po
dhe elementet figurative më të cilat autori
operon si hëna, yjet, deti, lumi, drurët,
hijet, era, stuhitë. Ai i shpirtëzon këto
dhe në vorbullën e ndjenjave i percepton
si një amalgamë në lëvizje të ndezur nga
pasioni.

Tek fantazmat e hijeve
Erdhi hëna,
Si një çupë e ndrojtur
Që don të shuaj mallin,
U iku yjeve dhe ra shpejt te pellgu
Në një idil të çuditshëm me malin.
Kështu dhe ne në një natë yjesh,
Duke shpërndarë rreze të rëna,
U gjetëm së bashku në pasqyrat e
pellgut,
Siç u gjetën sonte mali dhe hëna.
(Pasqyrimi)

Gërshetimi i detajeve konkrete jetësore
me një metaforikë të goditur funksionale,
po aspak të rënduar, e gjallëron imazhin
në këto lirika dhe e bën të komunikueshme
ndjenjën që synon të transmetojë poeti.
Ky procedim stilistik, që flet sa për intu
itën, aq dhe për përpunimin e kujdeshëm
mjeshtror të çdo vargu të poezisë, reali
zation atë që e quajmë ekonomizim të fjalës
e të figurës stilistike.

Poeti ka përdorur larmi vargjesh të të
e gjashtë rrokësh tradicional, deri te var
gjet e lira, të cilat kanë veçoritë e tyre, sa
herë-herë mund të pranohen si vargje të
thyer, ku nuk mungojnë rimat, asonancat
e konsonancat. Duhet të vë në dukje një
karakteristikë metrike të vargëzimit të
Spatharit: Përdorimi i rimës në poezitë
me vargje të lira vetëm në vargune tretë
(nga fundi) me vargun e fundit të strofës.
Poetit ia do veshi tingëllimën e rimës edhe
si mbështetje akustike e përfundimit të
strofës e të poezisë.

"Mollët presin këputjen biblike,
por Eva
mbi degë i ka harruar,
ajo ka ikur me mua atje ku bëhen
mekate moderne.
Mëkati i mollës është shumë i vjetruar."
(Eva dhe mollët)

Po e mbyll duke përmendur një thënie
domethënëse të kritikut të mirënjohur
Benedeto Kroce: "Jeta perëndon, po dhe
perëndimi ka bukurinë e vet; edhe ai sjell
dicka, që rinia nuk e ka, dhe e plotëson
me dhuntitë e veta atë që humbet nga
ana tjetër."

një shpjegim të qartë se si dhe kur
shkoi ai deri në Ilirik, në cilat vende
ndaloj para se të arrinte atje, dhe në
cilat qytete ndaloj kur u largua prej
provincës së Ilirikut e mbërriti në
Korint të Akesë (Greqisë). Përmes
fakteve që paraqet, ky studium
ndërton skemën e tij për udhëtimin
e tretë misionar të apostullit Pal,
duke përvijuar kalimin e tij edhe në
zonat fshatare të Tiranës, Mirditës,
Zadrimës dhe në qytetet bregde
tare të Adriatikut lindor, si Lezha
(Lissus), Durrësi (Dyrrachium) e
Nikopoli (Nikopolis).

Në hartat e mëparshme që e prano
nin vizitën e Shën Palit në trojet
ilire, përvijohet vajtja e këtij apostulli
në mënyra të ndryshme. Diku përvij
ohet vajtja e tij prej Thesalonikut
deri afër Shkodrës dhe kthim në
Thesalonik e më tej në Korint; diku
përvijohet kalimi nga Thesaloniku
në Durrës, pastaj kalimi në Nikopol
e më tej në Korint; diku përvijohet
vajtja e tij nga Thesaloniku në Dur
rës e kthim në Thesalonik e më tej
në Korint.

Lidhur me botën iliroshqiptare,
një risi tjetër e këtij studimi është dhe
ndërtimi i udhëtimit të katërt misio
nar të Shën Palit, udhëtim që u krye
pasi apostulli u lirua prej burgimit të
parë të Romës. Ky aspekt është tra
jtuar pak në biografitë e mëparshme
ose, sipas autorit, është trajtuar keq.
Në këtë pjesë të studimit Gjika ka
provar se Shën Pali nuk shkoi drejt
Spanjës, siç hamendësohet pa argu
mente nga studiues të ndryshëm,
por drejt Jerusalemit, sepse aty
ishte vrarë drejtuesi i kishës, Shën
Jakobi. Shën Pali kaloi nga Roma
në Brindis, në Durrës, ku mori Apol
lonin; në Nikopol, ku mori Titin; në
Kretë, ku la Titin për të ndrequr disa
gabime në organizimin e kishave; në
Cezarea të Judesë, ku i shkroi letrën
Titit; në Milet, ku la Trofimin të
sëmure; në Nikopol, ku kaloi dimrin
e viteve 62-63 mb. Kr. Kur u kthye
nga ky udhëtim në Romë, apostullin
Pal e riburgosën dhe mbas një viti e
vranë bashkë me Shën Pjetrin e të
krishterë të tjerë më 29 qershor të
vitit 64 mb. Kr.

Hartat e udhëtimit të tretë e të
katërt misionar të apostullit Pal në
këtë studim paraqiten më të plota e
më bindim.

Për vlerat që ka ky studim, për
pasionin e kërkimit dhe tezat e reja
që parashtron, mendojmë se duhet
botuar sa më parë në gjuhë të huaja.
Me të dhënat e reja të këtij studimi,
tekstologjia biblike shqiptare ka
mundësi të realizojë një botim të ri të
Dhiatës së Re me shënime dhe harta
të reja, veprë që mund të botohet më
tej edhe në gjuhë të tjera.

EKSPOZITA | VLERËSIMI

DHURATA HAMZAI

Mund të kishte zgjedhur për të bërë ironi me fenomenin Facebook çdo lloj diktatori, por arsyeja pse artisti Helidon Gjergji zgjodhi Stalinin është një lloj lidhje me të kaluarën e tij. "Jemi shqiptarë dhe e kemi vuajtur diktaturën staliniste. Mund të kisha zgjedhur dhe nënën e Hitlerit, Musolinit, Sadamit, etj", thotë artisti. Helidoni ka zgjedhur figurën e diktatorëve, sepse edhe imazhi i tyre për publikun ishte gjithmonë i kuar, me një buzëqeshje reklamuese dhe plot ëmbëlsi. Në Facebook kështu ndodh, sipas tij. "Unë mora një ekstrem në mënyrë që ta bëj të dukshëm këtë problem, që ekziston me Facebook, ose në përgjithësi me rrjetet sociale, me mediat", thotë Helidoni. Ai ka ekspozuar tri punë në ekspozitën e çelur në Galerinë Kombëtare të Arteve, që do të qëndrojë e hapur deri më 24 gusht. Puna më e madhe është videoinstalacioni "e-mages". Përmbytja e tij është rreth Facebook-ut, rrjeteve sociale. Aty buron ironia sesi rrjetet sociale e shndërrojnë realitetin, që artisti thotë se "është falco". Helidon Gjergji të jep të kuptosh se njerëzit për t'i publikuar në Facebook përzgjedhin momentet më të bukura dhe dalin jashtë kontekstit të vërtetë real. Frika e artistit është njësimi i njerëzve, ku të gjithë bëhen të barabartë dhe nuk njihet fytyra e vërtetë e tyre. Vepra e-mages shpallet me një video-projeksion ku duket Ketevan Geladze, nëna e Stalinit, e cila ka përzgjedhur disa fotografi prej albumeve të familjes saj për t'i "publikuar" këto në Facebook. Ndërsa vërejmë se "e-mages" shoqërohet me një vals nga Shostakovitch, që ishte kompozitori i oborrit të Stalinin. Është një muzikë që duket se i shkon këtij videoinstalacioni, ose ndryshe këtij publikimi të shqetësuar në facebook. Helidon Gjergji fenomenin Facebook e ka përdorur emocionalisht dhe e ka përkthyer filozofikisht në art për ta parë me vëmendje edhe shikuesit këtë fenomen global. Është një statistikë në Amerikë që nga 8-11 orë njerëzit i harxhojnë para një ekrani. "Pra ne kthehemi vetë në qenie dydimensionale, humbim realitetin tonë. Por realiteti është zevzek, të kthehet dhe të vret. Është një realitet jo i vërtetë, është hiper-realitet", thotë Helidon Gjergji për atë çfarë njerëzit kuptojnë duke naviguar për një kohë të gjatë në Facebook. Ndërsa ka projektuar një video, siç thotë ai pak ironike. Ironia e artistit është shumë inteligjente, duke marrë si personazh nënën e Stalinin (ajo nuk është më në këtë jetë, por po të ishte..., sigurisht do të hapte një adresë në Facebook dhe në të do të publikonte fotografite e familjes së saj, por jo me aktivitetet politike, kryesisht me imazhe familjare, në çaste gëzimi apo dhe trishtimi). Dhe duke e kthyer këto imazhe në ekran ai Helidoni sjell përmes videos imazhin e rrjeteve sociale. Sigurisht ajo që e lëvdon gjithmonë fëmijën e saj është



Artisti Helidon Gjergji



Videoinstalacioni "e-mages" i Helidon Gjergjit në Galerinë Kombëtare

Artisti

Ai ka ekspozuar tri punë në ekspozitën e çelur në Galerinë Kombëtare të Arteve, që do të qëndrojë e hapur deri më 24 gusht. Puna më e madhe është videoinstalacioni "e-mages". Përmbytja e tij është rreth Facebook-ut, rrjeteve sociale. Aty buron ironia sesi rrjetet sociale e shndërrojnë realitetin, që artisti thotë se "është falco"

Helidon Gjergji ironizon fenomenin Facebook me nënën e Stalinin

Ja çfarë rrëfejnë tre videot e ekspozuara në Galerinë Kombëtare të Arteve. Koncepti i artistit për fenomenin e facebookut. A është ky një problem global?

mamaja. Ndaj është ironike kur Stalin ky diktator i egër bëhet një figurë pozitive. "Nëna e shikon si një 'engjëll' si të gjitha nënat, por ne e dimë kush është Stalin", thotë Helidon Gjergji duke na shpjeguar me qartë mesazhet që vijnë

nga "e-mage. Ndërkohë Videoja tjetër është një "Picture TV", që është një televizor i vjetër ku ndërrohen kanalet vazhdimisht dhe krijohet një situatë abstrakte. Nuk punon mirë dhe abstrakton çdo imazh të televizorit, kthehet në diçka estetike dhe humbet përmbytjen. Videoja e tretë është "The Blue Danube" që ka të bëjë me realitetin dhe çfarë fshihet pas tij. Gjergji pohon se është një hidraulik që vjen dhe diagnostikon sistemin e ujërave të zeza në shtëpinë e tij. Ndërkohë në video ai duket poetik, por ja që lidhet e tij janë me ujërat e zeza.

Kësaj videoje artisti ironikisht i ka vënë muzikën e Shtrausit, "Danubi Blu".

JETA E ARTISTIT SHQIPTAR NË BRUKLIN

Helidon Gjergji jeton në Bruklin, në një



Diktatori rus Josif V. Stalin



Nëna e Stalinin

lagje të Nju Jorkut. Këtë herë falë ftesës nga drejtorja e GKA-së ai është kthyer me shumë dëshirë në Shqipëri, por nuk nguron të thotë se shtysat për të bërë një art të gjallë nuk do mund të ishin këtu si në Amerikë, apo në Bruklin, ku jeton artisti shqiptar. Helidon Gjergji shprehet edhe për mungesën e infrastrukturave të galerive dhe muzeve këtu në Shqipëri. Helidon Gjergji shprehet se për karrierën e tij e kanë ndihmuar edhe një rrjet profesional artistësh ndërkombëtar, ku ai ka mundur të përfaqësohet edhe nëpër bienale. Në to, jo rrallë herë është takuar edhe me artistët e talentuar shqiptarë si

Anri Sala, Artan Shabani, Sislej Xhafaj, etj, etj. Helidon Gjergji është larguar që në vitin 1991 nga Shqipëria. Fillimisht nisi studimet në Akademinë e Arteve në Napoli dhe më pas shkoi të studiohej në Nju Jork. Pas diplomimit me master në Çikago, ai është ftuar nga Francesco Bonami, një kurator i njohur, që të merrte pjesë në Bienalen e Tiranës, që u zhvillua në vitin 2001. Që nga ajo kohë ai ka mundur të ekspozohet me veprat e tij së paku tre herë në Tiranë, por kjo është e para ekspozitë e personale që ai çel në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë. Këtë ai e konsideron si një gjurmë të rëndësishme në jetën e tij.



NGA ARBEN DUKA

SATIRË POLITIKE



Pak e nga të gjitha..

vijon nga faqja 1

...Po nga sa dëgjova,
ndryshe mendoj unë,
sepse Celibashi,
do ta bëjë një punë!

Do ta bëjë një punë,
do ushtrojë zanatin,
se si ca të tjerë,
dorëzoi dhe mandatin!

E kam thënë që vjet,
dhe jo prej inatit,
është gabim i madh,
lënia e mandatit!..

Lënia e mandatit,
të fut në një cak,
kur s'je deputet,
do jesh frikacak!

Do jesh frikacak,
edhe jo më kot,
se kryeministrin,
s'e kundërshton dot!

Kush nuk ka mandat,
është ndënë furtunë,
se e shkarkon Rama,
dhe mbetet pa punë!

Kush ende e ka,
hiç mos e dorëzojë,
se në fakt mandati,
është një mburojë!

Është një mburojë,
dhe mburojë e fortë,
sepse në Kuvënd,
përkthehet në votë!..

Dhe që ta vazhdojmë,
këtë muhabet,
jo të gjithë kusarë,
janë në këtë shtet!

Dhe t'i vëmë tamam,
kokë muhabetit,
ka disa që rrojnë,
veç me rrogë të shtetit!

Njoh disa që rrojnë,
me rrogën e shtetit,
ose të ministrit,
o të deputetit!..

Dhe më saktësisht,
të jemi më bruto,
veç me atë rrogë,
jeton Pirro Luto!..

Dhe këmbët i shtrin,
aq sa ç'është jorgani,
them se këtë prerje,
ka dhe Ilirjani!

Kur i çova libra,
kur bënte fushatë,
s'kish me se t'i blinte,
ndaj ja dhashë dhuratë!

Po pse e dorëzove,
Celibash-o lumë,
për atë mandat,
ti u lodhe shumë!..

Nuk e dimë në ike,
a dikush ta nguli,
por ty po të lëmë,
dhe po shkojmë tek Luli!

Them se shqipen mirë,
e artikulon,
po nga gojë e Bashës,
çudira dëgjon!

Hartë e Bashkim Finos,
u anatemia,
sepse zëri kundër,
fare s'u dëgjua!

Ti Luli lundron,
në një tjetër lundër,
ku ta gjente Baçua,
atë zërin kundër?!

Me muaj me rradhë,
u prit i shkreti,
si të ishit Krishti,
edhe Muhameti!..

Zëri s'u dëgjua,
dhe kjo lehtë kuptohet,
sepse që nga SHQUP-i,
në Kuvënd s'dëgjohet!

Gjersa ti me Salën,
urdhëruat bojkot,
për punën e zërit,
mos fol si idiot!

Të gjithë mazhorancën,
ti e bërë pluhur,
po fjala do thënë,
në vëndin e duhur!..

Edhe unë për sot,
me kaq po e lë,
ZËRI S'U DËGJUA,
SEPSE S'KISHTE ZË!...

VARGJE PËR KËNGË..

Ti që më sëmure..

Si xhind i tërbuar,
rrugën se ç'ma zure,
me një të vështruar,
bo-bo ç'më sëmure!..

Në siklet më vure,
më hodhe në stromë,
ti që më sëmure,
eja dhe shëromë!..

Erdhe i ndriçuar,
si një rreze drite,
me një të vështruar,
prapë në këmbë më ngrite!

Ata që s'na duan,
nga inati plaçin,
ti që më sëmure,
kishe dhe ilaçin!

Nata..

Më pyet një vashë kurioze,
pse është nata misterioze,
kur ka yje që ndriçojnë,
magjinë më shumë ja shtojnë?!

Vashë e dashur me dy fjalë,
unë do të ta them si djalë,
Zoti natën për njerinë,
e bëri për dashurinë!..

Sepse do një dashuri,
më të madhen fshehtësi,
ditën s'ngjit e shkreta fare,
është si puna vullnetare!

Nata ka vërtetë magji,
të kesh dritë sa një qiri,
marrin gratë nur Perëndie,
pakëz dritë e shumë hije!

Në një gjysëm errësirë,
dashuria është e mirë,
vetëm pak-po pak rozë,
i bën çiftet misteriozë!

» **KLIPI I RI**

FANSAT kanë filluar ti japin epitelin e Kim Kardashianit, për shkak të fotove të nxehta që ka postuar ditët e fundit, në rrjetet sociale

Beatrix Ramosaj sakrifikon për dashurinë

“Qysh Ki Qef”, klipi që rikthen fuqishëm në treg këngëtares në sezonin veror

Beatrix Ramosaj sakrifikon për dashurinë! Sigurisht për dashurinë në klipin e saj më të ri “Qysh Ki Qef” e cila së shpejti premtan se do të godas fansat. Edhe pse e re në moshë, ajo tashmë ka pushtuar tregun muzikor me klipe dhe projekte pafund. Për “ThashThem”, Trixa rrefën se kënga “Qysh Ki Qef” është këngë e rrymës pop, e cila erdhi si bashkëpunim i Seven Saraqit, kompozitorit Lirian Lurro Kaqit dhe vargjet e Asdrin Gjick-

ollit, ndërsa klipi nga “Pro...Video”. Fabula e këngës flet për dashurinë, për një vajzë e cila është e gatshme të sakrifikojë çdo gjë për të dashurinë e saj. Pas suksesit të këngës “Pa ty”, Beatrixi po punon shumë për të qenë prezente në tregun muzikor. Për këtë arsye ajo tregon se kjo verë ka qenë shumë e ngarkuar me projekte të reja muzikore, duke lënë pas çdo angazhim tjetër. “Vera ime ka qenë shumë e ngarkuar me projekte të reja. Për këtë arsye, kam refuzuar çdo ofertë që më është bërë për

koncertet brenda dhe jashtë Shqipërisë. Pas disa ditë pushimeve në jug të Shqipërisë, tani jam çdo ditë në studio duke ju përkushtuar projekteve të reja”, tregon Beatrixi. Ndonëse është e re në moshë, këngëtarja ka një fizik të hatashëm. Për këtë arsye pak ditë më parë është komentuar në rrjetet sociale për format e saj trupore. Fansat e shumtë të saj kanë filluar ti japin epitelin e Kim Kardashianit, për shkak të fotove të nxehta që ka postuar ditët e fundit, në rrjetet sociale.

**Kënga**

Nora realizon remiksin e “Gangsta” me D Red

Nora Istrefi ka publikuar remiksin e këngës së saj të suksesshme “Gangsta” në bashkëpunim me deejayn e saj zyrtar, Dj D Red. Ky bashkëpunim ishte i pritshëm pasi dihet se, D Red dhe Nora kanë vite se bashkëpunojnë në koncerte në të gjitha trojet shqiptare. Këngën origjinale e ka punuar Zzap n'Chriss me video të Entermedias.

Këngëtarja

Zhvishet edhe Rita Ora, imiton Miley Cyrus


Ajo padyshim që tashmë është ikona më e ndjekur në shoë-biz. Bëhet fjalë për këngëtares me origjinë shqiptare Rita Ora e cila dhe ajo nuk i ka rezultuar tundimit për tu zhveshur, Sipas “Daily Mail”, këngëtarja Rita Ora është fotografuar thuajse nudo në majën e një ndërtese në Los Angeles, si reagim-kopje ndaj Miley Cyrus e cila bëri të njëjtën gjë para pak kohësh. Në koleksionin e fotografive të publikuar gjatë qëndrimit të Ritës në Los Angeles, është i pranishëm edhe vëllai i këngëtares me origjinë kosovare Doni.

**Konflikti**

Stresi kërcënon Ledrin dhe Mc Kreshën

Duket se reperi kosovar Ledri Vula i ka shpëtuar një sherri që pritej të ndodhte mbrëmë në Tiranë. Ai kishte paralajmëruar se do të performonte në Folie Terrace, ndërsa në anën tjetër Stresi e kishte kërcënuar se do ti tregonte burrërinë në Tiranë. Këto fjalë të stresit erdhën pas një foto ku Ledri u pa bashkë me “dikur”

armikun e tij të përbetuar, Noizyn. Në një intervistë për “Krej Real”, Stresi thotë se Ledri është femër, dhe më parë do të bënte seks me të në shtrat se sa me një femër. Ndërsa për Kreshën thotë se i ka të anuluar disa koncerte në Tiranë, pasi siç thotë edhe në intervistë është ai i cili vendos se kush do të performojë në Tiranë.

**Kalendari Kulturor****GALERIA KOMBETARE E ARTEVE**

- Më 6 Gusht 2014, ora 19.30, çelet ekspozita “Manipulations” e artistit të njohur Çene. Në ekspozitë do të paraqiten rreth 70 punime në teknikën tempera-akrilik mbi letër dhe akuarel mbi letër. Pikturat në këtë ekspozitë janë një imazh jo real, i abstraktuar përmes ngjyrave, të cilat vijnë me një gjuhë shumë më të qetë, janë më pak kontraktuese dhe anojnë drejt plotësisë dekorative.

**PROGRAMI I FILMAVE NE RRJETIN IMPERIAL PER DT 31.07.2014- 07 .08.2014****SALLA 1**

- -“Hercules” 3D / 13:00 / 20:30 / Çmimi 500 Leke
- -“Guardians Of The Galaxy” 3D / 18:00 / Çmimi 500 Leke
- -“Postman Pat” 2D/ 15:30 / Çmimi 500 Leke
- -“22 Jump Street” 2D/ 22:15 / Çmimi 500 Leke
- -“Planes: Fire & Rescue” 3D/ 10:30 / Çmimi 500 Leke

SALLA 2

- -“Hercules” 3D / 11:00 / Çmimi 500 Leke
- -“Guardians Of The Galaxy” 3D / 21:00 / Çmimi 700 Leke
- -“22 Jump Street” 2D/ 18:30 / Çmimi 500 Leke
- -“Dawn Of The Planet Of The Apes” 3D/ 16:00 / Çmimi 700 Leke
- -“Maleficent” 3D/ 13:30 / Çmimi 500 Leke

KINEMA AGIMI

- -“Hercules” 3D / 17:30 / 22:15 / Çmimi 500 Leke
- -“Guardians Of The Galaxy” 3D / 12:30 / 20:00 / Çmimi 500 Leke
- -“Postman Pat” 2D/ 10:00 / Çmimi 500 Leke
- -“Planes: Fire & Rescue” 3D/ 15:00 / Çmimi 500 Leke

PREMIERE BOTERORE DT. 07.08.2014

- 1- SexTape 2D

» GJIROKASTRA

“Traku-Fest” destinacioni i kulturës e turizmit

Eventi, qyteti i ngurtë tërhoqi
vëmendjen e qindra turistëve të huaj

XHULIA KARAVELLA
TIRANE

Prej dy ditësh dhe dy netësh Gjirokastra u shndërruar në destinacionin e mjaft aktiviteteve të ndryshme që kulmoi në një të vetëm që quhet TRAKU-Fest ose ndryshe, Festivali i Trashëgimisë Kulturore. Festivali i Trashëgimisë Kulturore e ka shndërruar Gjirokastrën në një destinacion me aktivitete nga më të ndryshmet në mes të këtij sezoni. Nisja e këtij festivali është shoqëruar me pjesëmarrje masive në Pazarin Karakteristik, i cili është gjallëruar si kurrë më parë. Rryma

të ndryshme muzikore nga punk, rock, jazz, nga banda të ndryshme apo dhe nga Dj të ndryshëm, kanë performuar në qendrën e zonës historike duke gjallëruar rininë e pranishme. Ajo që e bëri më të veçantë “Traku-Fest”, ishte dhe ardhja e një çifti që u kurorëzua në martesë po në këto ditë të zhvillimit të këtij aktiviteti që promovon vlerat e Gjirokastrës. Për organizatorët pjesëmarrja tregon se tashmë me afirmimin e rinisë në aktivitete të tilla synohet njohja e këtyre vlerave kulturore e historike si dhe traditës gjirokastrite. “Nuk besoj se mund të ketë një hapësirë të dytë, kunë kaq pak kilometra katror njerëzit mund të gjejnë edhe kulturën e lashtë siç është Antigoneja dhe Adrianopoli në luginë. Edhe kulturën edhe gjithë trashëgiminë otomane në mënyrën se si është ndërtuar qyteti i Gjirokastrës dhe luftën e parë dhe luftën e dytë botërore, të cilat miku im Shkreli po organizon ekspozita në disa cepa të ndryshëm të pjesës së vjetër të lagjes së pazarit”, u shpreh ministri Veliaj. Edicioni i dytë i këtij festivali i cili u mbështetet nga Ministria e

Mirëqenies Sociale dhe Bashkia e Gjirokastrës, vijoi me mjaft aktivitete të ndërthurura si ekspozita, panair kulinarie, sesione shkencore, udhëtime e vizita në banesa të ndryshme karakteristike, site arkeologjike etj, e deri te koncertet e shumta në pika të ndryshme të qytetit. Aktivitetet që vijnë si një ndërthurje e të zhvilluar në zona të ndryshme të Pazarit Karakteristik dhe kështjellës së qytetit, janë ndjekur me mjaft interes jo vetëm nga banorë të rajonit jugor, por edhe nga turistë të huaj dhe banorë të ardhur nga rrethet e ndryshme të vendit dhe trevat shqiptare.

EVENTI

Hapet pas katër dekadash tuneli i Luftës së Ftohtë

Hapet për herë të parë për publikun tuneli i ndërtuar gjatë Luftës së Ftohtë në Gjirokastrë. Ditën e dytë të “Traku Fest”, qytetarët e Gjirokastrës, dhe jo vetëm, kanë pasur mundësi të shohin ambientet e nëndeshme të tunelit, i cili përkon të jetë ndërtuar rreth viteve

80. Mësohet se mjediset e këtij tuneli kanë qenë të palejuara për tu parë më parë nga qytetarët, i cili quhet ndryshe dhe tunel anti-bërthamor. Sipas kreut të Fondacionit “Gjirokastra”, Sadi Petrela, ky tunel është bërë në kullim e Luftës së Ftohtë, rreth viteve 80’, në kohën kur Shqipëria ishte e vetëizoluar. Para-

noja për të mbrojtur nga ndonjë sulm i mundshëm, bëri që të hapet ky tunel. Tuneli është i përbërë nga 56 dhoma. Ai është i ngushtë, por hapësira jetike është normale. Mësohet se shuma e këtij tuneli mund të shkojë në shifra të 80 milionë eurove.



NISJA e këtij festivali është shoqëruar me pjesëmarrje masive në Pazarin Karakteristik, i cili është gjallëruar si kurrë më parë



NË FOTO:
Gjirokastra gjatë 2 netëve të “Traku-Fest”

NJEREZIT

nga ora 13:20-13:45 në

A1

REPORT!

Cikli "Njerëzit" me gazetarin Agim PIPA

Një cikël reportazhesh me antologji dhe histori njerëzore, udhëtime afër dhe larg, dritëhije, drama familjare, njerëz dhe shtresa në nevojë, por edhe histori suksesi

Afër dhe larg

Antologji dhe Histori njerëzore

Emision i përjavshëm

CIKEL DOKUMENTARËSH




Kampionët e Europës formalizojnë goditjet e reja Real mbret i merkatos shet Di Marian, merr Falcaon

— Paris Saint-Germain ka arritur marrëveshjen me Real Madridin për transferimin e Angel di Marias në formë huazimi me të drejtë blerje në verën e vitit të ardhshëm për 80 milionë euro. Futbollisti do t'i bashkohet gjigantit nga Parc des Princes në formë huazimi për t'ju shmangur një ndëshkimi të ri në "Fair-Play Financiar" të UEFA-së. Real Madrid do të përfitojë 10 mil-

ionë euro tani dhe 70 milionë euro të tjera në vitin e ardhshëm. Di Maria u largua nga Real pas ardhjes së James Rodriguez nga Monaco. Ndërsa PSG nuk mund të paguajë këtë merkato të gjithë shumën, pasi ka kaluar limitin e vendosur nga FIFA. Ndërsa Monaco është gati ta shesë Falcaon te Real i Madridit, por më parë duhet të sigurohen se kolumbiani është rikuperuar plotësisht nga dëmtimi në gju.


E përditshmja franceze "L'Equipe" siguron se tashmë operacioni është më pranë se kurrë. 28-vjeçari u largua verën e kaluar për shifrën e 60 milionë eurove nga Los Colchoneros, por që atëherë u përfol se Monaco do të ishte vetëm një trampolinë për të ardhmen e Falcaos te Real. Me blerjet e fundit Real bëhet mbret i merkatos duke synuar të gjithë titujt kampion që janë në lojë.

LAJME shkurt



Shaqiri:
Nuk do të
largohem nga
Bajerni

— Kosovari i Bajernit të Mynihut, Xherdan Shaqiri u ka dhënë një përgjigje përfundimtare të gjithë zërave që e largojnë nga kampionët e Gjermanisë. "Kam një kontratë deri në vitin 2016 dhe do të jap maksimumin për sa kohë do të jem te Bajerni. Klubi beson te unë dhe unë besoj te klubi, pra me pak fjalë nuk kam ndërmend të largohem. Mendoj se Toni Kroos është një futbollist i madh, i cili e përmirësoi ndjeshëm skuadrën, por kemi në dispozicion shumë lojtarë që mund të luajnë në rolin e tij. Në këtë aspekt, largimi i Tonit nuk besoj se do të ndikojë te loja jonë".



Rakitic
thumbon
Realin: Fitojmë
Superkupën

— Blerja e Barcelonës, Ivan Rakitic pas kalimit te katalanasit ka filluar thumbimet ndaj Realit të Madridit. "Unë vë bast për fitoren e Sevillas në Superkupën e Europës ndaj Realit të Madridit. Ata mund të fitojnë, ndërsa mua më kanë ftuar të jem i pranishëm në stadium. Messi është lojtar më i jashtëzakonshëm i viteve të fundit. Zoti i ka dhuruar një gjë të veçantë, diçka që e bën atë më të mirin në botë. Neymar, pavarësisht moshës së re, ka treguar se di të bëjë gjëra të mrekullueshme. Me blerjet e fundit jemi forcuar akoma më shumë" deklaroi ai për mediat spanjolle.

Flamurtari bën goditjen e parë Presidenca turke shpall planin

Kuqezinjtë firmosin me kosovarin Shkodran Metaj

DYLBER BALLA
TIRANE

Presidenca e re e ekipit të Flamurtarit ka realizuar edhe goditjen e parë në merkato pas zyrtarizimit nga Këshilli Bashkiak i qytetit të Vlorës. Kështu kuqezinjtë kanë arritur që të firmosin kontratën me mesfushorin e talentuar kosovar Shkodran Metaj. 26-vjeçari zbarkoi në Vlorë nga Holanda, aty ku prej disa vitesh luante në ligën e dytë me Emmen. Metaj mbërriti në qytetin bregdetar së basku me motrën dhe babanë, nën shoqërinë e të cilëve firmosi edhe kontratën me Flamurtarin.

METAJ

"Kam pasur ofertë për të vazhduar kontratën në Holandë, por në fund s'bashku me familjen vendosa që të firmos me ekipin e Flamurtarit"



Kosovari firmosi një kontratë dy vjeçare me option rinovimit nëse gjithcka do të shkojë sipas paashkimeve të dy palëve. Pas firmosjes së kontratës në prani të investitorëve tike dhe përfaqësuesit të tyre në Shqipëri, Sinan Idrizi, Metaj u shpreh i kënaqur për aventurën e re që po ndërmerr. "Kam pasur ofertë për të vazhduar kontratën me Emenin në Holandë, por nuk kam pranuar. Edhe nga kampionati rumun dhe grek gjithashtu kisha disa oferta të mira, por në fund s'bashku edhe me familjen vendosa që të firmos me ekipin e Flamurtarit, pasi drejtuesit më bindën me projektin ambicioz që kanë këtë edicion. Klubin nuk e njoh mirë, por besoj se do të përshtatem shpejt në Vlorë. Kam dëgjuar për tifozët e Flamurtarit dhe besoj që do të më mbështesin" tha ai. Të kënaqur me afrimin e parë u shfaqën edhe Idrizi dhe aksioneria e firmës turke TRK dhe AtlasJet. "Metaj është blerja e parë, në vazhdim do të ketë të tjerë futbollistë që do të bashkohen me Flamurtarin. Këtë edicion kemi ambicie të qarta dhe për të arritur te suksesi duhen lojtarë cilësorë. Duam të bëjmë një merkato cilësore, por kushtet tona të infrastrukturës nuk na lejojnë. Klubeve shqiptare u mungojnë edhe dushet. Për të motizuar lojtarët do të praktikohet një lloj i ri kontrate. Plus pagesë së garantuar, do të kenë një kontratë rendimenti. Nëse lojtari jep maksimumin, të ardhurat e tij do të shkojnë deri në 150% më lart. Për herë të parë të gjithë lojtarët do të pajisen me karta bankare. Nuk do të ketë më asnjë pagesë në dorë" tha ai.

Blerjet

■ Merkato

"Metaj është blerja e parë, këtë edicion kemi ambicie të qarta dhe për të arritur te suksesi duhen lojtarë cilësorë" tha Idrizi.

■ Kontrata

"Për të motizuar lojtarët kontratë rendimenti. Nëse lojtari jep maksimumin, të ardhurat do të shkojnë deri në 150% më lart".

Villaznia

Sqarohet situata, "Gea Sport" nuk do të largohet nga Shkodra

— Villaznia ka marrë dy lajme të mira në një ditë. Kompania "Gea Sport" përmes një komunikate për mediat ka deklaruar se nuk do të largohet nga Villaznia, ndërsa kuqebllutë arritën të pengonin kalimin e Shtubinës te Teuta në minutat e fundit. Pas lajmeve të mira kompania

zvicereane ka paraqitur edhe emrat për Bordin Mbikëqyrës. Ata janë: Luca Barberis i propozuar për kryetar, Roberto Nava i propozuar për anëtar dhe Eleonora Telo e propozuar për anetare. Administratori Ardian Grabova ka siguruar se portier i Villaznisë në sezonin e ri

do jetë vlonjati Mocka, ndërsa përsa i përket interesimit të Kukësit për Arsid Krujën, Grabova tha se ne i dimë vlerat e ketij lojtari dhe prandaj duam ta mbajmë në skuader. Ai sipas Grabovës është një futbollist që mund të luajë për Liverpul dhe jo për Kukësin".

PARADE FJALEKRYQESH

NGA KADRI VOKOPOLA

VIDEO/
SHAKAJA
HUMORISTIKE
NE PLAZHPër të parë videon në smartphonin tuaj skanoni
QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas

HOROSKOPI



Dashi

Do ruani një lidhje me force gjate kësaj dite sepse ne fakt partneri do e ketë mendjen gjetu. Gjeni mënyrën e duhur për ta mbajtur atë pas vetes. Beqaret do kenë disa takime, por asnjëri nga personat nuk do ua mbushë as shume mendjen sa për te filluar një histori dashurie. Kjo do ju japë mundësinë te kryeni edhe ndonjë shpenzim me tepër.



Demi

Marsi do e rizgjojë pasionin ne jetën tuaj ne çift sot dhe do krijojë kushtet që ju te përjetoni emocione pa fund. Shfrytëzoni çdo sekonde. Beqaret do marrin propozime mjaft interesante dhe do ju mbushet me ne fund mendja për te filluar një histori dashurie. Financat nuk do jete shume te mira kështu që bëni kujdes me çdo lloj shpenzimi.



Binjakët

Do vazhdoni ta ruani edhe sot klimën e ngrohte ne jetën tuaj ne çift dhe gjithçka do shkojë sipas planeve. Partneri ne mbërme mund t'iu beje edhe ndonjë surprize. Beqaret do jene me fat ne dashuri dhe do e gjejnë personin që kane ëndëruar gjithë kohës. Gjendja financiare do varet nga mënyra sesi ju do i menaxhoni te ardhurat.



Gaforja

Dite aspak pozitive kjo e sotmja për te dashuruarit. Urani do iu nxite te debaton me partnerin për gjithçka dhe te mos pranoni kurrësi te toleroni. Beqaret nuk do kenë ne ditën me te përshtatshme për te filluar një histori dashurie. Prisi edhe pak. Ne planin financiar matuni mire para se te shpenzoni. Çdo gabim sado i vogël mund te ndikojë tek situata ne te cilën ndodheni.



Luani

Duhet te tregoheni paksa me te duruar gjate kësaj dite me personin që keni ne krah dhe gjerat do ecin me se miri. Edhe ata që kane pasur debate apo mosmarveshje do kenë përmirësim te situatës. Beqaret do realizojnë takimin e shumëpritur dhe do njihen mjaft mire. Ne planin financiar do keni energjinë e duhur dhe durimin për t'i përmirësuar situatën.



Virgjëria

Do ndiheni mjaft mire sot ne krahët e partnerit tuaj dhe nuk do dëshironi te ndaheni për asnjë çast prej tij. Te dy do i shprehni me tepër se kurrë ndonjë. Nëse zemra juaj është ende e lire duhet te shfrytëzoni çdo mundësi që do i jepet për t'u ngjitur me persona te rinj. Financat duhet t'i menaxhoni me shume kujdes dhe matuni sepe përmirëse situata mund t'iu dale jashtë kontrollit.



Peshorja

Ka rezik që sot te debaton ashpër me partnerin dhe te preket pa dashje disa pika te dobëta te tij. Asgjë nuk do shkojë ashtu si ju e keni pritur. Beqaret duhet te përgatiten për ndryshime mënjësore ne jetën sentimentale. Çdo gjë do ndodhe si me magji për ta. Financat nuk do jene te qëndrueshme, por dhe as shume problematike. Shmangni investimet e tejkajshme.



Akrepi

Tregohuni sa me diplomate gjate kësaj dite ne jetën tuaj ne çift dhe gjeni mënyrën për ta joshur edhe me shume partnerin. Po e bëtë këtë ai nuk ka për t'iu lënë asnjë minute pas dore. Beqaret duhet njehere te reflektojnë me kujdes se çfarë do bëjnë me jetën e tyre para se te hedhin hapa. Ne planin financiar duhet sa me shpejt te vendosni rregull.



Shigjetari

Perspektivat financiare do jene shume te mira gjate kësaj dite për ata që janë ne një lidhje. Gjithçka do shkojë sipas planeve kështu që shfrytëzoni ditën sa te mundni. Beqaret nuk do iu japin shume rëndësi ftesave që do iu bëhen dhe do mbeten shesh vetëm. Financat do vazhdojnë te jene te stabilizuara. Asgjë dhe askush nuk do mund ta prishe këtë qëndrueshmëri.



Bricjapi

Nëse tregoheni paksa me realiste ne jetën tuaj ne çift çdo gjë do shkojë me se miri sot. Po ëndërruat me shume sesa duhet do përbaleni me zhgënjime. Beqaret duhet t'i bëjnë sytë katër sepe personi ideal mund t'iu shfaqet ne çdo moment. Ne planin financiar mund te keni surpriza si te këqija ashtu edhe te mira. Gjithçka do varet nga mënyra sesi ju jeni sjelle kohet e fundit.



Ujori

Do jeni shume kërkues ndaj partnerit tuaj gjate kësaj dite dhe do mërziçeni kur ai te mos ua plotësojë dëshirat. Rikthehuni me këmbë ne toke. Beqaret do jene te sjellshtëm me personat që do takojnë dhe kjo do iu beje me interesante ne sytë e tyre. Ne planin financiar nuk do keni për çfarë te gaheni. Gjithçka që keni dashuruar do iu realizohet me se miri.



Peshqit

Lidhja juaj do konsolidohet mjaft gjate kësaj dite. Do flisni dhe do bashkëpunoni pa fund me atë që keni ne krah. Ne asnjë çast nuk do ndiheni keq. Beqaret, te nxirni nga Marsi do tregohen me te hapur ndaj çdo hese. E ardhmja e tyre do jete tërësisht ndryshe. Ne planin financiar do ndërmerrin iniciativë dhe do fillojnë te përmirësojnë situatën.

FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 35 KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

HORIZONTAL

1. Eshhtë bota e palestinezëve.
-Fund heroi.

2. Thytet një me kohën më me të mirë.

-Fillojnë tematikën.
-I dashuri i Kozetës.

3. Një pjesë e institucioneve.

-Portokalli... i Stanley Kubrick.

-Janë shosha.

4. Janë poeti... barbare.

-Eshhtë dënimi eksem.

-Gjysma e sulmit.

5. Kush nuk di... mbytet.

-Mund të shpërthejë në shtyp.

-Zanore për arena.

6. Fillojnë ironinë.

-Eshhtë infeksion në bark.

-Janë tek në lutje.

7. Mbledh basket separatistë.

-Kështu është heroi pozitiv.

-Fillojnë lajthiljen.

8. Në krye të atletëve.

-Kufizojnë matjet.

-Eshhtë dënimi me serie A.

9. Eshhtë kampionat me serie A.

-Parashetë për prapa.

10. Mund jetë françeskan.

-Një mund të jetë edhe spijanzhi.

11. Memoria në computer.

-Mud të jetë ciklistik.

-Shaban që që voleybollist.

-Fillojnë marrjen.

12. Kështu është rasti i vetëm.

-Fund heroi.

-Pecani regjisor.

13. Një peshtë e pastër.

9. Cooper i i fundmi i mohikanëve.

-Eshhtë derri.

10. Ndiqet nga ata që udhëtojnë.

-Një ngjyra... e humës.

11. Eshhtë ngjyra... e humës.

-Një koeficient shahistësh.

12. Inicialet e Moravia-s.

-Eshhtë Amerika në Brazil.

13. Para Vegas.

-Fillojnë titrat.

14. Opera e Mascagni-t.

-Eshhtë leximi... pas këndimit.

15. Eshhtë gjendje.

-Përfundojnë përteje.

16. Eshhtë grimë që bëjnë gratë.

-Eshhtë distinktiv.

17. Festat pa fat.

... Romeo markë makine

-Gjysmë taktik.

18. Një peshtë e pastër.

9. Cooper i i fundmi i mohikanëve.

-Eshhtë derri.

10. Ndiqet nga ata që udhëtojnë.

-Një ngjyra... e humës.

11. Eshhtë ngjyra... e humës.

-Një koeficient shahistësh.

12. Inicialet e Moravia-s.

-Eshhtë Amerika në Brazil.

13. Para Vegas.

-Fillojnë titrat.

14. Opera e Mascagni-t.

-Eshhtë leximi... pas këndimit.

15. Eshhtë gjendje.

-Përfundojnë përteje.

16. Eshhtë grimë që bëjnë gratë.

-Eshhtë distinktiv.

17. Festat pa fat.

... Romeo markë makine

-Gjysmë taktik.

18. Një peshtë e pastër.

9. Cooper i i fundmi i mohikanëve.

-Eshhtë derri.

10. Ndiqet nga ata që udhëtojnë.

-Një ngjyra... e humës.

11. Eshhtë ngjyra... e humës.

-Një koeficient shahistësh.

12. Inicialet e Moravia-s.

-Eshhtë Amerika në Brazil.

13. Para Vegas.

-Fillojnë titrat.

14. Opera e Mascagni-t.

-Eshhtë leximi... pas këndimit.

15. Eshhtë gjendje.

-Përfundojnë përteje.

16. Eshhtë grimë që bëjnë gratë.

-Eshhtë distinktiv.

17. Festat pa fat.

... Romeo markë makine

-Gjysmë taktik.

FJALËKRYQI SPORTIV

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1										
2										
3										
4										
5										
6										
7										
8										
9										
10										
11										
12										
13										
14										
15										
16										
17										
18										
19										
20										
21										
22										
23										
24										
25										
26										
27										
28										
29										
30										
31										
32										
33										
34										
35										
36										
37										
38										
39										
40										
41										
42										
43										
44										
45										
46										
47										
48										
49										
50										

HORIZONTAL

1. Basti kur s'është ai.

4. Eshhtë shahu i fundit.

5. Një ndërjesë me rezervë.

9. Vanessa violiniste.

10. Fillojnë betejet.

11. Rastisin në krye.

12. Ancelotti trainer.

13. Një... franceze.

14. Skuadra e Shijakut.

17. Fillojë luftën.

18. Inicialet e Walcott tre Arsenal.

19. Futbollisti në foto.

23. Jordi te Barça.

28. Futbollisti në foto.

29. Ventura saksofonist.

29. Massimo që zëvendëson

LAJME

nga bota**Kosovë, prag
krize energetike**

Kosova do ta kalojë dimrin e këtij viti duke u përballur me një krizë të rëndësishme energetike. Nga fillimi i sezonit dimëror e deri në muajin mars 2015, Kosovës i duhen rreth 700 milionë kilovatorë energji elektrike, të cilat duhet t'i importojë. E gjithë kjo krizë ka ardhur si pasojë e avarisë, që ndodhi në fillim të muajit qershor, e që nxori nga prodhimi dy blloqe të Termocentralit "Kosova A". Qeveria e Kosovës është alarmuar për krizën energetike. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Fadil Ismajli, deklaroi se javën e ardhshme parashikohet të gjendet zgjidhja për sigurimin e energjisë për sezonin dimëror. "Kemi bërë takime edhe me donatorët, me institucionet financiare, të cilat ndodhen në Kosovë. Mungesat janë të konsiderueshme", tha ai.

**Londra: Rusia
kërcënon
NATO-n**

Kryeministri David Cameron ka paralajmëruar NATO-n se duhet të rishikojë marrëdhëniet e saj afatgjata me Rusinë pasi Moskë e sheh aleancën euro-atlantike si "kundërshtarë". Në një letër drejtuar udhëheqësve të tjerë të NATO-s, Cameron tha se Aleanca duhet të marrë disa masa që të jetë në gjendje të mbrojtë anëtarët e saj nga një kërcënim i mundshëm ushtarak rus. Sipas liderit britanik, NATO duhet të ketë një "prani me të fuqishme" në Europën Lindore për shkak të veprimeve ilegale që Rusia ka bërë në Ukrainë. Në propozimin e tij përfshihet një përgatitje më e mirë fizike me një orar të ri të ushtrimeve ushtarake, pajisje dhe furnizime të reja mjeteve ushtarake si edhe rritjen e forcës së reagimit të NATO-s e deri në 25.000 trupa.

**Shpërthim në
Kinë, 65 të vdekur**

Zyrtarët kinezë thanë se 65 vetë kanë humbur jetën dhe më shumë se 100 të tjerë janë plagosur nga shpërthimi dje në një fabrikë të qytetit Kunshan, në pjesën lindore të vendit. Autoritetet deklaruan se shpërthimi ndodhi në orën 7:30 të mëngjesit në një punishte për laminimin e pjesëve metalike të rrotave të makinave, në pronësi të një firme tajvaneze. Nga një hetim paraprak del se shpërthimi mund të jetë shkaktuar nga pluhuri metalik në një dhomë të mbyllur, ku ka patur shkëndijë ose flakë.

INFORMACION ME INOVACION

LAJMI I FUNDIT
Lajme në kohë reale nga politika, aktualiteti, ekonomia, sociale, bota, sporti, kultura, thashetheme, video, moti, horoskopi dhe shumë të tjera...

RAPORTONI JU
Nëse jeni dëshmitarë të një ngjarjeje mund të bëni një fotografi ose një video me smartphonin tuaj (ose mund të përdorni një foto ose një video që keni bërë kohë më parë) dhe vetëm me një klik mund ta nisni në redaksinë e A1Report për ta transmetuar

FITONI
Përmes këtij seksioni mund të merrni pjesë pa pagesë në të gjitha konkurset që do të bëhen në A1Report: nëse ju keni fituar, mund ta mësoni vetëm në pak minuta nga ekrani i TV që do të vendosë në transmetim shifrat e fundit të numrave celularë fitues.

LAJME
LIVE TV
RAPORTONI JU
SONDAZH
FITONI
SKANO KODIN QR

LIVE TV
Një fagje LIVE nga e cila mund të ndjekësh programacionin e televizionit A1Report me cilësinë e streaming HD

SONDAZH
Mund të merrni pjesë në të gjitha sondazhet të propozuara nga A1Report ndërkohë që vota juaj do të numërohet në televizion në kohë reale

QR CODE
Me këtë mjet të mrekullueshëm mund të merrni pjesë falas në të gjitha përmbajtjet multimediale që A1Report do të vërë në dispozicion të telespektatorëve të vetë duke përdorur sistemin modern të QR Code

SHKARKO APP FALAS PER IPHONE

POWERED BY SPAZIO EVENTI ALBANIA

**Ditën e hënë
Ora 21:00-22:00**
na ndiqni live në tv

A1 REPORT!

**Ritransmetim
Të martën
00:30-01:30 & 14:30-15:40**

**Në emisionin
5 Pyetjet nga
BABARAMO
me gazetarin
Ilir Babaramo**

DIGITALB
TOKESORE
KANALI 48
Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë

DIGITALB
SATELITOR
KANALI 50
Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë, Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi dhe në pjesën tjetër të Europës

VALE UHF
NË PREFEKTURAT:
TIRANË - DURRËS - LEZHË - FIER

ASCOM
KANALI 158

WWW.BOTIMEMAX.COM.AL

libra të cmuar dhe shumë të lirë

Ofertë verore nga data 3 gusht në të gjitha pikat e shitjes së gazetave

{Sh} GAZETA E SPORTIT

Vetëm 300 Lekë

Dhurata e Hanës
Mësoni nga një jetë e jetuar gjatësisht
MARIA HOUSDEN

OFERTAT MË TË MIRA NGA BOTIMET MAX NË ÇDO PIKË SHITJE GAZETE
KONTAKTONI NË: +355 (4) 4309210 / +355 67 40 19 548

Alba Malltezi - Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group ; Aurel Pepa - Zv/kryeredaktor
Genc Kondi - Administrator i Përgjithshëm & Ekonomik ; Admirina Peçi - Kryeredaktore e "Rilindasit" ; Politika: Brahimi Shima ; Aktualitet: Elton Qyno ; Sociale: Sonila Isaku ;
Kulturë: Dhurata Hamzai ; Sport: Dylber Balla ; Design: Altin Aliaj, Erjon Ymeri ; Website: Greta Malaj ; Shpërndarja: Spiro Meshini cel: +35569608847

Departamenti i Marketingut:
Vera Përleka
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Redaksia: Rruga "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. **E-mail:** redaksia@shqiptarja.com - **Website:** www.shqiptarja.com - **Mobile:** +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën KLASA shp, Rruga 5 Maji, Tiranë